



KOMISIONI EVROPIAN

Bruksel, 12.10.2011
SEC(2011) 1207

DOKUMENT PUNE I PERSONELIT TË KOMISIONIT
RAPORTI I PROGRESIT 2011 PËR KOSOVËN*

Në përcjellje të dokumentit

KOMUNIKATA NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN DHE KËSHILLIN
EVROPIAN

Strategjia e Zgjerimit dhe sfidat kryesore 2011-2012

{COM(2011) 666}

***SIPAS RKSKB 1244/1999**

PASQYRA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	2
1.1. PARATHËNIE	2
1.2. KONTEKSTI	2
1.3. MARRËDHËNIET MES BE-SË DHE KOSOVËS.....	3
2. KRITERET POLITIKE	4
2.1. DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT	5
2.2. TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E PAKICAVE.....	13
2.3. ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE.....	21
3. KRITERET EKONOMIKE.....	23
3.1. EKZISTENCA E EKONOMISË FUNKSIONALE TË TREGUT	23
3.2. KAPACITETI I PËRBALLJES ME PRESIONIN KONKURRUES DHE FORCAT E TREGUT BRENDA BASHKIMIT EVROPIAN	30
4. STANDARDET EVROPIANE	32
4.1. TREGU I BRENDSHËM	32
4.1.2. Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta e themelimit (establishment)	34
4.1.3. Lëvizja e lirë e kapitalit.....	35
4.1.4. Doganat dhe tatimimi.....	35
4.1.5. Konkurrenca.....	37
4.1.6. Prokurimi publik	38
4.1.7. Ligji për pronën Intelektuale.....	38
4.1.8. Punësimi dhe politikat sociale, politikat e shëndetit publik.....	39
4.1.9. Arsimi dhe hulumtimi	41
4.1.10. Çështjet e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT).....	43
4.2. POLITIKAT SEKTORIALE	43
4.2.1. Industria dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM)	43
4.2.2. Bujqësia dhe peshkataria.....	43
4.2.3. Mjedisi	45
4.2.4. Politikat e transportit.....	47
4.2.5. Energjia	48
4.2.6. Shoqëria informative dhe mediet.....	50
4.2.7. Kontrolli Financiar.....	51
4.2.8. Statistikat	52
4.3. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA	53
4.3.1. Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migrimi.....	53
4.3.2. Pastrimi i Parave.....	56
4.3.3. Droga	57
4.3.4. Policia.....	58
4.3.5. Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit.....	59
4.3.6. Mbrojtja e të dhënave personale.....	61
SHTOJCA STATISTIKORE.....	62

1. HYRJE

1.1. Parathënie

Që prej marsit 2002, Komisioni i ka raportuar rregullisht Këshillit dhe Parlamentit mbi përparimin e arritur nga vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Ky raport përgjithësisht ndjek të njëjtën strukturë si në vitet e kaluara. Raporti:

- Përshkruan shkurt marrëdhëniet mes Kosovës¹ dhe Bashkimit;
- Analizon gjendjen politike në Kosovë në kuptimin e demokracisë, sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut, mbrojtjes së pakicave dhe çështjeve rajonale;
- Analizon gjendjen ekonomike në Kosovë;
- Shqyrton kapacitetin e Kosovës në zbatim të standardeve evropiane, që do të thotë përafrimi gradual i legjislacionit dhe politikave të saj me *acquis*, në përputhje me Procesin e Stabilizim-Asocimit, si dhe prioritetet e Partneritetit Evropian.

Ky raport përfshin periudhën nga tetori i vitit 2010 deri në shtator të vitit 2011. progresi matet në bazë të vendimeve të marra, legjislacionit të miratuar, si dhe masave të zbatuara. Si rregull, legjislacioni apo masat që janë në përgatitje apo në pritje të miratimit në parlamentin nuk janë marrë parasysh. Kjo qasje siguron trajtim të barabartë në të gjitha raportet, si dhe mundëson një vlerësim objektiv.

Raporti bazohet në informatat e grumbulluara dhe të analizuara nga Komisioni. Janë përdorur shumë burime tjera, duke përfshirë kontributet nga autoritetet e Kosovës, Shtetet Anëtare të BE-së, Përfaqësuesin Special të BE-së në Kosovë, Misionin e BE-së për sundim të ligjit (EULEX), raportet e Parlamentit Evropian² si dhe informatat nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe joqeveritare.

Komisioni nxjerr konkludime më të hollësishme në lidhje me Kosovën në komunikatën e tij të veçantë për zgjerimin³, në bazë të analizave teknike që janë paraqitur në këtë raport.

1.2. Konteksti

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese në vjeshtën e vitit 2010, Presidenti i Kosovës dha dorëheqje, derisa zgjedhjet e reja u shpallën për muajin dhjetor. Kuvendi i ri u mbledh në shkurt dhe zgjodhi Presidentin. Procesi zgjedhor u kontestua në këndvështrimin kushtetues, ndërsa Gjykata Kushtetuese luajti rol të rëndësishëm përmes mënyrës së ushtrimit të përgjegjësive të saj. Si rezultat, Presidenti i ri u zgjodh në përputhje me kushtetutën e Kosovës. Periudha shënoi rezultate të kufizuara në agjendën e reformave.

Gjatë periudhës së raportimit, komunitetet serbe në jug të lumit Ibër/Ibar kanë rritur bashkëpunimin me autoritetet kosovare, si dhe pjesëmarrjen e tyre në institucionet përfaqësuese.

Dalja e tyre në zgjedhje ka qenë më e lartë, si dhe kanë marrë pjesë edhe në regjistrimin e

¹ Sipas Rezolutës së KS të OKB 1244/1999

² Raportuesja për Kosovën është Znj. Ulrike Lunacek.

³ Strategjia e Zgjerimit dhe sfidat kryesore 2011-2012 - COM(2011) 666.

popullsisë. Në Kosovën veriore, integrimi nuk ka përparuar. Komunitetet veriore të mbështetura nga Serbia nuk kanë bashkëpunuar mjaftueshëm me UNOPS-in dhe Komisionin për të mundësuar vazhdimin e regjistrimit në këtë pjesë të Kosovës. Serbët në veri, të mbështetur nga udhëheqësit politikë lokalë, kanë sfiduar edhe autoritetin e EULEX-it.

Në fund të korrikut, situata në veri të Kosovës eskaloi kur Kosova mori vendim të vendosë embargon ndaj mallrave serbe në përgjigje ndaj bllokadës serbe të mallrave qysh prej vitit 2008, në bazat e mos-njohjes së vulës “Doganat e Kosovës”. Vendimi për embargon erdhi pas dështimit në arritjen e marrëveshjes për vulat doganore të Kosovës në kuadër të dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës, të mundësuar nga BE-ja, i cili ishte filluar pas rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së vitin e kaluar. Dërgimi i njëanshëm i policisë së Kosovës në portat 1 dhe 31 në veri të Kosovës çoi tek dhuna, duke rezultuar në vdekjen e një oficeri të policisë së Kosovës. Qetësia u mundësua me ndihmën e KFOR-it, pranisë ushtarake të udhëhequr nga NATO-ja. Në shtator, çështja e vulave doganore u zgjidh në kontekstin e dialogut Beograd/Prishtinë. Zbatimi i marrëveshjes çoi në bllokada të shumta në veri, duke përfshirë ato në portat 1 dhe 31. Ndodhën edhe incidente të dhunshme. Tensionet në veriun e Kosovës duhen qetësuar, ndërsa lëvizja e lirë e njerëzve dhe e mallrave duhet rivendosur. Gjitha palët duhet të kenë rolin e tyre në proces. Në prizmin e situatës në veri të Kosovës, Serbia ndërpreu pjesëmarrjen e saj në dialog në fund të shtatorit.

Dialogu është vërtetuar të jetë mënyra kryesore e trajtimit të dallimeve mes dy palëve. Janë arritur marrëveshje edhe për regjistrat civilë, lëvizjen e lirë të personave, si dhe për regjistrat kadastralë. Marrëveshjet e arritura duhet të zbatohen në mirëbesim. Qasja përgjithësisht konstruktive e Kosovës në dialog shënon përparim në përkushtimin e saj drejt BE-së.

Deri më sot, Kosova është njohur nga 81 Shtete Anëtare të OKB-së, duke përfshirë 22 Shtete Anëtare të BE-së.

Gjatë periudhës së raportimit, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ka nxjerrë katër raporte për Kosovën – në tetor 2010, si dhe në janar, maj dhe gusht 2011. Ai ka theksuar që autoritetet kosovare kanë rritur përpjekjet e tyre për krijimin e një angazhimi të ngushtë me Bashkimin Evropian, të cilat kanë gëzuar dukshmëri në nivel ndërkombëtar. Ai gjithashtu ka vënë në dukje që dialogu mes Beogradit dhe Prishtinës ka potencial të përafrojë dallimet mes palëve si dhe të zgjidhë një numër çështjesh me histori të gjatë të cilat ndikojnë në jetën e njerëzve në terren.

KFOR-i gjithashtu ka vazhduar të ndihmojë ruajtjen e sigurisë në pjesët tjera të Kosovës. Gjatë periudhës së raportimit, prania e tij është zvogëluar deri në pak mbi 6,000 trupa. Në këtë kontekst, policia e Kosovës ka marrë përsipër përgjegjësinë për mbrojtjen e disa objekteve kulturore dhe fetare. Policia gjithashtu ka marrë përsipër detyrat e sigurisë përgjatë kufirit me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë si dhe me Malin e Zi.

Kosova nuk ka përmbushur kushtet për Marrëveshjen “Stand-by” me Fondin Monetar Ndërkombëtar, e rrjedhimisht, Fondi nuk i ka ndarë asaj ndihmën makro-financiare. Për shkak të kësaj, Komisioni nuk ka mundur të ndajë këstin e radhës të ndihmës së vet makro-financiare për Kosovën. Qeveria e Kosovës duhet të bëjë hapa urgjentë në trajtimin e deficitit buxhetor.

1.3. Marrëdhëniet mes BE-së dhe Kosovës

Kosova merr pjesë në Procesin e Stabilizim-Asocimit (PSA). Cikli i takimeve brenda

dialogut PSA (DPSA) në vitin 2011 është përmbushur në korrik. Gjatë periudhës së raportimit, janë mbajtur shtatë takime sektoriale për këta sektorë: drejtësia, liria dhe siguria; bujqësia; ekonomia, statistikat dhe kontrolli financiar; tregu i brendshëm, konkurrenca, shëndeti dhe mbrojtja e konsumatorëve; transporti, mjedisi, energjia dhe zhvillimi rajonal; inovacioni, kapitali njerëzor, politikat sociale dhe shoqëria informative; si dhe tregtia, industria, doganat dhe tatimimi. Më 30 qershor, Kosova ishte nikoqire e takimit të dytë për dialogun e DSPA-së me shoqërinë civile, të pasuar nga takimi plenar më 1 korrik. Kosova gjithashtu ishte nikoqire e një konference të nivelit të lartë për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në maj. Në promovim të dialogut ekonomik, ka vazhduar mekanizmi i mbikëqyrjes fiskale me Komisionin Evropian, me takime që mbahen dy herë në vit.

Në dhjetor të 2010-ës, në kontekstin e zgjedhjeve të parakohshme të përgjithshme, Parlamenti Evropian dërgoi një delegacion vëzhgues zyrtar prej shtatë anëtarësh në Kosovë. Në janar të vitit 2011, një delegacion dy-anëtarësh i Parlamentit Evropian vëzhgoi përsëritjen e zgjedhjeve në pesë komuna. Komisioni dërgoi një mision me tre ekspertë të zgjedhjeve. Zyra e Përfaqësuesit Special të BE-së (PSBE) organizoi edhe një vëzhgim diplomatik të zgjedhjeve. Në maj, u mbajt takimi i katërt ndërparlamentar mes Parlamentit Evropian dhe Kosovës, në Prishtinë.

EULEX-i ka vazhduar të veprojë në gjithë Kosovën dhe të përmbushë mandatin e tij. Bashkëpunimi i autoriteteve të Kosovës me EULEX-in ka qenë i përzier. Misioni ka përforcuar praninë dhe aktivitetet e tij në veri të Kosovës, sidomos pas ngjarjeve gjatë verës, kur njësitë speciale të Policisë së Kosovës provuan të vendoseshin në portat 1 dhe 31. Gjykata në Mitrovicë ka vetëm gjyqtarë të EULEX-it. Situata në veri të Kosovës ka hapur sfida të veçanta për këtë mision.

BE-ja ka rikonfirmuar përkushtimin e tij ndaj Kosovës, duke përfshirë pjesën veriore, duke hapur një pikë informative në Mitrovicën e Veriut. Shtëpia e BE-së ka zgjeruar praninë e saj dhe tani ka personel të përhershëm nga EULEX-i, PSBE-ja dhe Komisioni. Mandati i Z. Feith si Përfaqësues Special i BE-së (PSBE) përfundoi; ai vazhdon të veprojë si Përfaqësues Civil Ndërkombëtar. Në maj është emëruar PSBE-ja i përkohshëm. Ambasadori italian në Kosovë vazhdon të mbajë mandatin e tij si ndërlidhës për veriun. Shefi i Zyrës ndërlidhëse greke në Prishtinë vazhdon mandatin e tij si ndërlidhës për mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore në Kosovë. Të dy kanë dhënë kontribute të mëdha në fushat e tyre përkatëse.

Kosova vazhdon të përfitojë nga Instrumenti për Ndhimë para Aderimit (IPA), Instrumentit për Stabilitet (IfS) si dhe burimet tjera të financimit. Kosova merr pjesë në programet e IPA-s me shumë përfitues. Dokumenti shumëvjeçar i planifikimit indikativ për periudhën 2011-2013 është miratuar më 27 qershor. Gjatë vitit 2011, gjithsej 68.7 milionë euro të dhëna nga programi vjetor i IPA-s për 2011 janë ndarë në bashkërendim të afërt me Ministrinë e Integritimit Evropian dhe institucionet qeveritare. Ndhimja evropiane para aderimit përqendrohet në mbështetjen e sundimit të ligjit, ekonomisë, tregtisë dhe industrisë, si dhe reformën e administratës publike.

2. KRITERET POLITIKE

Kjo pjesë vlerëson progresin e arritur nga Kosova në përmbushjen e kriterëve politike të Kopenhagës, të cilat kërkojnë stabilitet të institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, si dhe respektimin e mbrojtjen e pakicave. Ajo gjithashtu vëzhgon bashkëpunimin rajonal, marrëdhëniet e mira fqinjësore me vendet në aderim dhe

Shtetet Anëtare, si dhe respektimin e obligimeve ndërkombëtare, si bashkëpunimi me Tribunalin Ndërkombëtar Penal për Ish-Jugosllavinë (TNPJ).

2.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit

Parlamenti

Në tetor të vitit 2010, njëra nga partitë u tërhoq nga koalicioni qeveritar, derisa ushtruesi i detyrës së Presidentit të Kosovës shpalli zgjedhje të parakohshme të përgjithshme më 12 dhjetor. Pas votës së mosbesimit, kuvendi u shpërnda më 2 nëntor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizoi zgjedhjet e parakohshme të përgjithshme në më pak se 40 ditë.

Në bazë të vendimeve të organeve kompetente, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizoi përsëritjen e zgjedhjeve: më 9 janar në komunat Skenderaj/Srbica, Glllogoc/Glogovac dhe Deçan/Decane, si dhe në dy vendvotime tjera, njëri në komunën e Malishevës/Mališevo, tjetri në Lipjan/Lipljan, ndërsa më 23 janar në komunën e Mitrovicës/Mitrovica. Më se 40% e votave të hedhura u deshën të rinumërohen. Përsëritja e zgjedhjeve, rinumërimet dhe shpallja e vonuar e rezultateve kanë dëmtuar kredibilitetin e procesit si dhe legjitimitetin e rezultateve.

Më 7 shkurt, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpalli rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për gjithë Kosovën. Shkalla e daljes në zgjedhje ishte pak mbi 45%. Pjesëmarrja në gjashtë komunat me shumicë serbe ishte rritur. Në tri komunat veriore, prania në zgjedhje ishte e papërfillshme.

Procesi zgjedhor shënoi mangësi serioze. Mbesin sfida në kuptimin e respektimit të standardeve ndërkombëtare dhe thjeshtësisë së sistemit aktual, si dhe mos-dënueshmërinë në të kaluarën sa i përket keqpërdorimeve në zgjedhje. Gjithsej 502 persona janë akuzuar për mashtrime në lidhje me zgjedhjet e përgjithshme nga zyrat komunale të prokurorisë në Kosovë. Deri në fund të qershorit, janë shpallur vetëm 18 vendime. Me përjashtim të një rasti, prokurorët e Kosovës kanë parashtruar ankesa ndaj gjitha vendimeve, për shkak të sanksioneve të buta. Kosova duhet të përballet më vendosmërisht me rastet e mashtrimit zgjedhor. Kosova duhet të përballet me mangësitë dhe të sigurojë vullnetin politik në gjitha nivelet për të organizuar zgjedhje të drejta në secilën fazë të procesit.

Kuvendi u mblodh sërish më 21 shkurt. Më 21 dhe 22 shkurt, u zgjodhën Kryetari i Kuvendit, Presidenti i Kosovës dhe Qeveria. Vijimisht, zgjedhja e Presidentit u kontestua nga një numër deputetësh para Gjykatës Kushtetuese. Më 28 mars, Gjykata Kushtetuese vendosi që zgjedhja e presidentit më 22 shkurt kishte qenë “jokushtetuese”. Pas marrëveshjes mes partive të koalicionit (Partia Demokratike e Kosovës – PDK dhe Aleanca për Kosovë të Re – AKR), si dhe partisë kryesore opozitare (Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK), u zgjodh Presidentja e re – Znj. Atifete Jahjaga – më 7 prill, në pajtim me kushtetutën. Marrëveshja mes tri partive gjithashtu përcaktoi që do të bëheshin reforma kushtetuese dhe elektorale, duke përfshirë zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit të Kosovës, brenda afateve të caktuara kohore.

Në legjislaturën e tij të katërt, kuvendi rizgjodhi kryetarin e kaluar për legjislaturën e re. Kryesia u zvogëlua, nga nëntë në gjashtë anëtarë. Pesë deputetë të kuvendit u zgjodhën si Nën-Kryetarë, tre nga grupet më të mëdha dhe dy nga komunitetet jo-shqiptare. Në përpjekje të harmonizimit të punës së tij, kuvendi zvogëloi numrin e komisioneve parlamentare nga 16 në 13. Bashkëpunimi mes Komisionit për Integritet Evropian dhe Ministrisë së Integritetit Evropian është përmirësuar. Komisioni duhet fuqizuar, sidomos në kuptimin e kapaciteteve administrative, si dhe të sigurojë bashkërendimin dhe vëzhgimin e përgjithshëm të planit të

veprimet për integritet evropiane, si dhe që efektivisht të shqyrtojë legjislacionin në kuptimin e përputhshmërisë me standardet evropiane.

Pas shpërbërjes së kuvendit më 2 nëntor 2010, gjitha projektligjet e dorëzuara iu kthyen prapa zyrës së Kryeministrit. Që prej fillimit të mandatit të katërt, Kuvendi ka miratuar buxhetin dhe një numër ligjesh reformuese. Ai ka miratuar gjithashtu dy rezoluta, të parën në mars mbi dialogun Beograd/Prishtinë, si dhe të dytën në prill për integritet evropiane. Plani i veprimet për integritet evropiane është miratuar në prill.

Programi strategjik i Kuvendit për periudhën 2012-2014 është në rishikim. Kuvendi ende nuk ka miratuar rregulloren e re të punës në përputhje me mandatin e ri. Mbikëqyrja e degës ekzekutive nga Kuvendi duhet përforcuar. Përfaqësuesit e Qeverisë nuk ndjekin seancat plenare në baza të rregullta. Kërkesat nga Kuvendi për raporte me shkrim nga qeveria nuk plotësohen në masë të mjaftueshme. Dëgjimet publike mbesin sporadike, derisa shoqëria civile efektivisht nuk është e përfshirë në asnjë debat parlamentar. Nuk ka platformë institucionale që do të mundësonte dialog të rregullt mes kuvendit dhe organizatave të shoqërisë civile. Ekzistojnë brenga në kuptimin e respektimit të plotë të rregullores së punës së Kuvendit. Miratimi i ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme pa shqyrtim të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, siç kërkohet me rregullore, është një shembull i tillë.

Kapaciteti i Kuvendit për monitorim dhe hulumtime mbetet ende i dobët. Procedura legjislative duhet përforcuar për të siguruar një ekspertizë ndërsektorale. Zyra për çështje ligjore, standardizim dhe harmonizim ka mungesë personeli, duke dobësuar kështu shqyrtimin e efektshëm dhe të hollësishëm të legjislacionit. Kapaciteti i Kuvendit për sigurimin e përputhshmërisë me normat evropiane duhet të avancohet në mënyrë efektive.

Kuvendi ende nuk ka departament ligjor, i cili do t'i ofronte këshilla ligjore udhëheqësve të administratës, Kryetarit dhe kryesisë, si dhe do ta përfaqësonte Kuvendin në gjykatë. Kapaciteti i administratës së kuvendit në ofrim të këshillave ligjore dhe mendimeve formale për kuvendin mbi çështjet kushtetuese gjithashtu mbetet i dobët.

Vazhdojnë të qëndrojnë brengat në lidhje me menaxhimin e resurseve njerëzore nga sekretaria e kuvendit. Rregullorja e re, e cila përcakton organizimin dhe përgjegjësitë e administratës së kuvendit, është miratuar në tetor 2010, si dhe është duke u zbatuar. Rregullorja nuk është në përputhje të plotë me ligjet në fuqi, si ligji mbi shërbyesit civilë dhe ligji mbi pagat e shërbyesve civilë. Duhet zbatuar një procedurë rekrutimi me baza meritore për të shmangur ndërhyrjet politike. Kuvendi duhet të vendosë mekanizma më të fuqishëm për të mbikëqyrë shpenzimet buxhetore gjatë vitit financiar. Buxheti për trajnimin e personelit mbetet mjaft i pashpenzuar. Në shkurt të 2011-ës, Gjykata Kushtetuese vendosi që ligji mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve të kuvendit nuk ishte në përputhje me ligjin mbi pensionet. Kështu, moshë e pensionimit për deputetë duhet të ngrihet nga 55 në 65 vjet.

Në përgjithësi, kuvendi ka zbatuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese për rizgjedhjen e Presidentit. Ka pasur mangësi serioze në procesin e zgjedhjeve të përgjithshme. Kosova duhet të bëjë hapë urgjentë për adresimin e këtyre, duke thjeshtuar sistemin, duke e bërë më transparent, si dhe duke hetuar e përndjekur rastet e mashtrimeve zgjedhore. Është shënuar progres i kufizuar në përforcimin e mbikëqyrjes së qeverisë nga kuvendi, në përmirësimin e shqyrtimit të propozim-ligjeve në përputhje me prioritetet e integritet evropian, apo në punën e përbashkët mes qeverisë dhe kuvendit në një program të përbashkët të reformës. Ekzistojnë brenga në lidhje me respektimin e rregullores së punës nga kuvendi.

Qeveria

Më 22 shkurt, kuvendi votoi qeverinë e re të koalicionit të formuar nga anëtarët e PDK-së, AKR-së dhe partitë e pakicave. Qeveria aktuale ka gjashtë Zëvendës Kryeministra dhe 19 ministra, prej të cilëve tre janë edhe Zëvendës Kryeministra. Zëvendës-Ministrat përfshijnë tre serbë dhe tetë nga komunitetet tjera.

Qeveria e re ka miratuar agjendën e saj legjislative në mars, pasuar nga plani i saj vjetor i punës në prill. Rregullorja e punës së qeverisë është rishikuar. Në mars, qeveria ka miratuar një rregullore për themelimin dhe përfundimin e rolit të departamenteve për integritet evropian brenda ministrive. Tani, ato kanë edhe funksionin e politikave strategjike dhe bashkërendimin e ndihmës së jashtme. Ministria e Integriteteve Evropiane mban takime të rregullta javore me këto departamente, duke siguruar kështu një rrjedhë më të mirë të informatave dhe koordinim më të mirë mes këtyre palëve kryesore. Këshilli ndërministror për integritetin evropian është takuar gjatë periudhës së raportimit. Arkitektura e përgjithshme ndërinstitucionale që udhëheq procesin e integriteteve evropiane duhet përfunduar më tutje dhe të sinkronizohet, por edhe të menaxhohet në mënyrë më efektive. Grupet punuese për integritetin evropian nuk takohen rregullisht.

Ministria e Integriteteve Evropiane, e sidomos shërbyesit civilë që merren me çështjet e integritetit evropian, kanë avancuar në masë të konsiderueshme menaxhimin e ciklit të dytë të dialogut të Procesit të Stabilizim-Asocimit. Kjo siguroi vazhdimësinë e të gjithë procesit përkundër rrethanave të vështira institucionale. Në mars, Ministria miratoi një plan veprimi duke përcaktuar dhjetë prioritetet kyçe të integritetit evropian të natyrës së përgjithshme për qeverinë e Kosovës. Identifikimi më i fokusuar i qëllimeve specifike dhe rezultateve të matshme do të udhëzonin më mirë përpjekjet e qeverisë. Për më tepër, Ministria ka mobilizuar qeverinë dhe kuvendin për të punuar në prioritetet kryesore. Qeveria gjithashtu ka miratuar një Plan Veprimi të rishikuar për Partneritetin Evropian në mars. Struktura e dokumentit është përmirësuar, derisa lista e veprimeve është harmonizuar. Ka nevojë për më shumë përpjekje për ta bërë dokumentin vegël monitorimi dhe udhëzimi strategjik për qeverinë, duke identifikuar më qartësisht se çfarë realisht mund të arrihen brenda 12 muajve të mbuluar nga plani.

Në tetor të vitit 2010, u bë ndryshim/plotësimi i ligjit për vetëqeverisjen lokale. Plani strategjik i ndërtimit të kapaciteteve në komuna është përfunduar në mars të vitit 2011, ndërsa trajnimet janë ofruar. Ministria e Pushtetit Lokal ka miratuar një rregullore për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve komunale. Është nxjerrë edhe një udhëzim për përgjegjësitë e komunave në procesin e integriteteve evropiane. Është themeluar një sistem me indikatorë për vlerësimin e performancës së komunave, i cili tani funksionon në secilën komunë, përveç tri komunave në veri. Ministria ka bërë ca përparim në mbikëqyrjen e autoriteteve lokale. Kufizimet buxhetore dhe mungesa e qasjes në tokë mbeten pengesa madhore ndaj zhvillimit ekonomik të komunave. Interpretimet kundërtënëse të legjislacionit për vetëqeverisjen lokale vazhdojnë të krijojnë pengesa në bashkëpunimin mes niveleve qendrore e lokale të administratës. Kjo situatë duhet zgjidhur, duke përfshirë edhe parashtrimin e çështjeve para gjykatave kompetente.

Përpjekjet e decentralizimit kanë vazhduar. Qeveria duhet të gjejë zgjidhje për qëndrueshmërinë afatgjate të komunave me shumicë serbe të krijuara rishtas. Edhe kapacitetet e tyre administrative duhen përfunduar më tutje. Si rezultat i kundërshtimit nga strukturat e mbështetura nga Serbia në veri të Kosovës, decentralizimi nuk ka mundur të përparojë në këtë rajon.

Në përgjithësi, mund të raportohet për progres të përzier në këtë fushë. Qeveria ka përforcuar departamentet e integritit evropian në ministritë e caktuara, derisa Ministria për Integritet Evropian ka vazhduar të konsolidojë rolin e saj bashkërendues. Ka nevojë për përpjekje të mëtejshme në përmirësim të zbatimit, në ministritë e përfshira, të agjendës së reformimit, në bazë të veprimeve të identifikuara në dialogun e Procesit të Stabilizim-Asocimit. Është arritur progres i konsiderueshëm në decentralizim. Komunitat vazhdojnë të përballen me vështirësi në kuptimin e kapaciteteve dhe resurseve. Integriti i komunave dhe komuniteteve serbe në Kosovën veriore është sfidë e veçantë.

Administrata publike

Ka pasur progres të kufizuar në kuptimin e reformës së administratës publike. Strategjia e rishikuar e administratës publike për periudhën 2010-2013, e cila u miratua nga qeveria në shtator të vitit 2010, nuk është zbatuar ende. Një grup ndërministror pune, përgjegjës për hartimin e planit të veprimit në zbatim të strategjisë së reformës së administratës publike, është themeluar në nëntor të vitit 2010. Plani i veprimit nuk është finalizuar ende, duke vonuar kështu në masë të konsiderueshme zbatimin e reformave të parashikuara. Procesi në përgjithësi pengohet nga mungesa e resurseve financiare dhe mbështetja e pamjaftueshme politike. Në takimin e tij të parë qysh prej shtatorit 2010, komiteti ndërministror për reformën e administratës publike ka miratuar katër plane strategjike zhvillimore në korrik.

Në fushën e reformës së shërbimit civil, janë miratuar disa rregullore dhe udhëzime administrative të rëndësishme, si rregullorja për orarin e punës dhe ajo për përshkrimin e punës, si dhe në veçanti rregullorja për emërimin e shërbyesve të lartë civilë, si dhe ajo për regjistrin civil të shërbyesve civilë. Rregullorja që përcakton përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive është miratuar si pjesë e masave për zbatimin e ligjit për administratën shtetërore. Janë rekrutuar punëtorë shtesë në departamentin e shërbimit civil, por korniza institucionale e administratës publike vazhdon të vuajë nga mungesa e resurseve adekuate. Korniza ligjore e domosdoshme për zbatimin e legjislacionit primar të shërbimit civil nuk është ende e plotë. Zbatimi i ligjeve për administratën shtetërore dhe për procedurat administrative ka qenë i kufizuar.

Instituti i Kosovës për Administratë Publike ka ofruar një numër trajnimesh, sidomos për zyrtarët e prokurimit publik. Kapaciteti administrativ dhe financiar, si dhe funksioni koordinues i Institutit, mbetet kapacitete të dobëta. Kjo ndikon në kapacitetin e tij të sigurimit të një qasjeje më racionale strategjike të ndërtimit të kapaciteteve për shërbyes civilë.

Ligji për qasje ndaj dokumenteve publike është miratuar në tetor të vitit 2010, si dhe është në fazat fillestare të zbatimit. Shumica e kërkesave vijnë nga mediet, por nuk mbahen statistika për to. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i raporton drejtpërdrejt kuvendit. Ai merret me ankesat nga shërbyesit civilë, si dhe monitoron zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil. Këshilli ka organizuar aktivitete vetëdijesuese në komuna në lidhje me ligjet e shërbimit civil të miratuara më 2010. Efektshmëria e Këshillit është e kufizuar, pasi që shumica e vendimeve të tij nuk ekzekutohen nga institucionet përkatëse publike. Për më tepër, disa nga përgjegjësitë e tij ndërthuren me ato të Ministrisë së Administratës Publike.

Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës mbetet i dobët, për shkak të mungesës së mbështetjes politike në sigurimin e pavarësisë së mirëfilltë funksionale dhe financiare. Rekomandimet e Ombudspersonit kërkojnë mbështetje nga Zyra e Kryeministrit për të siguruar zbatimin e tyre. Rekrutimi i zëvendësve të Ombudspersonit ende nuk është përfunduar. Në qershor të vitit 2011, Ombudspersoni ka dorëzuar një raport të veçantë në

Kuvendin e Kosovës. Raporti identifikon si sfida kryesore resurset e pamjaftueshme njerëzore e financiare, por edhe mungesën e kushteve adekuate të punës në Prishtinë dhe komunat tjera. Kuvendi dhe qeveria duhet ta trajtojnë urgjentisht këtë situatë.

Gjatë vitit 2010, Ombudspersoni ka pasur gjithsej 1,233 vizita nga individët që kanë kërkuar këshilla dhe ndihmë. Më 1 shtator 2011, Institucioni i Ombudspersonit ka pranuar rreth 1,000 ankesa. Ombudspersoni duhet të përforcojë komunikimin me publikun mbi rezultatet e punës së tij.

Auditimi i jashtëm gjithashtu ka nevojë të zhvillohet më tutje, pasi ai shërben si motor i përmirësimit të administratës publike dhe sigurimit të përgjegjshmërisë. Përveç zyrave të auditimit të brendshëm në ministri, ekziston edhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, e cila i përgjigjet drejtpërdrejt Kuvendit, si dhe mandati e detyrat e të cilit përkufizohen me Kushtetutë dhe me ligj. Deri në shtator të 2011-ës, Zyra kishte 124 pozita pune, të gjitha të plotësuara. Sa i përket e-Qeverisjes, mungesa e koordinimit ka krijuar situatën ku degë të ndryshme të administratës nuk janë të kyçur, derisa qytetarëve iu ofrohen shërbime të kufizuara të e-Qeverisjes.

Në përgjithësi, ka pasur përparim të kufizuar në reformën e administratës publike. Disa ligje e rregullore janë miratuar. Përpjekjet për zbatimin e strategjive dhe legjislacionit të miratuar duhen rritur. Për më tepër, shkathtësitë në shërbimin civil duhen përmirësuar në masë të konsiderueshme. Kosova ka nevojë të ndërtojë një administratë profesionale publike, të lirë nga ndërhyrjet politike. Ky është prioritet kyç i Partneritetit Evropian, si dhe duhet të jetë prioritet i lartë politik. Rritja e kapacitetit të institucioneve në krye të administratës publike në njërin anë, si dhe të institucioneve të pavarura në anën tjetër, sidomos Ombudspersonit, ka rëndësi madhore.

Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë

Ka pasur progres të kufizuar në mbikëqyrjen civile të forcave të sigurisë. Kosova ende nuk ka zbatuar legjislacionin për klasifikimin e informatave dhe nivelet e sigurisë. Duhet përmirësuar vëzhgimi i shërbimeve të sigurisë dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës nga komisionet përkatëse në kuvend. Për më tepër, partitë kryesore politike në Kosovë vazhdojnë të operojnë me rrjetet e veta të sigurisë.

Sistemi gjyqësor

Kosova ka bërë përparim në sektorin gjyqësor. Gjykata Kushtetuese ka marrë një numër vendimesh, të cilat kanë pasur ndikim të konsiderueshëm. Institucionet kanë siguruar që këto aktgjykime të zbatohen. Në shtator, Gjykata Kushtetuese vendosi mbi çështjen e imunitetit funksional të deputetëve të kuvendit, presidentit dhe anëtarëve të qeverisë. Përveç konfirmimit që askush nuk është imun për veprimet e ndërmarra dhe vendimet e bëra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre, vendimi gjithashtu përcakton rastet dhe rrethanat sipas të cilave mund të bëhen apo të mos bëhen arrestimet apo burgosjet.

Autoritetet e Kosovës kanë vazhduar të zbatojnë legjislacionin e miratuar për reformimin e gjyqësorit, sidomos ligjin për Këshillin Gjyqësor dhe atë për Këshillin Prokurorial, për gjykatat dhe prokurorinë. Buxheti vjetor për gjyqësorin është rreth 17 milionë euro për vitin 2011. Më 2011, ishte rreth 14 milionë Euro, që vlerësohet të jetë 0.34% të BPV-së së vitit 2010. Kosova ka miratuar një ligj mbi aspektet civile të rrëmbimeve ndërkombëtare të fëmijëve në tetor të vitit 2010, si dhe ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve në korrik. Ligji mbi

përgjegjësinë penale të personave juridike për veprat penale, ligji për ndihmën juridike ndërkombëtare në çështje penale, ekstradimit dhe transferimit të personave të dënuar, si dhe ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, të gjithë janë miratuar në fund të gushtit. Zbatimi i ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme paraqet vështirësi të konsiderueshme në kuptimin e mungesës së gjyqtarëve të kualifikuar vendorë. Ligji gjithashtu kufizon rolin e EULEX-it në Dhomë, që është çështje brengosëse, duke marrë parasysh faktin që përfshirja e fuqishme e misionit zvogëlon potencialin e kundërthënieve në lidhje me vendimet e Dhomës.

Me qëllim të zbatimit të ligjit për ndërmjetësimin, komisioni i ndërmjetësimit ka certifikuar 74 ndërmjetës, prej të cilëve 50 i janë parashtruar Ministrisë së Drejtësisë për të marrë licencën. Ata kanë kaluar trajnimin, derisa pilot-qendrat e ndërmjetësimit janë hapur në Gjilan/Gnjilane dhe Pejë/Pec, me mbështetje të donatorëve. Zbatimi i ligjit për noterinë ka filluar. Ka nevojë për përpjekje të mëtutjeshme në konsolidimin e një sistemi plotësisht funksional të noterisë.

Departamenti përgjegjës për ndihmën juridike ndërkombëtare brenda Ministrisë së Drejtësisë ka vazhduar të ushtrojë detyrat e tij në mënyrë profesionale dhe efikase. Kapaciteti i tij është përforcuar. Më 2011, janë nënshkruar marrëveshje bilaterale për ndihmën juridike në çështje penale, ekstradim dhe transferim të personave të dënuar, me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Turqinë. Marrëveshje tjera bilaterale janë duke u negociuar. Përtej kësaj kornize ligjore, ndihma juridike ndërkombëtare e bazuar në reciprocitet është duke vazhduar me shumë vende tjera. Ministria e Drejtësisë e Kosovës vepron në bazë të kërkesave për ndihmë juridike të ndërsjellë që merren nga vendet që nuk e kanë njohur Kosovën, ose drejtpërdrejt ose përmes UNMIK-ut ose EULEX-it. UNMIK-u mbetet pika zyrtare e kontaktit me Interpol-in dhe TPNJ-në. Ndihma e drejtpërdrejtë e ndërsjellë juridike mes Serbisë dhe Kosovës nuk është funksionale. Më 12 gusht është nënshkruar një marrëveshje teknike për ndihmën juridike të ndërsjellë mes Ministrisë së Drejtësisë dhe EULEX-it, sipas së cilës EULEX-i merr përsipër rolin e ndërmjetësit mes Ministrisë së Drejtësisë dhe shteteve të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, si dhe për të lehtësuar përpunimin e kërkesave për ndihmën e ndërsjellë juridike nga ato vende.

Pagat për gjyqtarë dhe prokurorë janë rritur, sipas përcaktimit në ligjet përkatëse, duke përforcuar kështu më shumë *pavarësinë* e gjyqtarëve. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka filluar të adresojë mangësitë në gjyqësor. Këshilli ka miratuar një plan veprimi për zbatimin e ligjit mbi gjykatat. Në tetor të 2011-ës, ai ka miratuar një strategji për zvogëlimin e rasteve të pazgjidhura, si dhe ka filluar ta zbatojë atë më 1 janar 2011. Deri në fund të korrikut, ngarkesa me lëndë të pazgjidhura (e cila është përcaktuar nga strategjia të jetë 161,273, sipas referencës së datës 31 dhjetor 2008) është zvogëluar me rreth 26%, deri në totalin prej rreth 119,000 lëndë. Numri i përgjithshëm i rasteve të pazgjidhura ishte 211,588 lëndë (prej të cilave 111,704 raste të prapambetura në gjykata të rregullta - 76,030 të tyre janë raste ekzekutimi për mospagesë të shërbimeve publike), derisa gjykatat e kundërvajtjeve kanë 99,031 raste të pazgjidhur (7,284 prej të cilave janë të pazgjidhura). Është themeluar një njësi e specializuar e ekzekutimit për rastet civile, me zyrat e veta në pesë gjykata. Janë angazhuar rreth 30 referentë për ekzekutim.

Drejtori i Sekretariatit të Këshillit është emëruar, si dhe ka ndërmarrë hapa madhorë drejt përmirësimit të funksionimit të sekretariatit. Këshilli ka marrë përgjegjësinë e plotë për rekrutimin, kontrollimin e prapavijës dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozita në gjyqësor, si dhe ka themeluar zyrën për vlerësimin dhe kontrollimin gjyqësor dhe prokurorial, për mbështetje të procesit të përzgjedhjes. Zyra duhet të luajë rol të rëndësishëm në të siguruarit

të *përgjegjshmërisë* së gjyqësorit. Prej gjithsej 399 gjyqtarëve të parashikuar për gjykatat e Kosovës, janë plotësuar 244 pozita të lira, derisa Këshilli ka shpallur konkurset për 112 pozita tjera të lira. Shpërndarja e 43 pozitave të mbetura do të bëhet në bazë të ligjit të ri mbi gjykatat, i cili ristrukturon sistemin gjyqësor në Kosovë. Numri i aplikacioneve për riemërim nga anëtarët e pakicave ka vazhduar të jetë më i ulët sesa që nevojitet për plotësimin e gjitha pozitave. Si pjesë e procesit të riemërimit, tre gjyqtarë (nga gjithsej shtatë) janë emëruar në kolegjin e apelit të Dhomës së Posaçme. Më 11 gusht, katër shqiptarë dhe një serb janë emëruar nga Presidenti i Kosovës si gjyqtarë të Gjykatës Supreme. Kjo e çon numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve në Gjykatën Supreme në 16.

Këshilli gjithashtu ka organizuar seanca trajnimi për zyrtarët gjyqësorë, për zbatimin e doracakut për menaxhim të gjykatave, si dhe mbi sistemin informativ të menaxhimit të lëndëve. Ai gjithashtu ka emëruar panelin disiplinor në shkurt, por ende ka për të emëruar komitetet tjera të parashikuara me ligjin mbi Këshillin Gjyqësor. Janë raportuar disa procedura disiplinore kundër gjyqtarëve apo prokurorëve, por asnjë prej tyre nuk ka rezultuar në shkarkim të tyre. Këshilli Gjyqësor ende nuk ka arritur përbërjen e tij të plotë. Këshilli ka miratuar rregullat për zgjedhjen e anëtarëve nga kolegjet e tyre për të plotësuar pozitat që janë liruar nga prokurorët që tani janë anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe kanë organizuar procesin e zgjedhjes. Janë zgjedhur dy gjyqtarë nga shkalla e parë. Kuvendi ende pritet të emërojë tre anëtarë të Këshillit, duke përfshirë dy gjyqtarë nga komunitetet pakicë.

Ligji mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës ka hyrë në fuqi më 1 janar. Të nëntë anëtarët e Këshillit Prokurorial janë emëruar, derisa Këshilli ka filluar punën. Ai ka marrë disa përgjegjësi nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, dhe ka funksionalizuar dy trupa kryesorë tanimë: komisionin disiplinor si dhe kolegjin për rekrutimin e prokurorëve të rinj, për të plotësuar 45 pozita të lira. Disa rregullore administrativ dhe organizative janë miratuar nga Këshilli, derisa procesi i rekrutimit është në vazhdim e sipër. Këshilli ka caktuar prokurorë specialë për t'u marrë me krimin e organizuar, krimin ekonomik, korrupsionin dhe trafikimin e qenieve njerëzore në gjitha gjykatat e qarkut dhe ato komunale. Është me rëndësi që bashkëpunimi mes prokurorëve dhe policisë vazhdon të përmirësohet, sidomos në luftën kundër krimit të organizuar, për të cilën gjë Këshilli duhet të zhvillojë politikën dhe strategjinë e vet prokuroriale, në përputhje me ligjin.

Është arritur përparim në gjykimin e rasteve të mbetura pas trazirave të marsit të 2004-ës. Procedurat penale janë përfunduar në shkallë të parë; shumica e rasteve civile janë konsideruar të papranueshme.

Sistemi gjyqësor mbetet i dobët, derisa *efikasiteti* duhet avancuar. Zbatimi i doracakut për menaxhimin e gjykatave është në fazë të hershme. Menaxhimi i të dhënave dhe lëndëve është ende i dobët. Ende ka raportime të kërcënimeve dhe frikësimit të gjyqtarëve, sidomos në rastet e ndjeshme si ato për të drejtat pronësore. Kjo është brengë serioze në kuptimin e *paanshmërisë* së gjyqësorit. Kështu, duhen ndërmarrë masa të përshtatshme të sigurisë dhe mbrojtjes, për t'i siguruar gjyqtarëve dhe personelit në gjykata mjedis të sigurt të punës, si dhe masa efektive të mbrojtjes ndaj kërcënimeve apo frikësimit. Ndërhyrja politike në punën e gjyqësorit është ende brengosëse.

Sundimi i ligjit vazhdon të jetë çështje brengosëse në veriun e Kosovës. Gjykata në Mitrovicë/Mitrovica vazhdon të përbëhet vetëm nga gjyqtarë e prokurorë të EULEX-it, si dhe funksionon me kapacitet të kufizuar. Kjo kufizon qasjen në drejtësi, si dhe dëmton sundimin e ligjit. Dyzet e dy raste penale janë gjykuar, por lëndët civile nuk janë duke u trajtuar. Rastet civile kanë mbetur pezull për më shumë sesa tri vjet qysh prej ndalimit të aktiviteteve

normale të gjykatës në mars të vitit 2008, duke krijuar kështu brengën për të drejtën e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Aktualisht, as gjykatat komunale e as ato të kundërvajtjeve nuk funksionojnë në veri të Kosovës, përveç gjykatës në Mitrovicë/Mitrovica, që përbëhet nga EULEX-i.

Ekzistojnë brenga serioze për transparencën kur vjen tek zbatimi i ligjit mbi faljen. Ushtruesi i detyrës së Presidentit ka falur (pjesërisht) 103 të burgosur në shkurt të vitit 2011 (në krahasim me 62 në shkurt të vitit 2010). Shumë prej tyre po vuanin dënime për krime të rënda.

Në përgjithësi, Kosova ka shënuar përparim në këtë fushë. Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë një numër aktgjykimesh kyçe. Këshilli Gjyqësor ka filluar adresimin e prioritetëve kryesore, derisa Këshilli Prokurorial ka filluar punën. Përfundimi i suksesshëm i procesit të riemërimit ka rritur vetëbesimin brenda gjyqësorit lokal. Sistemi gjyqësor është ende i dobët. Ndërhyrja në punët e drejtësisë vazhdon të ekzistojë, duket rrezikuar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Ka nevojë për përmirësime në efikasitetin e procedurave gjyqësore si dhe ekzekutimin e vendimeve.

Politika anti-korrupsion

Kosova ka bërë ca përparim në luftimin e korrupsionit. Zbatimi i strategjisë kundër korrupsionit monitorohet nga Agjencia Kundër Korrupsionit. Agjencia është gjithashtu autoriteti përgjegjës për monitorimin e zbatimit të ligjit për parandalimin e konflikteve të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, i cili është ndryshuar në gusht. Ligji për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, si dhe ai mbi deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e dhuratave të gjithë zyrtarëve publikë, ligji për mbrojtjen e informuesve, si dhe ligji për prokurimin publik, janë gjithashtu ligje që janë miratuar në fund të gushtit. Është emëruar edhe një koordinator anti-korrupsioni brenda Zyrës së Prokurorit të Shtetit, derisa nga një prokuror është emëruar në secilën zyrë të prokurorisë së qarkut për t'u marrë me rastet e korrupsionit. Janë ndërmarrë edhe hapa në përforcimin e task-forcës anti-korrupsion si dhe për të siguruar që oficerët e deleguar të policisë dhe ekspertët e angazhuar të jenë në gjendje të kontribuojnë në mënyrë efektive. Janë ndërmarrë hapa të ngjashëm edhe në përmirësimin e bashkëpunimit mes prokurorëve. Një panel i përzier i gjyqtarëve vendorë dhe atyre të EULEX-it ka dënuar zyrtarë të lartë dhe politikanë. Aktakuza kundër zyrtarëve të departamentit të doganave është rrëzuar në baza ligjore nga një gjyqtar i procedurës paraprake i EULEX-it në gjykatën në Prishtinë. Prokuroria ka parashtruar ankesë ndaj këtij vendimi.

Ngritja e pagave të gjyqtarëve dhe përfundimi i procesit të riemërimit janë hapa pozitivë në parandalimin e korrupsionit në gjyqësor. Fushata e vitit 2011 për deklarimin e pasurive ka krijuar një rritje të numrit të deklarimeve nga zyrtarët. 96% (1830) e zyrtarëve kanë bërë deklarimet, të cilat janë publikuar në internet. Janë iniciuar lëndë kundër 84 personave që nuk kanë deklaruar pasuritë e tyre. Agjencia kundër Korrupsionit ka rritur aktivitetet e veta të vetëdijesimit, duke bërë fushata dhe trajnime të caktuara. Agjencia ka kapacitet të mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të veta. Agjencitë e zbatimit të ligjit kanë përforcuar strukturat e veta disiplinore.

Ka pasur disa dënime në rastet e lidhura me korrupsionin. Qysh prej janarit 2009, gjithsej tridhjetë vendime janë marrë nga kolegje të përziera të gjyqtarëve të EULEX-it dhe atyre kosovarë, tridhjetë të pandehur janë gjetur fajtorë, nëntë janë liruar. Në rastet tjera të korrupsionit, 216 raste janë trashëguar nga vitet e kaluara, derisa 92 janë raportuar në

periudhën tetor 2010 – korrik 2011. 75 raste janë zgjidhur në shkallën e parë (40 prej të cilave me aktgjykime dënuese) në këtë periudhë.

Kosova vazhdon të përballet me sfida të konsiderueshme në luftimin e korrupsionit. Legjislacioni që është miratuar tani duhet zbatuar plotësisht. Kapaciteti për hetimin e këtij lloji të krimit, si dhe niveli i ekspertizës, mbeten të kufizuara. Autoritetet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore duhet të jenë më pro-aktive në këtë fushë. Bashkëpunimi mes Agjencisë kundër Korrupsionit, policisë dhe prokurorisë duhet përmirësuar edhe më shumë. Deklarimet e pasurisë nga zyrtarët publikë vazhdojnë të shfaqin dallime mes pasurive të deklaruara dhe të ardhurave aktuale. Shumica e partive politike nuk kanë respektuar plotësisht obligimet e tyre të raportimit tek zyra për regjistrimin e partive politike. Për më tepër, amendamentet e domosdoshme në ligjin për financimin e partive politike nuk janë miratuar ende. Shkeljet e rregullave të prokurimit vazhdojnë të jenë brengosëse në kontekstin e korrupsionit. Qytetarët rregullisht përballen me korrupsionin në polici, dogana e shërbime gjyqësore. Ka nevojë për përpjekje të mëdha në luftimin e korrupsionit të përhapur gjerësisht në fushat e arsimit dhe shëndetësisë.

Në përgjithësi, është shënuar ca përparim në luftën kundër korrupsionit, sidomos me fillimin e trajtimit të disa prej rasteve korruptive dhe përmirësimit të kornizës legjislative. Strukturat e ndërtuara për t'u marrë me korrupsionin gjithashtu janë përmirësuar. Korniza legjislative ende nuk është e plotë. Ka nevojë që kjo sfidë të adresohet në mënyrë më pro-aktive, sidomos nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe gjyqësori. Korrupsioni mbetet i pranishëm në shumë fusha, si dhe vazhdon të jetë brengë serioze. Ai po ashtu ndikon në qasjen e qytetarëve ndaj shërbimeve publike.

2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave

Respektimi i së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Kosova nuk është as anëtare e OKB-së, e as Këshillit të Evropës. Rrjedhimisht, nuk është në pozitë të ratifikojë **instrumentet përkatëse ndërkombëtare për të drejtat e njeriut**. Kosova nuk i nënshtrohet këtyre kornizave të vendosura nga trupat ndërkombëtare për raportim të rregullt dhe bashkëpunim për të drejtat e njeriut (duke përfshirë **Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut**). Kushtetuta e Kosovës përmban dispozita të qarta për sigurimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Përveç një katalogu të të drejtave, Kushtetuta i vendos dispozitat operative të instrumenteve të shumta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si obligative brenda rendit juridik të Kosovës. Kosova synon të angazhohet me trupat evropiane dhe ndërkombëtare të monitorimit përtej komunikimit të vazhdueshëm joformal.

Gjatë periudhës së raportimit, qeveria ka dorëzuar raportin tek Komiteti për të Drejtat e Fëmiut. Ky bashkëpunim me rregullime ad-hok për raportim para trupave të Traktateve të OKB-së është hap pozitiv. Ky i ka bërë të mundur Kosovës që të parashtojë një raport mbi zbatimin e Konventës për Eliminimin e gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas.

Promovimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut mbetet sfidë madhore. Trajnimi është organizuar për të ndërtuar kapacitetet e njësive për të drejtat e njeriut. Zbatueshmëria e mjeteve juridike dhe administrative në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut duhet përmirësuar në gjitha nivelet. Spektri i institucioneve dhe trupave që merren me të drejtat e njeriut në nivel qendror dhe komunal është tejte i shpërndarë, e nganjëherë edhe i ndërthurur. Komunikimi dhe bashkërendimi mes institucioneve dhe trupave të ndryshëm që merren me të

drejtat e njeriut në nivel qendror dhe lokal si dhe me Ombudspersonin, janë të dobëta. Këta trupa duhen harmonizuar, e mandati i tyre duhet qartësuar, për të shfrytëzuar më mirë ekspertizën dhe resurset e tyre të kufizuara.

Në përgjithësi, kjo fushë mbetet sfidë madhore. Struktura institucionale e promovimit dhe zbatimit të të drejtave të njeriut duhet thjeshtuar. Duhet siguruar edhe resurset e duhura. Duhet përforcuar përpjekjet në avancim të zbatimit të ligjeve dhe politikave ekzistuese. Sigurimi i respektimit të plotë të të drejtave të njeriut është prioritet kyç i Partneritetit Evropian.

Të drejtat civile dhe politike

Qeveria duhet të vazhdojë përpjekjet e saj për adresimin e **torturës dhe keqtrajtimit**, duke përfshirë edhe luftën kundër padënueshmërisë. Numri i rasteve të raportuara ku përfshihen policia dhe personeli i burgjeve është zvogëluar. EULEX-i është duke monitoruar dhe duke përcjellë pretendimet për keqtrajtimet e mundshme në burgun e Dubravës, si dhe duke punuar afërsisht me ekipin intervenues të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Në përgjithësi, ka nevojë për përpjekje të mëtutjeshme në parandalimin e torturës, keqtrajtimit dhe padënueshmërisë. Kosova ka shënuar ca përparim në lidhje me **sistemin e burgjeve**. Kushtet e jetesës në qendrat e paraburgimit në Kosovë janë përmirësuar. Janë bërë edhe hapat e parë në vendosjen e një mekanizmi të qëndrueshëm për monitorimin e paraburgimit lokal, për të koordinuar përpjekjet e organizatave të ndryshme lokale dhe institucionet që monitorojnë paraburgimin dhe mbajtjen. Një marrëveshje bashkëpunimi mes Ombudspersonit, Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës dhe Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, me qëllim të vendosjes së një mekanizmi të tillë, ka hyrë në fuqi në maj. Shërbimi Korrektues i Kosovës ka vendosur një program të trajtimit me metadon, gjë që ka përmirësuar gjendjen e të varurve nga droga brenda të burgosurve.

Ekzistojnë disa çështje të mbetura që duhen trajtuar. Vetëm një numër i vogël i rreth tridhjetë akteve nënligjore për zbatimin e ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale ka hyrë në fuqi. Për shkak të mungesës së hapësirës në qendrat e paraburgimit, si dhe rritjes së numrit të të paraburgosurve (nga 369 në gusht 2010, në 545 në qershor 2011), Shërbimi Korrektues i Kosovës ka bartur disa të mbajtur në burgun e Dubravës, ku ata janë vendosur në një pavijon të ndarë nga të burgosurit e dënuar. Shërbimi Korrektues vazhdon të përballet me vështirësi në sigurimin e fondeve për riparime. Ndërtimi i burgut të sigurisë së lartë duhet përfunduar sa më shpejt që është e mundur. Bashkëpunimi me qendrën e paraburgimit në Mitrovicë dhe zyrën qendrore është përmirësuar, dhe tani është i kënaqshëm. Ky objekt nuk është i përshtatshëm për të burgosurit me dënime afatgjate.

Aktualisht, Shërbimi Korrektues nuk ka sistem elektronik të informatave, i cili mund të regjistrojë dhe ofrojë të dhëna të besueshme mbi numrin e të burgosurve. Kjo e bën të pamundur planifikimin e programeve efektive të riintegritit social. Korrupsioni brenda sistemit të burgjeve duhet adresuar.

Në përgjithësi, mund të raportohet ca përparim në lidhje me shërbimet korrektuese. Kosova po vazhdon të ndjekë synimet e saj në këtë fushë. Në rastin e **qasjes në drejtësi**, ka pasur përparim të kufizuar. Mekanizmat për të ndihmuar viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje ekzistojnë. Zyrat e ndihmës juridike gjithashtu janë hapur. Zyrat ndërlidhëse me gjykata janë në funksion në gjitha rajonet, por financimi dhe resurset e tyre duhen siguruar plotësisht.

Ende vazhdojnë sfida madhore, siç është rasti i ngarkesës me lëndë të vjetra. Gjykata në Mitrovicë vazhdon të funksionojë me kapacitete të kufizuara nga EULEX-i. Qasja në drejtësi për viktimat e trafikimit, fëmijë e gra, duhet përmirësuar. Ka nevojë për përpjekje të mëtutjeshme për të siguruar ndihmën juridike në Kosovë, duke përfshirë edhe miratimin e ligjit përkatës.

Në përgjithësi, Kosova ka shënuar përparim të kufizuar në këtë fushë. Ka një numër pengesash që vazhdojnë të kufizojnë qasjen në drejtësi. Kosova është ende në një fazë të hershme të sigurimit të një qasjeje të tillë. Sa i përket **lirisë së shprehjes**, mund të raportohet përparim i kufizuar. Transparenca e pronësisë së medieve garantohet me ligj, derisa ligji zbatohet në mënyrën e duhur. Komisioni i Pavarur për Media ka ndërmarrë monitorimin nga mediet të fushatës zgjedhore për herë të parë. Njësitë ministrore për të drejtat e njeriut kanë kryer trajnimin për ligjin mbi qasjen ndaj dokumenteve publike. Zbatimi i këtij ligji kërkon që rolet dhe përgjegjësitë e ministrive të përfshira të qartësohen.

Pesë profesionistë të medieve dhe një kryetar komune janë akuzuar për komente kërcënuese dhe shpifëse ndaj një gazetari të pavarur hulumtues. Gazetarët vazhdojnë të përballen me presione politike dhe frikësim, gjë që kërcënon gazetarinë hulumtuese, e cila është ende e brishtë. Ndryshimi i Kodit Penal, që do t'i jepte fund shpifjes si vepër penale, ende nuk është miratuar. Standardet profesionale në gazetari duhen avancuar.

Përpjekjet për hartimin e ligjeve të reja për Komisionin e Pavarur të Medieve dhe transmetuesin publik RTK, kanë kontribuar në rritjen e vetëdijesimit për standardet evropiane. Pavarësia editoriale e transmetuesit publik RTK nuk është e garantuar. RTK-ja gjithashtu ka mungesë të financimit të qëndrueshëm. Financimi aktual që vjen vetëm nga buxheti ka dëmtuar seriozisht pavarësinë e RTK-së. Mediet tjera varen shumë nga financimi nga sektori publik dhe ndërmarrjet publike. Kuvendi ende nuk ka emëruar anëtarët e Komisionit të Pavarur të Medieve. Legjislacioni garanton kohë të mjaftueshme për programe të pakicave në RTK, por kjo nuk respektohet në praktikë.

Në përgjithësi, Kosova vazhdon të përballlet me sfida të konsiderueshme në këtë fushë, duke përfshirë ndërhyrjet politike. **Liria e grumbullimit dhe asocimit** vazhdon të ushtrohet në Kosovë. Janë mbajtur demonstrata të ndryshme në Kosovë. Ligji i ndryshuar së voni për lirinë e asocimit në OJQ siguron që të drejtat e tyre të asocimit të mos pengohet. Sa i përket zhvillimit të organizatave të shoqërisë civile, mund të raportohet shumë pak përparim. Presidentja e Kosovës ka ftuar disa përfaqësues të shoqërisë civile që ta këshillojnë atë. Institucionet duhet të gjejnë mënyra për të siguruar bashkëpunim më të strukturuar me shoqërinë civile. Të kuptuarit publik i rolit të shoqërisë civile mbetet i ulët. Është brengosëse që shoqëria civile i nënshtrohet presioneve politike të mëdha dhe kërcënimeve, nëse aktivitetet e saj nuk përputhen me qëndrimet e autoriteteve.

Në përgjithësi, ka pasur përparim të përzier në kuptimin e garantimit të plotë të lirive të grumbullimit dhe asocimit. Mjedisi në të cilin OJQ-të veprojnë duhet përmirësuar. Qeveria, Kuvendi dhe komunat duhet të bashkëpunojnë në mënyrë më efektive me shoqërinë civile. Në lidhje me **lirinë e të menduarit, ndërgjegjes dhe fesë**, ka pasur përparim. Policia e Kosovës ka vazhduar të marrë përsipër nga KFOR-i ruajtjen e objekteve historike dhe fetare, duke përfshirë ato ortodokse serbe. Vetëm tri objekte mbesin në mbrojtjen e KFOR-it. Kosova ka shtyrë përpara aktivitetet e rinovimit të objekteve ortodokse serbe në bashkëpunim me pjesëmarrësit përkatës nga Kisha Ortodokse Serbe dhe nga autoritetet serbe.

Seminari Ortodoks ka rifilluar aktivitetet e tij në objektin e vet historik në Prizren. Kosova ka filluar konsultimet për amendamentimin e ligjit për liritë fetare, për t'i dhënë fund kërkesës aktuale që gjitha bashkësitë fetare të regjistrohen si OJQ.

Janë mbajtur edhe demonstrata paqësore me baza fetare në Prishtinë. Udhëheqësit fetarë kanë marrë pjesë bashkërisht në disa ngjarje fetare. Ndërtimi i katedrales katolike në qendër të Prishtinës është në vazhdim e sipër. Studentët kanë ndërmarrë veprime për të pastruar varrezat hebraike në Prishtinë.

Megjithatë, janë vandalizuar disa objekte të trashëgimisë fetare, duke përfshirë kishat ortodokse serbe dhe varrezat ortodokse e myslimane. Mekanizmat për raportimin dhe përcjelljen e këtyre veprimeve duhen përforcuar.

Në përgjithësi, ka pasur përparim të përzier në kuptimin e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, derisa bartja e përgjegjësive për mbrojtjen e objekteve fetare e kulturore tek policia është bërë butësisht. Toleranca ndaj feve mbetet e brishtë. Mungesa e respektit ndaj objekteve simbolike dhe besimtarëve, pa marrë parasysh fenë e tyre, vazhdon të ekzistojë.

Të drejtat ekonomike dhe sociale (Shih edhe Kapitullin 4.1.8 – Politikat sociale, punësimi dhe shëndeti publik)

Në fushat e **të drejtave të gruas dhe barazisë gjinore**, mund të raportohet përparim. Pozita e gruas në politikë është përmirësuar me zgjedhjen e Znj. Atifete Jahjaga për Presidente të Kosovës, si dhe emërimin e tri grave si Zëvendës Kryeministre, duke përfshirë negociatoren në dialogun Beograd/Prishtinë, si dhe Ministren e Integritetit Evropian.

Ligji i punës ka zgjeruar të drejtën e pushimit të lindjes. Në zbatimin e këtij ligji, duhet kushtuar vëmendje ndaj cenueshmërisë së grave në tregun e punës. Zbatimi i ligjit për mbrojtje kundër dhunës në familje ka vazhduar. Në këtë drejtim, Agjencia për Barazi Gjinore dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës kanë ofruar trajnime personelit ligjor për mbrojtjen nga dhuna në familje. Është mbajtur edhe një debat publik për këtë çështje në Gjilan/Gnjilane.

Janë botuar edhe fletëpalosje. Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka themeluar njësinë për të drejtat e njeriut, e cila gjithashtu merret me barazinë gjinore, si dhe ka angazhuar tre zyrtarë. Në nivel komunal, janë ofruar trajnime dhe janë avancuar kapacitetet.

Dhuna në familje dhe ajo me bazë gjinore vazhdon të jetë sfiduese në Kosovë. Legjislacioni përkatës duhet zbatuar dhe monitoruar. Shërbimet për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit pjesërisht financohen nga qeveria, por mbeten gjerësisht të varura nga financimi i donatorëve. Duhet siguruar riintegrimi afatgjatë i viktimave, duke përfshirë stabilitetin e tyre ekonomik dhe qasjen e tyre në drejtësi. Duhet ndërmarrë masa pozitive për t'i fuqizuar gratë si viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje. Shifrat e larta të braktisjes së shkollave nga vajzat, si dhe përfaqësimi i dobët i grave në tregun e punës, duke përfshirë sektorin publik, kërkojnë veprime konkrete nga autoritetet. Agjencia për Barazi Gjinore ka vazhduar lehtësimin, promovimin dhe monitorimin e zbatimit të Programit të Barazisë Gjinore (2008-2013).

Në përgjithësi, ka ca përparim që mund të raportohet në lidhje me të drejtat e gruas. Institucionet përkatëse duhen përforcuar, si dhe buxheti i tyre të rritet, ashtu që legjislacioni të zbatohet plotësisht.

Mbrojtja e **të drejtave të fëmiut** është përmirësuar me zbatimin e Kodit të Drejtësisë për të Mitur, si dhe procesin e monitorimit të tij. Në mars është botuar edhe raporti vjetor për të drejtat e fëmiut. Është themeluar Këshilli për Mbrojtje të Fëmiut dhe Drejtësisë për Fëmijë. Ai duhet të përqendrohet në zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për të drejtat e fëmijëve për periudhën 2009-2013.

Kosova ka hapur qendra mësimi në disa komuna për të luftuar kundër braktisjes së shkollës nga romët, ashkalijtë dhe egjiptasit. Këto përpjekje duhet të vazhdojnë.

Skema e ndihmës sociale është duke u rishikuar, në bazë të konsultimeve të domosdoshme si dhe duke marrë parasysh kufizimet buxhetore. Mbrojtja e fëmijëve mbetet e dobët, derisa shkalla e varfërisë tek fëmijët është mbi 48%. Fëmijët përballen me rrezik më të madh të varfërisë sesa popullsia në përgjithësi, e sidomos mes komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas. Kujdesi amnor i dobët, bashkë me ushqimin dhe kujdesin shëndetësor të fëmijëve, janë sfida tjera që pasqyrohen me nivelin e lartë të vdekshmërisë së fëmijëve. Lypja e detyruar nga fëmijët vazhdon të jetë e pranishme gjithandej. Kosova ka nevojë të përforcojë sistemin e saj të mbrojtjes së fëmijëve.

Në përgjithësi, mbrojtja e fëmijëve mbetet e dobët. Duhet zhvilluar mekanizma e procese për të zbatuar të drejtat e fëmijëve. Mbrojtja e fëmijëve duhet mbështetur me një qasje funksionale shumë-sektoriale. Është arritur progres i kufizuar me **personat me cenueshmëri sociale dhe/ose persona me aftësi të kufizuara**. Seancat e trajnimeve në këtë fushë kanë avancuar kapacitetet administrative, si dhe duhet të vazhdojnë si të tilla. Këshilli për Persona me Aftësi të Kufizuara është themeluar për të koordinuar zbatimin e legjislacionit. Raporti i parë për zbatimin e planit të veprimit për persona me aftësi të kufizuara (2009-2011) është publikuar. Ky plan, bashkë me ligjin për aftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, duhet zbatuar më mirë, si dhe të monitorohet zbatimi i tyre. Kërkohen edhe veprime adekuate në nivelin komunal.

Përgjithësisht, ka nevojë për më shumë përpjekje për të përmirësuar jetën e përditshme të grupeve sociale të cenueshme dhe personave me aftësi të kufizuara. Qeveria ka vazhduar të organizojë disa fushata vetëdijesuese për ligjin **kundër diskriminimit**. Niveli i ulët i besimit në gjykata është dekurajues për viktimat e diskriminimit. Ka nevojë për më shumë përpjekje në luftimin e gjitha formave të diskriminimit, i cili është çështje madhore brengosëse. Zbatimi i legjislacionit përkatës, e sidomos ligjin kundër diskriminimit, mbetet i detyrueshëm. Monitorimi i zbatimit të ligjeve në këtë fushë është ende i pamjaftueshëm.

Kushtetuta ndalon diskriminimin në baza të orientimit seksual. Ligji kundër diskriminimit gjithashtu ofron një shkallë të lartë mbrojtjeje për komunitetin lezbik, homoseksual, biseksual dhe transseksual (LGBT). Zbatimi praktik i legjislacionit mbetet sfidë.

Ekziston ende një mungesë vetëdijeje për çështjet e LGBT-së, të cilat nuk diskutohen haptas. Ka njohuri e kuptim të kufizuar në anën e zyrtarëve të zbatimit të ligjit në lidhje me të drejtat e këtij komuniteti. Mungesa e tolerancës, e pranuar nga shoqëria, ndaj individëve që identifikojnë veten si persona me orientim tjetër seksual kërkon përkushtim më politik. Anëtarët e komunitetit LGBT përballen me kërcënime, apo edhe me rrezikun e dhunës.

Në përgjithësi, ka nevojë për më shumë përpjekje për të ngritur vetëdijen për masat kundër diskriminimit, si dhe për zbatimin e legjislacionit ekzistues. Në fushën e **të drejtave të punës dhe atyre sindikale**, është arritur përparim. Ligji i punës është miratuar në nëntor të vitit 2010. Kjo përmirëson kushtet e punës, sidomos në kuptimin e kontratave të punës. Ai

gjithashtu ka vendosur pushimin e paguar të lindjes deri në 9 muaj. Këshilli Socio-Ekonomik është funksionalizuar, derisa ligji për këshillin Socio-Ekonomik është miratuar, duke rregulluar kështu organizimin, mandatin dhe veprimet e tij. Inspektoratet e punës janë riorganizuar, por iu mungojnë kapacitetet e domosdoshme për monitorimin e kushteve të punës në gjithë Kosovën. Ligji për sindikatat është miratuar, duke qartësuar kështu të drejtat e punëtorëve për të themeluar dhe për të marrë pjesë në sindikata. Ekzistojnë brenga në lidhje me përafrimin e ligjit mbi grevat me Kartën Evropiane për të Drejtat Themelore si dhe standardet ndërkombëtare.

Në përgjithësi, të drejtat e punës dhe ato sindikale janë garantuara gjerësisht. Zbatimi i legjisllacionit ekzistues ka rëndësi qenësore në krijimin e ndryshimeve të prekshme. Në kuptimin e të **drejtave pronësore**, ka pasur përparim të përzier. Është miratuar një numër ligjesh për përmirësimin e kornizës ligjore (ligji për kadastrën, ndryshimet në ligjin për themelimin e regjistrimit të të drejtave mbi pronën e paluajtshme, ligji mbi tatimet mbi pronën e paluajtshme, ligji mbi dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, si dhe ligji për ndryshim/plotësimin e ligjit për shpronësim). Komuna e Prishtinës ka miratuar një rregullore për inicimin e procesit të legalizimit të ndërtimeve të paligjshme. Gjyqtari vendor i Kolegjit të Gjykatës Supreme për ankesat kundër vendimeve të kontestuara të Agjencisë së Pronës është emëruar, duke e bërë këtë kolegji funksional. Qeveria ka emëruar koordinatorin e saj për të drejta pronësore, me qëllim të përmirësimit të zbatimit të ligjit në këtë fushë. Agjencia Kadastrale e Kosovës ka filluar një projekt për regjistrimin e banesave në qytetet kryesore të Kosovës. Gjitha zyrat kadastrale komunale tani janë të lidhura me Agjencinë Kadastrale qendrore të Kosovës, derisa të dhënat janë në dispozicion në qendër dhe në zyrat komunale. Nga 41,222 kërkesa të regjistruara nga Agjencia Kosovare e Pronës, 30,649 janë trajtuar nga Komisioni i Kosovës për Kërkesa Pronësore. 18,365 kërkesa të vendosura të cilat janë rrëzuar për shkak të njoftimit të pasaktë fizik gjatë periudhës 2006-2009, janë njoftuar sërish. Zyrat e UNHCR-së në Serbi veprojnë si zyra ndërlidhëse për Agjencinë Kosovare të Pronës.

Numri i vendimeve të vlefshme të Komisionit të Kërkesave Pronësore qëndron tek shifra 17,076, prej të cilave 11,712 iu janë dorëzuar parashtruesve të suksesshëm. Nga 4,526 kërkesa të pranuar, 3,133 janë zbatuar, 1,069 me riposdim, derisa 1,268 janë vendosur nën administrimin e Agjencisë së pronës. Zbatimi i urdhrave të dëbimit dhe administrimit të pronës në pjesën veriore të Mitrovicës mbetet sfidë. Financimi i Agjencisë së Pronës mbetet i paqëndrueshëm. Rreth 21,000 kërkesa për kompensim prone mbeten të pazgjidhura para gjykatave. Gjykatat e shkallës së dytë shpesh i kthejnë rastet pronësore tek gjykatat e shkallës së parë për rigjykim. Kjo ndodh për shkak të parregullsive ose në aktgjykim, ose në procedura, gjë që çon në përsëritjen e gjykimeve. Kontestet ndëretnike pronësore zgjaten pa nevojë në gjykatat vendore. Nuk ka skemë kompensimi për banesat shoqërore. Ligji për shitjen e banesave ku ekzistojnë të drejta shfrytëzimi nuk është miratuar ende. Mungesa e strategjisë së rregullimit të vendbanimeve joformale mbetet brengosëse. Derisa procedurat e shpronësimit zbatohen në masë të kënaqshme, si dhe pronarët kompensohen, nuk bëhen në masë të duhur konsultime të mirëfillta dhe njoftime nga autoritetet për pronarët e zhvendosur. Kjo pastaj krijon ngarkesë të shtuar të rasteve të pazgjidhura në gjykata.

Në përgjithësi, zbatimi i dobët i ligjeve pronësore është pengesa më madhore ndaj mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave pronësore.

Respektimi dhe mbrojtja e pakicave, të drejtat kulturore

Ka pasur ca përparim në respektimin dhe mbrojtjen e **pakicave**. Decentralizimi dhe mbështetja për komunat e posathemeluara me shumicë serbe janë zhvillime pozitive. Ky proces ka nevojë për më shumë vëmendje dhe vullnet politik për zgjidhjen e çështjeve të mbetura, siç është menaxhimi i tokës. Puna e Këshillit Konsultativ të Komuniteteve ka vazhduar. Anëtarët e saj kanë kontribuar në shqyrtimin e veprimtarisë dhe politikave të qeverisë që prekin komunitetet, sidomos përmes grupeve të tij punuese për arsim dhe për çështjet në lidhje me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas. Gjatë periudhës së raportimit, një kroat është emëruar në Këshill, duke e bërë kështu forumin më përfaqësues. Këshilli po konsultohet përditë e më shumë nga organet ekzekutive. Numri i incidenteve që prekin komunitetet pakicë është rritur, si pasojë e ngjarjeve që nxitën tensionet mes Kosovës dhe Serbisë.

Mund të raportohet përparim i kufizuar në lidhje me qasjen e komuniteteve pakicë ndaj arsimit. Ligjet e miratuara së voni për arsimin parauniversitar dhe atë të lartë përmbajnë dispozita në lidhje me përfaqësimin e komuniteteve jo-shqiptare në këshillat dhe autoritetet arsimore që rregullojnë dhe mbikëqyrin sistemin arsimor. Ligji i ri për arsimin e lartë përfshin gjithë bartësit e arsimit të lartë, duke përfshirë universitetin në gjuhën serbe.

Finalizimi i kornizë-kurrikulës së re ka qenë parakushti për hartimin e kurrikulave në serbisht dhe gjuhë tjera të komuniteteve. Tani është krijuar kjo dhe hartimi i kurrikulave të lëndëve duhet të fillojë. Regjistrimi i nxënësve romë është rritur paksa. Kurrikula për gjuhën rome është publikuar si lëndë zgjedhore në tri gjuhë (shqip, rome dhe serbisht).

Shumë libra shkollorë ende nuk ofrohen në gjuhën amtare të komuniteteve turke, boshnjake dhe rome. Për më tepër, ende nuk ka kurrikulë serbe në dispozicion nga Kosova, e as serbishtja nuk ofrohet si gjuha e dytë zyrtare në shkollat publike jashtë zonave të banuara kryesisht nga serbët. Në shumë raste, qasja në arsimin e mesëm në gjuhën amtare për komunitetet turke dhe boshnjake pengohet nga mungesa e kurrikulës së përkthyer në gjuhën e tyre, apo cilësia e dobët e përkthimeve të librave shkollorë.

Trajnimi për mësimdhënës që ligjërojnë në gjuhët e komuniteteve duhet të avancohet, sidomos në lidhje me kurrikulat e reja. Personeli mësimdhënës i shkollave të mbështetura nga Serbia ka filluar të nënshkruajë kontrata me drejtoritë komunale të arsimit të Kosovës. Mësimdhënësit goranë nuk kanë nënshkruar kontrata me komunën e Dragashit/Dragaš, e për këtë janë ndaluar të shfrytëzojnë objektet shkollorë të administruara nga Kosova.

Ka pasur pak përparim në kuptimin e përdorimit të gjuhëve. Korniza ligjore përgjithësisht arrin standardet ndërkombëtare për të drejtat gjuhësore. Komisioni i Gjuhëve ka filluar të marrë ankesa. Komunat e sapothemeluara kanë miratuar rregulloret për përdorimin e gjuhëve zyrtare. Zbatimi i ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare mbetet joadekuat. Mungesa e resurseve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare rrezikon qasjen ndaj shërbimeve publike shumëgjuhëshe, e edhe pjesëmarrjen efektive në jetën publike. Ndikimi i Komisionit të Gjuhëve është tejet i kufizuar, për shkak të mungesës së resurseve njerëzore, si dhe strukturave të komplikuar institucionale që merren me të drejtat themelore.

Përkrahja ndërkombëtare ka përmirësuar pozitën e medieve të pakicave, sidomos në serbisht. Producentët e televizionit serb kanë vendosur rrjetin "TV Mreža", duke lidhur katër stacione televizive në gjuhën serbe në Kosovë, duke mbuluar kështu 80% të popullsisë serbe në Kosovë.

Rrjeti radiofonik i Shoqatës së Medieve të Kosovës në serbisht transmetohet në gjithë Kosovën.

Transmetuesi publik (RTK) ka ndarë kohën në nivelin e dispozitës ligjore për programet në gjuhën serbe, rome, boshnjake, gorane dhe turke. Plani për themelimin e kanalit të dytë publik në gjuhën serbe apo gjuhët tjera jo-shqiptare nuk është finalizuar. Fondi për mbështetjen e medieve të pakicave, atyre shumetnike dhe grupeve tjera të veçanta nuk ka qenë funksional qysh prej ndërprerjes së arkëtimit të tarifës së transmetimit publik për RTK-në, me një vendim gjyqësor të tetorit 2009. Si rezultat, 5 përqindëshi i tarifës së përgjithshme i ndarë për këtë fond nuk është më.

Në përgjithësi, është arritur përparim i kufizuar në lidhje me qasjen ndaj arsimit për komunitetet pakicë. Sfida kryesore mbetet mungesa e kurrikulave dhe librave shkollorë në gjuhët e komuniteteve. Mësimdhënësit gjithashtu kanë nevojë për më shumë trajnime aty ku këto kurrikula ekzistojnë. Autoritetet e Kosovës duhet të bëjnë më shumë përpjekje në këtë fushë, sidomos në ndarjen e resurseve adekuate për arsimimin e komuniteteve pakicë. Pak përparim mund të raportohet në lidhje me përdorimin e gjuhëve. Zbatimi i kornizës ligjore është joadekuat. Shërbimet publike shumëgjuhëshe nuk janë vendosur. Pozita e medieve të pakicave, sidomos në serbisht, është përmirësuar.

Sa i përket komuniteteve **rom, ashkali dhe egjiptas** (RAE), është arritur përparim i përzier. Në tetor të vitit 2010, kampi i kontaminuar me plumb në Çesmin Lug është mbyllur dhe gjitha banesat aty janë rrënuar. Banorët e këtij kampi, bashkë me familje tjera nga Osterode janë vendosur në Mëhallën Rome në jug të Mitrovicës, ku autoritetet komunale kanë ndarë tokën për banim. Qeveria ka promovuar regjistrimin civil të këtyre komuniteteve, duke përfshirë edhe ofertën për regjistrim pa pagesë. Raporti për zbatimin e Strategjisë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas është nxjerrë. Kosova ka marrë pjesë në Komitetin Drejtues të Dekadës Rome si vëzhguese, duke mundur kështu angazhimin me faktorët kryesorë në çështjet rajonale të romëve.

Kampi Osterode ende nuk është mbyllur, sepse toka publike për banorët e mbetur (nëntë familje) nuk është ndarë ende. Kosova ende nuk ka plan gjithëpërfshirës për rregullimin e vendbanimeve joformale të komuniteteve RAE. Mungesa e regjistrimit të statusit civil është pengesë tjetër serioze ndaj qasjes në shërbime. Riintegrimi i romëve, ashkalijve dhe egjiptasve të riatdhesuar është brengë. Autoritetet duhet të rrisin përkushtimin e tyre për të trajtuar çështjet urgjente që prekin jetët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas, e sidomos qasjen e tyre ndaj arsimit, shëndetësisë, banimit dhe mbrojtjes sociale.

Në përgjithësi, ka pasur ca përparim në integrimin e komuniteteve pakicë. Kosova ka shënuar rezultate të mira me mbylljen e kampit të kontaminuar të Çesmin Lugut dhe me rritjen e regjistrimit civil të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas. Këto përpjekje duhet të vazhdojnë për të nxitur integrimin e tyre socio-ekonomik.

Në fushën e **refugjatëve dhe personave të zhvendosur në vend** (PZHV), mund të raportohet pak përparim. Nga janari deri në dhjetor të 2010-ës, gjithsej 2,261 pjesëtarë të pakicave janë kthyer vullnetarisht në Kosovë, gjë që shënon shkallën më të lartë të kthimit në gjashtë vitet e fundit. Procesi i kthimit vullnetar është ndikuar nga mjedisi i vështirë politik dhe ekonomik në gjysmën e parë të vitit 2011. Buxheti i dedikuar për kthimin vullnetar është zvogëluar në masë të konsiderueshme nga qeveria. Komunitat përballen me vështirësi në ofrimin e banimit social për të kthyerit pa pronë.

Qeveria duhet të rrisë përpjekjet e saj për të marrë udhëheqjen në adresimin e çështjes së PZHV-ve. Komunat si të vetme nuk janë ende në gjendje t'i përgjigjen nevojave imediate dhe afatgjate të PZHV-ve dhe të kthyerve, për shkak të mungesës së fondeve të ndara për atë qëllim. Ka mospërputhje mes strategjive komunale të kthimit dhe planit të veprimit të përgatitur nga Ministria për Komunitete dhe Kthim.

PZHV-të vazhdojnë të përballen me një numër rreziqesh, sidomos me mungesën e dokumentacionit të identitetit personal dhe pronësor, kushtet e mjerueshme të jetesës si dhe mungesën e qasjes në të drejtat themelore socio-ekonomike. Për më tepër, mos-njohja e dokumenteve administrative mes Kosovës dhe institucioneve të Serbisë edhe më shumë ndikon në qasjen ndaj shërbimeve dhe kthimin e pronës tek PZHV-të. Sulmet ndaj të kthyerve janë të rralla. Nëse ndodhin, nuk janë gjithmonë të trajtuara në mënyrë të mirëfilltë nga policia dhe gjyqësori.

Ka nevojë për një strategji të qartë në përballje me rastet e PZHV-ve. Në kuptimin e procesit të kthimit, sfidat kryesore janë problemet e vazhdueshme dhe të vështirësuar socio-ekonomike, arsimi dhe çështjet e pronësisë, mungesa e financimit, tensionet ndëretnike në disa zona, si dhe mungesa e përkushtimit në anën e institucioneve.

Në përgjithësi, procesi i kthimit mbetet sfidë për Kosovën. Qasja e kufizuar ndaj pronës, procedurat e zgjata të rikthimit të pronës, si dhe mundësitë e pakta ekonomike, vazhdojnë të jenë pengesat kryesore ndaj kthimit të qëndrueshëm. Shumë persona të zhvendosur ende jetojnë në kushte të vështira. Prishtina dhe Beogradi duhet të bashkëpunojnë në adresimin e kësaj çështjeje.

Përkritazi me zbatimin e të **drejtave kulturore**, mund të vërehet përparim i kufizuar. Është emëruar Drejtori i Departamentit të Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Kulturës. Sekretariati i Këshillit për Trashëgiminë Kulturore është funksionalizuar. Bashkëpunimi mes ministrive përkatëse dhe ai mes nivelit qendror dhe atij lokal po përmirësohet ngadalë, por duhet intensifikuar dhe menaxhuar në mënyrë më të strukturuar për të siguruar përparim të qëndrueshëm. Policia e Kosovës ka udhëzuar gjitha stacionet rajonale të policisë që të rrisin patrullimet në objektet e trashëgimisë kulturore dhe fetare. Ligjet për Prizrenin dhe për Hoçën e Madhe nuk janë miratuar.

Zbatimi i kornizës legjislative që rregullon mbrojtjen e trashëgimisë kulturore mbetet i dobët. Lista gjithëpërfshirëse e objekteve të trashëgimisë kulturore që kualifikohen për mbrojtje, ashtu siç përcaktohet me ligjin për trashëgiminë kulturore, ende nuk është miratuar. Si rezultat, objektet historike të mbrojtura mbesin të cenueshme. Kjo çon në shkelje të ligjit. Ka nevojë për përkushtim më të madh për planifikimin hapësinor të trashëgimisë kulturore.

Në përgjithësi, ka pasur përparim të kufizuar në fushën e të drejtave kulturore. Kosova ka përmirësuar bashkërendimin dhe ka vendosur në funksion struktura të reja. Zbatimi i kornizës legjislative mbetet i dobët.

2.3. Çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare

Bashkëpunimi me **Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ)** ka vazhduar.

Sa i përket **personave të zhdukur**, që prej shtatorit 2011, rreth 14,000 njerëz ende janë të pagjetur nga konfliktet në rajon. Prej këtyre, rreth 10,000 kanë të bëjnë me konfliktin në

Bosnjë dhe Hercegovinë, 2,000 me konfliktin në Kroaci, si dhe mbi 1,800 me konfliktin në Kosovë.

Kosova ka miratuar ligjin për personat e pagjetur. Ky është korniza e parë ligjore që garanton njohjen e të drejtës për të ditur dhe të drejtën e reparacionit për familjet e të pagjeturve, bashkë me statusin juridik të personave të pagjetur. Grupi Punues për Persona të Pagjetur, forum bilateral që bashkon delegacionet e Beogradit dhe Prishtinës për dialog dhe këmbim informatash mbi personat e zhdukur në Kosovë, ka vazhduar të jetë korniza brenda së cilës autoritetet e Kosovës kanë vazhduar përkushtimin e tyre. Punët e gërmimit dhe deminimit kanë vazhduar në lokacionet Zhilivodë dhe Koshare, ku është pretenduar të jenë varrosur mbetjet mortore të serbëve etnikë. Pjesa më e madhe e punës po kryhet nga Forca e Sigurisë së Kosovës, me përfshirjen e Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur, një trup ndërministror. Ekspertët nga Departamenti Mjeko-Ligjor i EULEX-it, në bashkëpunim me Forcën e Sigurisë së Kosovës, kanë bërë vlerësimet e lokacionit në liqenin e Livoqit dhe afër fshatit Zhilivodë. Operacioni në liqenin Livoq nuk ka gjetur mbetje të personave të pagjetur. Autoritetet e Kosovës duhet të ofrojnë informata të reja nga burimet vetanake në lidhje me varrezat e pohuara.

Mbetjet mortore të paidentifikuara e të ruajtura në morgun e Prishtinës vazhdojnë të jenë shkak për brengosje. Mungesa e një marrëveshjeje formale mes Kosovës dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë është pengesë ndaj qartësisë të pohimeve në lidhje me mbetjet mortore në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

EULEX-i ka vazhduar hetimet e rasteve të krimeve të luftës. Ai ka ndërmarrë një numër operacionesh, duke përfshirë arrestimet dhe dënimet në rastet e krimeve të luftës me përfshirjen e figurave të larta politike. Në lëndën «Geci», një kolegji i përzier i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dënoi katër ish-komandantë dhe anëtarë të UÇK-së me burg me kohëzgjatje mes shtatë dhe pesëmbëdhjetë vjet për (mes tjerash) krime lufte kundër popullsisë civile. Në rastin e Kleçkës, aktakuza është konfirmuar, duke rënduar dhjetë të paditur me akuzat të ndryshme të krimeve të luftës kundër popullsisë civile dhe të burgosurve të luftës më 1999. Në këtë rast, një ish-ministër, i cili është edhe figurë e lartë politike në partinë në pushtet, është arrestuar nga EULEX-i. Rezoluta e miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në lidhje me trajtimin çnjerëzor të njerëzve dhe trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë ka ngritur pretendime serioze në lidhje me konfliktin e vitit 1999. EULEX-i ka themeluar një task-forcë të veçantë me bazë në Bruksel për të hetuar këto pretendime. Autoritetet janë duke bashkëpunuar me EULEX-in në këtë hetim. Kosova ende nuk posedon kapacitetet vetanake dhe përkushtimin politik për të hetuar rastet e krimeve të luftës me autoritetet e veta gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit.

Në përgjithësi, ka pasur përparim të përzier në këtë fushë. Fusha e personave të pagjetur kërkon përkushtim më të madh politik, mbështetur me resurset financiare dhe teknike të siguruara nga qeveria për të siguruar angazhim adekuat. Nëse nuk adresohet në masën adekuate, çështja do të vazhdojë të nxisë urrejtjen, të pengojë pajtimin dhe të ndikojë negativisht në klimën e përgjithshme politike në Kosovë. Autoritetet po bashkëpunojnë me EULEX-in në hetimin e pohimeve të bëra në rezolutën e miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës.

Kushtetuta e Kosovës përcakton përfaqësimin e jashtëm të Kosovës. Por, disa palë insistojnë që pjesëmarrja e Kosovës të jetë me praninë e UNMIK-ut për iniciativat rajonale të nënshkruara nga UNMIK-u. Kjo krijon sfida për pjesëmarrjen rajonale. Kosova nuk ka marrë pjesë në takimet e Bordit të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC) mes qershorit 2010

dhe majit 2011. Megjithatë, ka marrë pjesë si pjesë e delegacionit UNMIK/Kosovë në takimin vjetor të RCC-së në Mal të Zi në qershor të vitit 2011, si dhe në takimin e Bordit në shtator të vitit 2011. Koordinator i ri i zyrës së RCC-së është emëruar në maj. Edhe pse ka një procedurë të harmonizuar që ata që kanë pasaporta të Kosovës të marrin viza për vijimin e aktiviteteve të RCC-së në Bosnjë dhe Hercegovinë, procedura e vizave mbetet e komplikuar dhe e gjatë për ngjarjet tjera rajonale që mbahen atje.

Më 1 janar, Kosova, me UNMIK-un, ka marrë përsipër udhëheqjen e Marrëveshjes për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA). Gjatë periudhës së raportimit, ka organizuar katër takime brenda Presidencës së saj, duke përfshirë një takim në nivel zëvendës ministrash. Brenda dialogut Beograd/Prishtinë, është gjetur një marrëveshje për vulat doganore. Mallrat kanë filluar barten në të dyja drejtimet në shtator.

Kosova ka vazhduar të marrë pjesë në Traktatin e Komunitetit të Energjisë, Marrëveshjen e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit, si dhe Observatorin e Transportit për Evropën Juglindore. Ajo zyrtarisht përfaqësohet në këto tri forume të bashkëpunimit rajonal nga UNMIK-u. Institucionet e Kosovës ndjekin shumicën e takimeve rajonale dhe ndërkombëtare për të cilat kërkohet ndërmjetësimi i UNMIK-ut, duke i mundësuar kështu Kosovës që të mbetet e përfshirë në forumet rajonale/ndërkombëtare.

Kosova ka vazhduar të marrë pjesë si vëzhguese në Kontratën për Investime në Evropën Juglindore (Investment Compact for South-East Europe), e cila është zhvilluar për të përmirësuar klimën e investimeve dhe për të inkurajuar zhvillimin e sektorit privat në rajon, përmes zbatimit të reformave që avancojnë investimet vendore dhe të huaja. Kosova gjithashtu ka vazhduar të jetë plotësisht e përfshirë në projektet zbatuese, si Iniciativa Rajonale për Konkurrencë, e financuar nga BE-ja. Kosova mbështet iniciativën e pajtimit KOMRA.

Procesi i demarkimit me Malin e Zi nuk ka përparuar, pa marrë parasysh ekzistencën e një komisioni me përgjegjësi mu për këtë proces.

Në përgjithësi, duhet gjetur një marrëveshje për zgjidhjen e qëndrueshme të pjesëmarrjes në forumet rajonale të Kosovës edhe Serbisë. Kjo është thelbësore për bashkëpunim përfshirës dhe funksional rajonal. Demarkimi i kufirit me Malin e Zi duhet finalizuar.

3. KRITERET EKONOMIKE

Në vlerësimin e zhvillimeve ekonomike në Kosovë, qasja e Komisionit orientohet nga konkludimet e Këshillit Evropian në Kopenhagë, në qershor të vitit 1993, të cilat theksojnë që Bashkimi kërkon ekzistencën e një ekonomie funksionale tregu si dhe kapacitetin për t'u përballur me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian.

3.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut

Pikat kryesore të politikës ekonomike

Si pasojë e jostabilitetit politik dhe zgjedhjeve të parakohshme, buxheti i vitit 2011 nuk është miratuar nga Kuvendi deri në fund të marsit. Në prill, qeveria miratoi Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), për periudhën 2012-2014. Marrëveshja Stand-By (SBA) me vlerë prej 92.7 milionë SDR (109 milionë Euro), e negociuar me FMN-në në mesin e vitit 2010, doli nga rruga e duhur, sidomos për shkak të rritjes së konsiderueshme të pagave në sektorin

qeveritar. Pas kësaj, u arrit një Program Monitorimi nga Stafi (SMP) me FMN-në, pa ndarje të parave, që do të vazhdojë deri në fund të vitit 2011, i cili u nënshkrua në qershor. SMP-ja, që bëhet me kushtëzim, është një test i rëndësishëm dhe përpjekje për të rifituar kredibilitetin e politikave ekonomike dhe fiskale. Në përgjithësi, përkushtimi ndaj politikave ekonomike me orientim tregu është ruajtur, por janë miratuar masa që kanë shkaktuar çrregullime të rënda në ekonomi. Hartimi dhe zbatimi i një strategjie koherente dhe kredibile ekonomike, që ndërlidh prioritetet e politikave, reformat strukturore dhe shpenzimet publike, mbeten sfida të mëdha.

Stabiliteti makro-ekonomik

Gjendja ekonomike është sfiduese. Rritjet e mëdha të deficitit buxhetor gjatë dy viteve të fundit nuk kanë arritur të nxisin rritjen ekonomike në ndonjë masë të konsiderueshme. Të dhënat për pasqyrat kombëtare për vitin 2010 ende nuk janë vënë në dispozicion, por bilancet e jashtme dhe ato fiskale janë çrregulluar më tutje, shtyrë nga një vit tjetër i zgjerimit të sektorit publik. Rritja e konsumit privat ka mundësi të ketë mbetur e ndrydhur për shkak të dërgesave nga jashtë që kanë mbetur pothuaj të pandryshuara, krijimit të vendeve të pakta të punës si dhe përsheptimit të inflacionit. Kontributi i konsumit fundor të qeverisë në rritjen reale të BPV-së, edhe pse i mbështetur nga rritja nominale e shpenzimeve publike, është kufizuar nga zvogëlimi i vazhdueshëm i konsumit nga donatorit. Investimet qeveritare kanë vazhduar të jenë të gjalla, por ka pasiguri në lidhje me zhvillimin e investimeve private, pasi huadhënia nga bankat dhe rrjedhat hyrëse të kapitalit të huaj janë kanalizuar kryesisht në aktivitete jo-investuese në sektorin e shërbimeve. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve ka funksionuar në mënyrë impulsive, duke shënuar një rritje prej 36%. Me fillim nga një bazë tejet e dobët, ato kanë rritur hisen e tyre në BPV deri në gati një të pestën. Importet e mallrave dhe shërbimeve gjithashtu janë rritur me numra dyshifrorë, edhe pse me një shkallë më të ulët, duke zgjeruar kontributin negativ të neto eksportit me rritje me gati 1 pikë përqindjeje. Statistikat ekonomike kanë mbetur të dobëta, duke pamundësuar vlerësimin gjithëpërfshirës të gjendjes ekonomike.

BPV-ja për kokë banori⁴ vlerësohet të jetë rritur në 2,385 € më 2010, baras me 9.7% të mesatares së 27 shteteve evropiane (9.6% in 2009). Në përgjithësi, rritja ekonomike e Kosovës ka mbetur e dobët dhe e brishtë.

Më 2010, krijuar nga dyfishimi i eksporteve të metaleve bazë, eksporti total i mallrave ka shënuar rritje nominale me më shumë se 70%. Më 2011 ato kanë vazhduar të performojnë mirë, edhe pse rritja e tyre është ngadalësuar në masë të konsiderueshme deri në 19% deri në fund të korrikut. Hisja e eksporteve në BPV është rritur duke shënuar 7.4%, që është ngritje nga shkalla tejet e ulët prej 4.5% më 2009, e nxitur nga kërkesa e fortë e huaj si dhe çmimet e larta të mallrave. Ky trend pozitiv megjithatë maskon një dobësi fundore, pasi metalet bazë kanë rritur hisen e tyre në totalin e eksporteve me gati dy të tretat, duke shfaqur kështu mungesën e diversifikimit dhe dominimin e mallrave më vlerë të shtuar të ulët në strukturën e eksporteve. Importet e mallrave janë rritur me 11% më 2010, si dhe kanë shpejtuar rritjen me 14% deri në fund të korrikut 2011. Hisja e tyre në BPV ka shkuar në 49%, më lart sesa 47.3% më 2009. Struktura e importeve është zhvendosur kah mallrat e ndërmjetme dhe ato të

⁴ Masa me PPP nuk është në dispozicion për Kosovën. Kalkulimi bazohet në vlerësimet e popullsisë nga regjistrimi i popullsisë së vitit 2011.

konsumit, duke ulur mallrat kapitale.

Shkalla e mbulimit, pra eksporti i mallrave si përqindje e importit (mesatare e lëvizshme 12-mujore) është rritur, si dhe ka qëndruar në shifrën prej 14.1% në korrik të vitit 2011. Neto eksporti i mallrave ka shënuar performancë më të mirë sesa më 2009, por deficitin në mallra dhe shërbime është përkeqësuar, nga 39.2% e BPV-së më 2009 në 40.5% më 2010. Suficiti në shërbime ka rënë në masë të madhe për shkak të rritjes së konsiderueshme të importimit të shërbimeve të ndërtimitarisë me fillim në tremujorin e dytë të vitit 2010. Në shtatë muajt e parë të vitit 2011, deficitin tregtar është zgjeruar deri në shumën prej 1,122 milionë €, krahasuar me 992 milionë € në periudhën përkatëse të vitit të kaluar, pasi rritja në anën e eksportit është lënë në hije nga rritja e importit të mallrave.

Më 2010, deficitin aktual në llogari (duke përfshirë transferet zyrtare) është zgjeruar të mbulojë 16.0% të BPV-së, që është rritje nga 15.4% më 2009. Kjo rritje është nxitur kryesisht nga përkeqësimi i llogarisë së shërbimeve. Në të njëjtën kohë, suficiti në llogarinë e të ardhurave është përmirësuar në 3.1% të BPV-së, derisa rrjedhat dalëse të të hyrave nga investimet kanë rënë me 40% në krahasim me vitin e kaluar. Transferet rrjedhëse kanë mbetur të konsiderueshme duke përbërë 21.6% të BPV-së. Dërgesat e diasporës neto, një burim madhor i financimit të kërkesës vendore, janë rritur me rreth 6%, por pjesa e tyre në BPV ka mbetur gati e pandryshuar, në 10.2%. Suficiti tek llogaritë e kapitalit dhe financiare (12.3% e BPV-së) ka mbetur prapa madhësisë së deficitit të llogarisë rrjedhëse. Neto investimet e huaja direkte janë rritur deri në 7.5% të BPV-së, një e treta e të cilave është injektuar në prona të paluajtshme dhe ndërtimtari, derisa 22% në shërbime financiare. Ka pasur një ngritje me rreth 50% të rrjedhave hyrëse të investimeve të huaja direkte në prodhimtari, të ndërlidhur më shumë me përfundimin e marrëveshjeve të privatizimit sesa më investimet prej fillimit. Gjatë vitit 2010, valutat dhe depozitat e mbajtura jashtë vendit janë konvertuar në investime me portfolio jashtë vendit (kapital dhe sigurime borxhi). Kjo është përcjellë me një rritje të aseteve në rezervën e bankës qendrore. Neto gabimet dhe mangësitë prej 3.7% të BPV-së janë të larta në krahasim me shifrën prej 1.5% më 2009, si dhe përbëjnë problem kur vjen puna tek analiza e mirëfilltë e zhvillimeve ekonomike. Në përgjithësi, debalancet e jashtme janë të larta, sidomos në tregtinë me mallra, si dhe rrjedhat hyrëse të investimeve të huaja në avancim të prodhimtarisë kanë mbetur të kufizuara.

Papunësia ka qenë tejet e lartë, në shifrën prej 45.4%, sipas të dhënave më të fundit zyrtare nga Anketa e Fuqisë Punëtore 2009. Nuk ka të dhëna për shkallën e papunësisë më 2010, sepse Anketa e Fuqisë Punëtore është anuluar për shkak të kufizimeve financiare. Më 2010, numri i të papunëve të regjistruar është zvogëluar me rreth 1%, kryesisht në segmentin e të pakualifikuarve. Megjithatë, deri në fund të qershorit 2011, të papunët e pakualifikuar ende përbënin 60% të totalit të punëkërkuarve të regjistruar. Të papunët me arsim universitar, edhe pse përbëjnë numër të vogël, janë rritur në numër duke iu afruar shifrës 4,000, duke sinjalizuar kështu problemet në funksionimin si dhe lidhjet mes tregut të punës dhe sistemit arsimor. Të dhënat nga Trusti i Kursimeve Pensionale tregojnë që më 2010, numri i kontribuuesve është rritur me 2.3%, apo 5,213 persona, të ndarë gati në masë të barabartë mes sektorit qeveritar dhe atij jo-qeveritar. Statistikat në dispozicion nuk ofrojnë një pasqyrë të vërtetë të tregut të punës, sidomos duke marrë parasysh shkallën e konsiderueshme të punësimit joformal. Në përgjithësi, informatat për tregun e punës janë të pakta, derisa vazhdojnë të ekzistojnë dyshime për saktësinë e tyre. Papunësia ka mbetur tejet e lartë dhe ekonomia nuk ka krijuar vende të mjaftueshme pune për të zvogëluar presionin mbi tregun e punës dhe për të ofruar mundësi punësimi, sidomos për të rinjtë që kanë hyrë në treg.

Inflacioni mesatar vjetor më 2010 ishte 3.5%. Shkallët mujore të inflacionit u përshpejtuan në

masë të madhe që nga mesi i vitit 2010, si dhe në tremujorin e parë të vitit 2011. Deri në mars 2011, inflacioni ishte rritur me numra dyshifrorë prej 10.8% (vit pas viti), derisa u ngadalësua dhe mbeti në shifrën ende të lartë prej 5.3% deri në fund të gushtit. Çmimet e ushqimit qenë kontribuuesit kryesorë të inflacionit me 3.5 pikë përqindjeje, pasuar nga produktet e lidhura me energjinë që patën 0.9. Inflacioni thelbësor (jo-ushqimor dhe jo-energjetik) arriti pikën e lartë prej 1.6% në maj, pas një periudhe të zakonshme kur qëndronte nën 1%, nxitur mes tjerash edhe nga premtimi i qeverisë për të rritur në masë të konsiderueshme pagat e sektorit qeveritar. Rreth 90% e gjitha mallrave në shportën e konsumatorit shfaqën çmime të rritura, duke treguar kështu presioni inflacioni me bazë të gjerë. Niveli dhe struktura e inflacionit kanë goditur të varfrit në mënyrë disproporcionale, derisa i kanë ndrydhur skemat e konsumit që varen nga dërgesat nga jashtë. Në përgjithësi, inflacioni ka qenë i luhatshëm dhe është ngritur në nivele të larta.

Kosova përdor Euron si valutë ligjore. Rrjedhimisht, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka kufizim në instrumente politikash. Rritja në paranë e gjerë (definicioni i FMN-së⁵) ka qëndruar në masën prej 18.7% deri në fund të korrikut 2011. Dinamika e saj përgjatë periudhës është ndikuar nga zvogëlimi i depozitave publike të korporatave jo-financiare për shkak të tërheqjes së dividendëve të kompanisë publike të telekomunikacionit nga qeveria. Monetizimi i ekonomisë, matur nga raporti i parasë së gjerë mesatare me BPV-në, është rritur pak, nga 39.8% më 2009 në 40.4% më 2010. Mbikëqyrja më e rreptë e bankave ka çuar në riklasifikimin e disa kredive si dhe në rritjen e kredive të këqija, të cilat kanë arritur shifrën prej 5.9% të totalit të kredive deri në mes të vitit 2011. Banka qendrore ka vendosur institucionin më të madh mikrofinanciar nën administrimin e saj të drejtpërdrejtë. Ky rast ka vënë në pah dobësitë në legjislacion, veçanërisht ato në lidhje me licencimin e institucioneve mikrofinanciare. Në përgjithësi, korniza monetare ka vazhduar të funksionojë relativisht mirë, edhe pse ka hapësirë për përmirësim, sidomos në rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit financiar.

Deficiti buxhetor është rritur nga 0.7% të BPV-së më 2009 në 2.7% më 2010, shtyrë nga shpenzimet në rritje dhe dividendëve të pranuar në zvogëlim. Deficiti në sfond ka qenë shumë më i lartë - 5.5% e BPV-së – nëse merren parasysh pranimet e njëhershme, sidomos dividendë prej 85 milionë eurosh dhe granti buxhetor prej 30 milionë eurosh. Përveç këtyre, ka pasur një rritje të konsiderueshme të faturave të papaguara, të cilat kanë qëndruar në masën prej 0.7% të BPV-së deri në fund të vitit 2010. Të ardhurat e përgjithshme (duke përjashtuar dividendët dhe grantet) janë rritur me rreth 1 pikë përqindjeje për të arritur në 25.3% të BPV-së. Totali i shpenzimeve primare është rritur me rreth 0.7 pikë përqindjeje për të arritur në 30.7% të BPV-së. Dy të tretat e të ardhurave themelore kanë vazhduar të arkëtohen si tatime kufitare mbi konsumin, derisa të ardhurat direkte tatimore janë zvogëluar, jo vetëm në terma relativë, por edhe në ato absolutë. Shpenzimet rrjedhëse kanë arritur masën prej 18.1% të BPV-së, në krahasim me 17.7% më 2009, përforcuar kjo me rritjen e fortë të shpenzimeve në paga e mëditje. Transferet sociale janë rritur me 0.3 pikë përqindjeje deri në 4.8% të BPV-së. Gjithsej subvencionet, transferet kapitale dhe neto-huatë për ndërmarrjet publike janë ulur me 1.3 pikë përqindjeje për të arritur tek 3.2% të BPV-së, për shkak të zvogëlimit të shpenzimeve në Korporatën Energjetike të Kosovës. Shpenzimet kapitale janë rritur nga 9.9% në 10.7% të BPV-së, edhe pse gjitha kategoritë e shpenzimeve kapitale, përveç atyre që kanë të bëjnë me ndërtimin e autostradës që lidh Prishtinën dhe Tiranën, janë shkurtuar në masë të konsiderueshme me 2.2% të BPV-së. Depozitat e qeverisë në bankën

⁵ Përfshirë depozitat që përjashtohen nga paraja e gjerë.

qendrore kanë rënë nga 342 milionë euro (8.7% të BPV-së) më 2009 në 244 milionë euro (5.9%) në fund të vitit 2010. Borxhi qeveritar ndaj Bankës Botërore dhe FMN-së ka qëndruar në masën prej 6.2% të BPV-së.

Për shkak të shpërbërjes së parakohshme të parlamentit, buxheti i vitit 2011 është vonuar dhe nuk është miratuar nga Kuvendi i ri deri në mars. Ai parashikon rritje me 17% të të ardhurave (duke përfshirë dividendët dhe grantet) gjatë vitit 2010, 17.2% më shumë shpenzime primare në total, si dhe deficit buxhetor prej 227 milionë eurosh (4.7% të BPV-së). Buxheti parashikon që ai deficit të financohet nga grantet direkte, pagesat e pranuar nga shitja e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës (PTK), si dhe huamarrja nga institucionet financiare ndërkombëtare, shumica e të cilave kanë pak mundësi të realizohen më 2011. Në tetë muajt e parë të vitit 2011, ekzekutimi buxhetor ka shënuar performancë të fortë në të ardhurat tatimore (17% rritje vjetore), nxitur kryesisht nga importet po aq të forta të mallrave. Në tremujorin e parë, shpenzimet kanë mbetur prapa, sidomos në nivelin komunal, por deri në fund të gushtit, shpenzimet në total janë shpejtuar dhe janë rritur me më shumë se 24%. Buxheti u kthye në deficit prej 16.6 milionë eurosh kryesisht për shkak të rritjeve veçanërisht të mëdha të shpenzimeve në paga dhe mëditje (25%) dhe shpenzime kapitale (61%). Ministria e Financave ka ndërmarrë hapa në përmirësimin e transparencës së ekzekutimit të buxhetit si dhe ka filluar të regjistrojë informata paraprake mujore për të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore në faqen elektronike të saj. Megjithatë, transparenca buxhetore do të mund të përmirësohej më shumë. Në *përgjithësi*, financimi i buxhetit 2011 po përballlet me rreziqe të konsiderueshme.

Më 2010, në një përpjekje për të racionalizuar dhe për të siguruar parashikueshmëri të politikave ekonomike, Kosova kishte nënshkruar Marrëveshjen Stand-By me FMN-në. Marrëveshja mundësonte hapësirë dhe kohë të mjaftueshme për përshtatje të bilanceve negative fiskale. Megjithatë, pas një numri masash ad-hok, programi doli nga rruga e tij. Përveç Ligjit të Punës që u miratua në seancën e fundit të Kuvendit të kaluar, një numër iniciativash, me ndikime potencialisht të konsiderueshme negative në nivelin dhe cilësinë e shpenzimeve qeveritare, janë marrë pa analiza paraprake të ndikimeve të tyre ekonomike dhe buxhetore.

Vendimi i qeverisë për rritjen substanciale të pagave të punëtorëve qeveritarë (me 30 deri në 50%), më vonë i inkorporuar në buxhetin e vitit 2011, përkundër kundërshtimeve të Komisionit Evropian dhe FMN-së, ishte shumë dëmtes ndaj qëndrueshmërisë fiskale dhe cilësisë së shpenzimeve. Në mesin e korrikut 2011, qeveria hyri në një marrëveshje të re me FMN-në – një Program me Monitorim nga Stafii (SMP), pa ndarje buxhetore, i cili planifikohet të vazhdojë deri në fund të vitit 2011. Sipas programit, qeveria është përkushtuar ndaj masave të konsolidimit prej 35 milionë eurosh, si dhe ndarjes së një rezerve prej 60 milionë eurosh si shpenzime të pazotuar për vitin 2011, lirimi i të cilave ndërlidhet me shpalljen e fituesit të tenderit të privatizimit të PTK-së. Kjo rezervë është qenësore për ruajtjen e një niveli minimal të bilanceve bankare të qeverisë deri në fund të vitit 2011. Megjithatë, mbajtja e tyre ka mundësi të nënkuptojë shkurtime të shpenzimeve kapitale që nuk bëhen për autostradë, e cila është një prej kategorive shpenzuese me shkallën më të lartë të avancimit të rritjes. Zbatimi i SMP-së është një test i rëndësishëm, si dhe një përpjekje për të rikthyer kredibilitetin e politikave ekonomike dhe fiskale. Në *përgjithësi*, planifikimi fiskal dhe cilësia e financave publike është përkeqësuar më tutje, derisa parashikueshmëria, konsistenca dhe transparenca e politikave mbesin sfida serioze.

Zhvillimi ekonomik ka vazhduar të vulozet nga rritja e brishtë dhe bilancet e konsiderueshme negative vendore dhe të jashtme, rënduar tutje nga politikat e dobëta fiskalë. Në veçanti,

inflacioni i lartë dhe tregu jofunksional i punës përbëjnë sfida madhore për kohezionin ekonomik dhe social, derisa pasiguria e konsiderueshme ekonomike ka mbetur pengesë për krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e sektorit privat. Më 2011, në një përpjekje për të korrigjuar disa prej mangësive madhore të politikave, qeveria doli me një vizion ekonomik si dhe plan të veprimit për reformë ekonomike. Kjo është e lavdërueshme për sa i përket rolit udhëheqës që i është dhënë sektorit privat në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Megjithatë, planit i mungon caktimi i prioritetëve dhe renditja e masave të propozuara. Ai bazohet në një skenar optimist makroekonomik. Vlerësimet e kujdesshme dhe analizat e mirëfillta të ndikimit fiskal të shumicës së masave të tij ende nuk janë bërë. Përveç këtyre, synimi i plani për deficit buxhetor afatmesëm prej 2% të BPV-së nuk është në përputhje me deficitin prej 0.5% të parashikuar me KASH. *Në përgjithësi*, funksionimi i mirëfilltë i përzjerjes së politikave makroekonomike po kërcënohet përditë e më shumë nga politikat e paparashikueshme fiskale dhe rritja e paqëndrueshme e shpenzimeve qeveritare.

Ndërveprimi i faktorëve në treg

Rreth 90% e ndërmarrjeve publike (NP) kanë dalë me fitime operationale më 2010, por disa kompani të mëdha të energjisë dhe minierave kanë vazhduar të shënojnë humbje të mëdha, duke shpenzuar kështu buxhetin në masë të konsiderueshme. Agjencia Kosovare e Privatizimit ka vazhduar privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore (NSH). Janë privatizuar kryesisht biznese të vogla, me përjashtim të një fabrike të mëdha çimentoje (e cila do të sigurojë punësim për 500 punëtorë për tri vjet). Përparim i kufizuar është arritur në likuidimin e NSH-ve – vetëm një më 2010. Privatizimi i ndërmarrjeve publike ishte ndërprerë përkohësisht për shkak të shpërbërjes së parakohshme të parlamentit. Procesi i privatizimit të PTK-së rifilloi në pranverë. Në qershorin e vitit 2011, dy kompani nga pesë që kishin shprehur interesim, u kualifikuan për fazën e radhës. Në shtator, qeveria dha edhe dy javë të tjera për shprehjen e interesimit për kompanitë që nuk ishin kualifikuar në qershor. Kjo zgjatje ka potencial të dëmtojë kredibilitetin e procesit të privatizimit. Edhe privatizimi i degëve të Distribucionit dhe Furnizimit në KEK (KEDS) ka vazhduar, ku katër kompani janë parakualifikuar për të marrë pjesë në proces. Transaksioni për ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re (TCKR) ka vazhduar të përballet me vonesa, pjesërisht në lidhje me modelin e ardhshëm të tregut të energjisë, si dhe marrëveshjes afatgjate për blerjen e energjisë mes TCKR-së dhe KEDS-së, e cila pritet të finalizohet në hollësitë e saj. *Në përgjithësi*, ka pasur ca progres me procesin e privatizimit, sidomos në lidhje me ndërmarrjet publike.

Hyrja dhe dalja nga tregu

Regjistri i bizneseve tani numëron 105,000 kompani. Të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) tregojnë që rreth gjysma e tyre nuk janë aktive. Për t'u çregjistruar pas të qenit joaktive, kompanitë duhet të dorëzojnë tek regjistri i bizneseve një vërtetim nga ATK-ja që kanë përmbushur gjitha obligimet e mbetura tatimore. Deri tani, regjistrimi në internet i kompanive është i mundur vetëm në qendrat 'one stop shop', apo qendrat komunale të biznesit, të cilat janë themeluar në 22 komuna. Bizneset kanë vazhduar të vuajnë nga reduktimet e energjisë, derisa shumica e firmave kanë identifikuar korrupsionin dhe burokracinë si pengesat më madhore ndaj biznesit. Si pjesë e planit të saj të veprimit për zhvillim ekonomik, qeveria ka shpallur qëllimin e saj për përmirësimin thelbësor të mjedisit të biznesit. Në këtë drejtim, ajo planifikon një numër masash, duke përfshirë reformën gjithëpërfshirëse për heqjen e 50% të kërkesave për leje e licenca, në afat të mesëm. *Në përgjithësi*, administrata e dobët, furnizimi i paqëndrueshëm elektrik, si dhe mangësitë në sundimin e ligjit kanë vazhduar të pengojnë hyrjen dhe daljen nga tregu.

Sistemi juridik

Sistemi juridik ka vazhduar të vuajë nga qasja dhe efikasiteti i mangët. Zbatueshmëria e dobët e kontratave ka mbetur një prej brengave kryesore të kompanive dhe investitorëve në Kosovë. Kjo është gjithashtu një prej faktorëve që shpjegon shkallët relativisht të larta të interesit që vendosen nga bankat komerciale për sektorin privat. Sistemi gjyqësor i Kosovës, në bashkëpunim me EULEX-in, është duke hetuar disa raste korruptive të profilit të lartë. Disa zyrtarë të lartë dhe politikanë janë dënuar tashmë.

Ka pasur ca përparim në lidhje me infrastrukturën e të drejtave pronësore. Gjitha Zyrat Kadastrale Komunale tanimë janë lidhur me Agjencinë qendrore Kadastrale të Kosovës, derisa dokumentet janë në dispozicion në të dyja vendet. Gjatë disa viteve të fundit, edhe transaksionet e regjistruara edhe hipotekat janë rritur në numër, duke treguar kështu shfrytëzimin e pronës si peng apo kolateral. Më 2010 janë regjistruar gjithsej 5,364 hipoteka, si dhe 2,712 në tetë muajt e parë të vitit 2011. Zyrrat Komunale Kadastrale iu duhen diku rreth 15 ditë që të regjistrojnë një transaksion. Disa regjistra kadastralë mbeten në Serbi. Është arritur një marrëveshje për kadastrën në kuadër të dialogut Beograd/Prishtinë. Marrëveshja duhet të zbatohet. Procedurat e shpronësimit jo gjithmonë aplikohen, derisa pronarët e pronave jo gjithmonë konsultohen apo kompensohen në masë adekuate. Në *përgjithësi*, korniza ekzistuese ligjore është e pazhvilluar, derisa zbatimi i saj mbetet i dobët. Zbatimi i vështirë, i gjatë dhe i kushtueshëm i kontratave, si dhe korrupsioni i përhapur, kanë vazhduar të pengojnë mjedisin afarist.

Zhvillimi i sektorit financiar

Sektori financiar është zgjeruar me 13.7% më 2010, duke çuar vlerën totale të aseteve në 3.2 miliardë euro, apo rreth 78% të BPV-së. Sektori bankar është dominues, si dhe përbën 77% të gjitha aseteve, pasuar nga fondet pensionale (15.4%), institucionet mikrofinanciare (4.3%), kompanitë e sigurimit (3.1%) si dhe ndërmjetësit financiarë (0.2%). Numri i bankave komerciale (tetë), fondeve pensionale (dy) dhe kompanitë e sigurimeve (njëmbëdhjetë) ka mbetur i njëjtë, derisa dy institucioneve mikrofinanciare iu është revokuar licenca më 2010 (duke zvogëluar numrin e tyre në 17). Shkalla e koncentrimit të sistemit bankar mbetet e lartë, ku 77.4% e aseteve menaxhohet nga tri banka. Rreth 90% e aseteve në sektor mbahen nga bankat në pronësi të huaj. Më 2010, nxitur nga rritja e të ardhurave nga interesi, profiti i mbetur i sektorit bankar është rritur me 30%. Kthimi mbi asetet mesatare ka mbetur i pandryshuar në 1.4%, derisa kapitali mesatar i kthimit është rritur deri në 14.9%, krahasuar me atë prej 13.9% më 2009. Kreditë e këqija (joperformuese) janë rritur nga 4.3% e totalit të kredive më 2009 në 5.9% në mesin e vitit 2011, por raporti i përshtatshmërisë së kapitalit të sistemit bankar ka mbetur solid, mbi 17%. Derisa të ardhurat nga interesi kanë vazhduar me rritje të moderuar në gjysmën e parë të vitit 2011, provizionet për kredi dhe humbje në asete tjera janë dyfishuar në krahasim me periudhën e njëjtë më 2010, si dhe kanë ndryshuar kështu profitabilitetin. Në *përgjithësi*, ndërmjetësimi financiar ka vazhduar të thellohet, si dhe përkundër rritjes së kredive të këqija, sektori bankar ka mbetur stabil dhe profitabil.

Kredidhënia ka fituar pak shpejtësi, duke u rritur me 13.2% (vit pas viti) më 2010 në 35% të BPV-së. Rritja e saj është shpejtuar deri në 15.3% deri në fund të korrikut 2011, ku rritja e kredidhënies vjetore edhe për amvisëritë edhe për korporatat jo-financiare ka qenë dyshifrore - 17.2% dhe 13.2%. Gati e gjithë huadhënia e rritur për korporata ka shkuar në sektorin e shërbimeve, sidomos në tregtinë me shumicë e pakicë, e pjesërisht edhe në sektorin e ndërtimit. Hisja e ekspozimit të huadhënies ndaj prodhimit dhe bujqësisë është zvogëluar gjatë periudhës, duke reflektuar nivelin e ulët të prodhimit vendore dhe varësinë e madhe

të ekonomisë nga importet. Maturimi i huave është zgjeruar paksa, derisa huatë me maturim më të gjatë se dy vjet është rritur në 73% të portofolit të përgjithshëm të huave më 2010, rritur nga 70% më 2009. Ky trend është kthyer prapa në maj, pas një ngritjeje të mprehtë të huadhënies deri në dy vjet, derisa segmentet e huadhënies afatgjate kanë stagnuar.

Më 2010, depozitat e përgjithshme janë rritur deri në 47.1% të BPV-së, krahasuar me 44.6% më 2009. Struktura e depozitave dhe shkallët e rritjes së tyre janë çrregulluar, për shkak të tërheqjeve të konsiderueshme të depozitave të korporatave jo-financiare publike në lidhje me pagesat e dividendëve të PTK-së. Depozitat totale janë rritur me 15.7% deri në fund të korrikut. Depozitat e amvisërisë, të cilat përbënin rreth 70% të totalit, kanë pasur një rritje befasisht të fortë, duke u rritur me rreth 18%. Raporti mes huave dhe depozitave është rritur gjatë 2010-ës në 75.3%, e prapë më tutje në 81.2% në korrik të vitit 2011, afër pragut joformal prej 80% të raportit hua-depozita. Shkalla mesatare efektive e lëvizshme e interesit mbi depozita ka pasur një rrugëtim qartësisht tatëpjetë, si dhe ka qëndruar tek shifra prej 3.5% në korrik. Shkalla mesatare efektive e interesit mbi huatë gjithashtu është ulur paksa në 14.5%, por shpërndarja mesatare ka mbetur mbi 11 pikë përqindjeje. Në përgjithësi, baza e depozitave dhe aktiviteti kreditor ka vazhduar të rritet, por kushtet e huadhënies kanë mbetur të shtrënguara.

3.2. Kapaciteti i përballjes me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian

Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut

Stabiliteti makroekonomik po kërcënohet përditë e më shumë nga politikat e paparashikueshme fiskale në një mjedis të bilanceve negative të vazhdueshme dhe në rritje, vendore e të jashtme. Cenueshmëria e përzierjes së politikave është rritur, për shkak të deficitit të konsiderueshëm buxhetor, si dhe opsioneve të kufizuara financuese. Papunësia është tejet e lartë, gjë që tregon problemet e thella strukturore në ekonomi. Në përgjithësi, sundimi i dobët i ligjit, korrupsioni, niveli i lartë i veprimtarisë joformale, si dhe politikat ad-hok kanë rritur pasigurinë ekonomike, derisa problemet e thella strukturore kanë vazhduar të pengojnë ekonominë.

Kapitali njerëzor dhe fizik

Ca përparim është arritur në qasjen në arsim, duke marrë parasysh investimet e konsiderueshme në infrastrukturën shkollore, sidomos për arsimin fillor (klasat 1-9). Arsimi është një prej programeve më të mëdha qeveritare, duke marrë rreth 13% të shpenzimit total (3.9% të BPV-së), edhe pse resurset që i ndahen sektorit mbeten prapë relativisht të ulëta. Për shkak të proporcionit të lartë të fëmijëve në moshë shkollore në popullsinë e Kosovës, shpenzimet për nxënës mbesin edhe më shumë prapa. Më se gjysma e gjithë mësimit në shkollat fillore dhe të mesme kanë vetëm shkollim të mesëm ose të lartë. Rezultatet arsimore janë përgjithësisht të dobëta. Rreth 42% e gjithë nxënësve të shkollave të mesme kanë arritur të kalojnë provimin përfundimtar (Matura) më 2011 në rrethin e parë në qershor, derisa kalueshmëria e nxënësve të shkollave profesionale ka qenë vetëm 25%. Më 2010, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka hartuar një strategji gjithëpërfshirëse të sektorit (2011-2016), e cila thekson rëndësinë e një sistemi përfshirës arsimor, duke zgjeruar qasjen ndaj arsimit fillor dhe atij të mesëm të lart, si dhe duke rishikuar planet për zgjerimin e arsimit parashkollor. Në gusht të vitit 2011, qeveria miratoi zyrtarisht atë strategji. Kosova ende nuk ka të dhëna të sakta të numrit të studentëve dhe shkallës së punësimit të të diplomuarve. Shkollat vazhdojnë të punojnë me disa ndërtime.

Kapaciteti huluntues i universiteteve dhe instituteve kërkimore mbetet tejte i dobët. Agjencia për Promovim të Investimeve dhe ajo për Ndërmarrje të Vogla e të Mesme (NVM) kanë hartuar një katalog elektronik të institucioneve arsimore në Kosovë, me qëllim të avancimit të bashkëpunimit dhe bartjes së ekspertizës dhe teknologjisë tek NVM-të. *Në përgjithësi*, sektori arsimor ende ndikohet nga mungesa e infrastrukturës adekuate, si dhe karakterizohet me rezultate të dobëta.

Totali i investimeve ka qëndruar në shifrën prej 30% të BPV-së më 2010, gati i pandryshuar gjatë vitit të kaluar. Investimet publike (kryesisht në infrastrukturë rrugore) janë zgjeruar, por rritja e investimeve private duket të jetë shkurtuar, duke gjykuar nga zvogëlimi vjetor prej 13% i importit të mallrave kapitale. Ndërtimi i autostradës drejt Tiranës ka vazhduar, derisa 34 kilometrat e parë janë paraparë të hapen për trafik deri në fund të tetorit 2011. Megjithatë, përmasa e projektit nuk është proporcionale, as me parashikimet e trafikut e as me resurset në dispozicion, si dhe po lë anash shpenzimet tjera. Nuk është bërë aq shumë në përmirësim të infrastrukturës dhe efikasitetit të energjisë. *Në përgjithësi*, ka pasur përmirësime marginale në kapitalin fizik. Efikasiteti i shpenzimeve kapitale qeveritare mund të vihet në pikëpyetje, derisa informatat për nivelin dhe strukturën e investimeve private kanë mbetur të pakta.

Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

Sektori kosovar i ndërmarrjeve mbetet i dominuar nga ndërmarrjet e vogla dhe mikrondërmarrjet. Rreth 99.7% të ndërmarrjeve punësojnë më pak se 50 punëtorë, duke kontribuar rreth 60% të totalit të qarkullimit në ekonomi. Qasja si dhe kostoja e financave ka mbetur problematike, kryesisht për shkak të rreziqeve të larta në ekonomi. Masat për përmirësimin e qasjes në financa për NVM-të janë parashikuar në strategjinë për NVM, miratuar në korrik 2011.

Për të tërhequr investitorë, qeveria është duke marrë parasysh marrëveshjet afatgjate për blerjen e energjisë deri në 20 vjet, mes kompanisë së re të gjenerimit dhe kompanisë për distribucion e furnizim. Në një drejtim të ngjashëm, ajo është duke menduar rekomandimin e një ndalesë të mundshme shumëvjeçare të hyrjeve të reja në treg të operatorëve të telefonisë mobile. Masat si këto do të pengonin konkurrencën. Më 2010, raportet e faturimit dhe arkëtimit të KEDS-së janë përmirësuar paksa, mbështetur nga mosrritja e çmimeve të energjisë elektrike, por ende mbesin të ulëta.

Sektori joformal nxitet nga mangësitë e politikave tatimore dhe shpenzuese, si dhe në zbatimin e ligjit, duke përfshirë luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Këto zvogëlojnë bazën tatimore dhe efikasitetin e politikave ekonomike. Si masë për luftimin e ekonomisë joformale, administrata tatimore e Kosovës ka vazhduar të japë numra fiskalë, si dhe të instalojë arka fiskale. Megjithatë, këto arka ende nuk përdoren sistematikisht. *Në përgjithësi*, struktura e ndërmarrjeve ka mbetur e pandryshuar. Sektori i madh joformal përbën një sfidë të madhe.

Ndikimi i shtetit në konkurrueshmëri

Është miratuar Ligji për ndihmën shtetërore në korrik të vitit 2011. Sipas këtij ligji, ndihma shtetërore do të ofrohet kryesisht për qëllime sociale. Ligji parashikon që Komisioni për Ndihmë Shtetërore të miratojë ndihmën shtetërore, e cila do të monitorohet nga Komisioni për Konkurrencë. Subvencionet buxhetore dhe transferet e kapitalit tek ndërmarrjet publike kanë arritur shifrën prej 1.7% të BPV-së më 2010, në krahasim me shifrën e lartë prej 2.4% më 2009. Një sasi tjetër prej 1.5% e BPV-së është kanalizuar për të mbështetur programin e

investimeve të Korporatës Energjetike të Kosovës. Çmimet e energjisë elektrike kanë mbetur të pandryshuara, nën nivelet e mbulimit të kostos. Qeveria ka vendosur një skemë të kufizuar grantesh, të përbërë nga pagesat e dyzuara për bujqit e drithërave dhe blegtorët si dhe grantet përcjellëse për sektorët e bulmetit, pemëtarisë dhe perimtarisë në nivele fermash. Ajo gjithashtu ka paraqitur planet për rritjen substanciale të subvencioneve direkte të cilat, në kuptimin e nivelit të zhvillimit të sektorit, mund të jenë joefikase në krahasim me masat tjera mbështetëse më strukturore. Në përgjithësi, ndërhyrja e shtetit në ekonomi ka mbetur e lartë, por gjerësisht e pandryshuar.

Integrimi ekonomik me BE-në

Hapja e ekonomisë, matur me vlerën e importeve dhe eksporteve të mallrave e shërbimeve në raport me BPV-në, është rritur në 81.2% nga 70.5% më 2009. Eksportet drejt Shteteve Anëtarë të BE-së janë zgjuar nga një rënie e vitit 2009, si dhe janë rritur me 84%, duke marrë 45% të totalit të eksporteve të mallrave. Eksportet drejt vendeve të CEFTA-s janë rritur me 33%, edhe pse pjesa e tyre ka rënë nga 32% në 24%. Qysh prej fillimit të vitit 2011, pas skadimit të masave autonome të tregtisë, si dhe për shkak të vonësës në rivendosjen e tyre, Kosova nuk përfiton më nga qasja preferenciale ndaj tregut të BE-së. Vendet e BE-së dhe CEFTA-s kanë mbetur origjina kryesore për importet e Kosovës, me hise prej 38.3% (39% më 2009), respektivisht 37.2% (35.8% më 2009). Me rreth dy të tretat e rrjedhave të reja hyrëse të investimeve të huaja më 2010, vendet e BE-së kanë qenë investitorët më të mëdhenj në Kosovë. Në përgjithësi, integrimi ekonomik me BE-në mbetet i konsiderueshëm.

4. STANDARDET EVROPIANE

Kjo pjesë trajton kapacitetin e Kosovës për përafrimin gradual të legjislacionit dhe politikave të saj me ato të *acquis* në lidhje me tregun e brendshëm, politikat sektoriale dhe drejtësinë, lirinë dhe sigurinë, në përputhje me Procesin e Stabilizim-Asocimit, si dhe prioritetet e Partneritetit Evropian. Ajo gjithashtu analizon kapacitetin administrativ të Kosovës. Në secilin sektor, vlerësimi i Komisionit mbulon përparimin e shënuar gjatë periudhës së raportimit, si dhe përmbledh nivelin e përgjithshëm të gatishmërisë së Kosovës.

4.1. Tregu i brendshëm

4.1.1. Lëvizja e lirë e mallrave

Ka pasur përparim të kufizuar në fushën e **standardizimit**. Katër komisione të reja për agro-shqimet, lëkurën, lodrat dhe rekreacionin, si dhe teknologjinë informative, janë themeluar, duke çuar numrin e përgjithshëm të atyre komisioneve në 18. Është miratuar edhe një Udhëzim administrativ për organizimin dhe funksionimin e këtyre komisioneve teknike. Deri më sot, rreth 3,400 standarde evropiane (ENs) janë miratuar si standarde kosovare, duke përfshirë një numër standardesh të harmonizuara në lidhje me direktivat e Qasjes së Re. Agjencia nuk është ende anëtare e asnjë organizate standardizimi, evropiane apo ndërkombëtare. Kosova gjithashtu ka nevojë të hartojë një strategji afatgjate për standardizim.

Ka pasur ca përparim në lidhje me **vlerësimin e përputhshmërisë (konformitetit)**. Ligji mbi kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit është ndryshuar në gusht. Janë nxjerrë dy udhëzime administrative më 2010, me qëllim të transponimit të *acquis* të harmonizuara për ashensorët dhe përputhshmërinë elektromagnetike. 17 laboratorë testimi dhe një organ inspektimi janë akredituar në përputhje me standardet EN/ISO, për analiza

ushqimore të ujit dhe testim kimik të karburanteve, si dhe testim fiziko-kimik dhe mekanik të materialeve ndërtimore.

Ka pasur ca përparim në **akreditim**. Ligji për akreditimin dhe udhëzimi administrativ për funksionimin e Këshillit për Akreditim janë ndryshuar e plotësuar. Drejtoria e Akreditimit, e cila vazhdon të funksionojë brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ka rishqyrtuar dokumentacionin e saj të sistemeve për menaxhimin e cilësisë. Drejtoria ka kontratë bashkëpunimi me Korporatën Evropiane për Akreditim (EA) si dhe ka aplikuar në nëntor të vitit 2010 për nënshkrimin e një marrëveshjeje bilaterale me EA-në me kushtet që vlejné për nënshkruesit e marrëveshjes multilaterale në fushën e laboratorëve të testimit. Vlerësimi para vlerësimit nga homologët është bërë në maj. Drejtoria gjithashtu është bërë anëtare e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Akreditim të Laboratorëve (ILAC) në korrik, si dhe e Forumit Ndërkombëtar të Akreditimit (IAF) më 2010.

Ka pasur ca përparim në **metrologji**. Ligji për metrologjinë është miratuar në tetor të vitit 2010, duke mundësuar transponimin e direktivave të Qasjes së Re. Janë miratuar dispozita implementimi për para-paketime dhe njësi matëse, bashkë me udhëzimet administrative në fushat e termometrisë, njehsorëve elektronikë të energjisë, njehsorët elektronikë të energjisë reaktive, rrjedhat e lëngjeve përveç ujit, si dhe instrumenteve peshuese jo-automatike. Përputhshmëria e legjislacionit ekzistues për metrologjinë me *acquis* ende nuk është matur. Departamenti i Metrologjisë aktualisht ka 12 punëtorë. Dy laboratorët e Departamentit të Metrologjisë, të vendosur në Prishtinë dhe Prizren, kanë filluar operacionet e tyre më 2010. Këta laboratorë nuk përmbushin ende gjitha standardet përkatëse ndërkombëtare, pasi nuk ka sisteme të dokumentuara të menaxhimit të cilësisë, procedura kalibrimi apo procedura verifikimi për instrumentet matëse. Departamenti i Metrologjisë është bërë organizatë e ndërlidhur e Shoqatës Evropiane të Instituteve Kombëtare të Metrologjisë në tetor 2010.

Ka pasur ca përparim në fushën e **mbikëqyrjes së tregut**. Ligji i ri për inspektoratin e tregut dhe mbikëqyrjen, i cili merr parasysh Rregulloren (EC) 765/2008 për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2010. Përputhshmëria e tij me *acquis* horizontale nuk është vlerësuar ende. Dy udhëzime administrative janë miratuar më 2011, për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Tregut dhe për dokumentet ligjore të Inspektoratit. Ende nuk ka ndonjë strategji të hollësishme për mbikëqyrjen e tregut në Kosovë. Ndarja e përgjegjësiave mes inspektoratit të tregut dhe departamentit të metrologjisë ende nuk është definuar qartë. Mbi 3000 inspektime janë bërë mes shtatorit 2010 dhe marsit 2011. Mungesa e laboratorëve për testimin e produkteve pengon aktivitetet efektive të mbikëqyrjes së tregut. Procedura për shkatërrimin e produkteve të rrezikshme të konfiskuara mbetet sfiduese, për shkak të kornizës jo të plotë ligjore, si dhe mungesën e objekteve të përshtatshme.

Nuk ka pasur përparim legjislativ në lidhje me **mbrojtjen e konsumatorit**. Zbatimi i planit të veprimit për mbrojtjen e konsumatorit 2010-2014 ka vazhduar, si dhe janë intensifikuar fushatat vetëdijesuese. Është hapur një qendër këshilluese për qytetarë, si dhe një faqe interneti me produkte të rrezikshme është vendosur në internet. Kapaciteti administrativ nuk është përmirësuar.

Në përgjithësi, ca përparim është shënuar në kornizën ligjore. Përafrimi me legjislacionin evropian në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave është i kufizuar. Është i nevojshëm koordinimi më i mirë, si dhe një strategji për procesin e përafrimit të gjithë *Acquis* evropiane për lëvizjen e lirë të mallrave. I domosdoshëm është edhe progresi i mëtutjeshëm në përafrimin e legjislacionit specifik për produkte. Kapaciteti administrativ për përafrimin,

zbatimim dhe ekzekutimin legjislativ është jo-adekuat. Duhet dedikuar resurse të mirëfillta njerëzore për kompletimin e kornizës ligjore si dhe për zbatimin e dispozitave ekzistuese. Ka nevojë ende për përpjekje të konsiderueshme në këtë fushë.

4.1.2. *Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta e themelimit (establishment)*

Është arritur përparim i kufizuar në fushën e **lëvizjes së lirë të personave**. Kosova ka filluar përgatitjet për hartimin dhe negocimin e marrëveshjeve bilaterale të sigurimit social me shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e rajonit në fillim të vitit 2011. Pas hyrjes në fuqi të ligjit për lejet e punës dhe punësimin e qytetarëve të huaj në mars të vitit 2010, gjithsej 1682 leje pune për të huaj janë lëshuar. Kapacitetet institucionale në fushën e lëvizjes së lirë të personave mbesin të kufizuara.

Është arritur përparim i kufizuar në lidhje me **lirinë e ofrimit të shërbimeve**. Baza e të dhënave për legjislacionin në lidhje me shërbimet është përfunduar në qershor. Statistikat për shërbime vazhdojnë të jenë të pamjaftueshme.

Ka pasur përparim të kufizuar në *shërbime postare*. Autoriteti rregullativ i telekomunikacionit ka miratuar legjislacionin për tarifën e licencimit për operatorët postarë në territorin e Kosovës. Është themeluar një Departament i veçantë për shërbimet postare brenda autoritetit rregullativ për telekomunikacion, ashtu siç është kërkuar me ligjin e shërbimeve postare të vitit të kaluar, si dhe ka punësuar zyrtarin e lartë të shërbimeve postare. Kapaciteti administrativ ende ka nevojë të përforcohet më tutje.

Ca përparim mund të raportohet në fushën e *shërbimeve financiare*. Ligji mbi sigurimin e depozitave ka krijuar bazën ligjore për themelimin e Fondit të Sigurimeve të Depozitave të Kosovës. Bordi i saj është emëruar në korrik, duke përfshirë Guvernatorin e Bankës Qendrore, një përfaqësues të Ministrisë së Financave, përfaqësuesin e SCAKK-ut (shoqata e kontabilistëve të certifikuar), si dhe një ekspert bankar të punësuar përmes një konkursi publik. Vlerësimi i regjimit rregullativ dhe mbikëqyrës ka çuar në një udhëzues për migrim nga qasja e bazuar në rregulla CAMEL (përshtatshmëria e kapitalit, cilësia e aseteve, menaxhimi, të ardhurat, si dhe likuiditeti) drejt një qasjeje mbikëqyrëse më përparimtare të bazuar në rreziqe. Kriteret e përshtatshmërisë së kapitalit janë vetëm pjesërisht të përafuara me ato të Basel II. Banka Qendrore ka kapacitetin për të kryer mbikëqyrje efektive të sektorit financiar.

Ka pasur ca përparim në fushën e *sigurimeve*. Kuvendi ka miratuar një ligj për sigurimin e detyrueshëm të palës së tretë, i cili themelon Byronë kombëtare të sigurimeve, si dhe një fond në të cilin duhet të kontribuojnë kompanitë e sigurimeve. Ky fond do të sigurojë që zotëruesit e kartonëve të gjelbër në Kosovë të paguhet në rast dëmtimi. Kjo gjë është parakusht për aplikimin e Kosovës në Këshillin e Byrove për Katrona të Gjelbër si anëtare e përkohshme (në mungesë të anëtarësisë në OKB), të paraparë për në fillim të vitit 2012.

Ka pasur ca përparim në fushën e *letrave me vlerë*. Janë bërë hapa në ndërtimin e tregut të kapitalit. Për këtë qëllim, në kuadër të Ligjit të vitit 2009 për borxhin publik, është themeluar një njësi e operacioneve në tregun e hapur, duke i paraprirë kështu ankandëve të ardhshme të letrave me vlerë të qeverisë. Njësi është pjesë e drejtorisë së menaxhimit të aseteve në Bankën Qendrore.

Ka pasur pak përparim në lidhje me **të drejtën e themelimit (establishment)**. Përafrimi me standardet evropiane në lidhje me njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale.

Është arritur ca përparim në fushën e **së drejtës komerciale**. Ligji për shoqëritë tregtare, i miratuar në qershor, e përaftron kornizën ligjore me standardet evropiane, si dhe përforcon dispozitat për shmangien e konflikteve të interesit, si dhe kërkesat në lidhje me auditimet e jashtme të kompanive. Numri i qendrave komunale të biznesit, apo 'one-stop-shop' për themelimin e kompanive është rritur nga 8 në 22 (*shih edhe kapitullin 4.2.1 në lidhje me politikat për NVM*). Ligji për kontabilitetin dhe auditimin është zbatuar.

Në përgjithësi, përafrimi me standardet evropiane në fushën e lëvizjes së personave, shërbimeve dhe së drejtës së themelimit, bashkë me të drejtën komerciale, është në fazë të hershme. Kapaciteti administrativ ka nevojë për përforsim të konsiderueshëm, sidomos në fushën e shërbimeve postare. Kapacitetet për përafrim dhe ato administrative në lidhje me shërbimet financiare janë më të avancuara.

4.1.3. Lëvizja e lirë e kapitalit

Ka pasur përparim të kufizuar në lidhje me **lëvizjen e lirë të kapitalit**, në kontekstin e një regjimi tanimë liberal. Nuk ka kufizime në lidhje me pronësinë apo investimet e huaja në sektorin financiar apo në asete tjera. Si ilustrim, bankat e huaja kontrollojnë rreth 80% të sektorit bankar të Kosovës. Më 2011, totali i investimeve të huaja direkte u rrit, në krahasim me nivelin e tyre më 2010, duke arritur në 7.6% të BPV-së. Kosova nuk ka bursë e as treg financiar.

Përparim i kufizuar është bërë në **sistemet e pagesave**. Banka Qendrore ka zhvilluar softuerë për vendosjen e një sistemi pagesash bruto në kohë reale, që është pjesë e Strategjisë Kombëtare të Pagesave. Zbatimi i vërtetë i kësaj strategjie mbetet në pritje të miratimit të ligjit mbi pagesat. Sa i përket pagesave ndërkombëtare, përpjekjet për të negociuar një kod të përkohshëm SWIFT (kod ISO 3166-1 i vendosur për shfrytëzuesin) në mungesë e anëtarësimit në OKB, kanë qenë të pasuksesshme.

Në përgjithësi, sistemi për lëvizjet e kapitalit është tejet liberal. Ka nevojë për reforma të mëturshme për vendosjen e kërkesave të rrezikut nga Basel II, si dhe për përafrimin e kornizës ligjore në përputhje me standardet e BE-së për lirinë e lëvizjes së kapitalit dhe sistemit të pagesave. Kapaciteti i Bankës Qendrore për mbikëqyrjen e sektorit është adekuat.

4.1.4. Doganat dhe tatimimi

Ka pasur përparim në fushën e **doganave**. Shërbimi Doganor ka miratuar ndryshimet në udhëzimin administrativ për procedurat disiplinore për t'u përballur me pohimet për sjelljen joprofesionale të personelit doganor. Të ardhurat e përgjithshme të grumbulluara nga Shërbimi Doganor deri në fund të korrikut 2011 kanë shkuar në 426.8 milionë euro, krahasuar me 359.5 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit 2010. Njësia e brendshme anti-korrupsion merret me një ngarkesë të rasteve të mbetura që nga viti 2010. Bordi i Pavarur Mbikëqyrës për ankesa të bizneseve dhe tatimpagues të Administratës Tatimore dhe Shërbimit Doganor ende ka mbi 2500 raste për shqyrtim, derisa vendimet e tij janë shpesh të cilësisë së dobët. Pavarësia dhe paanshmëria e këtij bordi duhen përforsuar.

Para incidenteve në portat 1 dhe 31 në veri të Kosovës në fund të korrikut, Doganat e EULEX-it regjistronin mallrat që i deklaroheshin dhe i udhëzonte vozitësit të paraqiten në Terminalin Doganor në jug të Mitrovicës. Doganat e Kosovës mbanin pika statike të kontrollit në secilën rrugë kryesore nga portat 1 dhe 31, disa kilometra në jug të portave, ku bënin disa kontrollime të kufizuara në disa prej automjeteve. Shërbimi Doganor ka vlerësuar

që afërsisht 25% e automjeteve komerciale nuk ishin në përputhje me udhëzimet, duke shkuar kështu në lokacione tjera në veri pa arritur tek pikat e kontrollit të Doganave të Kosovës.

Në fushëveprimin e dialogut Beograd/Prishtinë, është arritur një marrëveshje me vulat doganore. Kosova ka hequr embargon e saj ndaj mallrave serbe, derisa Serbia dhe Bosnja e Hercegovina kanë njohur vulat kosovare. Lëvizja e lirë e mallrave është rivendosur. Portat 1 dhe 31 tani vështrohen nga një ekip i përzier me oficerë të EULEX-it, Policisë së Kosovës dhe Doganave nga të dyja etnitë.

Marrëveshjet e bashkëpunimit janë nënshkruar me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe me Slloveninë, me qëllim të harmonizimit të statistikave tregtare. Me Malin e Zi është nënshkruar një protokoll për këmbimin elektronik të të dhënave para arritjes. Ka vazhduar puna përgatitore për zëvendësimin e Sistemit aktual Doganor të Përpunimit të të Dhënave me Asycuda World (Sistemi i automatizuar për të dhëna doganore), siguruar nga UNCTAD.

Në përgjithësi, legjislacioni i doganave të Kosovës është gjerësisht në përputhje me Kodin Doganor të BE-së. Bordi i Pavarur Mbikëqyrës duhet të funksionojë më efektivisht dhe të zvogëlojë ngarkesën e lëndëve të mbetura.

Ka pasur ca përparim në fushën e **tatimit**. Administrata Tatimore e Kosovës ka miratuar një udhëzim administrativ në nëntor, duke qartësuar kompetencat e njësive si njësia për hetime tatimore, si dhe njësia që merret me ankesa. Administrata Tatimore ka filluar të zbatojë strategjinë e vitit 2010 për përmbushje të obligimeve tatimore, si dhe planin strategjik 2010-15. Strategjia ka krijuar procedura më të shkurtra për t'u marrë me tatimpaguesit që nuk raportojnë, kërkesat për rimbursim dhe ankesat. Njëkohësisht, zbatimi i strategjisë do të avancohej më tutje duke avancuar sistemin elektronik të Administratës - SIGTAS.

Që prej prillit 2011, kompanitë që aplikojnë për numër fiskal e marrin atë brenda ditës, derisa kontrollet bëhen më vonë. Gjatë vitit 2011, janë lëshuar 8,800 numra fiskalë, duke e çuar totalin në 48,800, numër që ende është më i vogël sesa numri i përgjithshëm i firmave të regjistruara nga agjencia e regjistrimit të bizneseve (rreth 105,000). Numrat fiskalë mund të merren si indikator i mirë i bizneseve aktive, duke treguar që një numër i konsiderueshëm i veprimtarive mbetet i peregjistruar. Totali i të ardhurave tatimore deri në fund të vitit 2011 ishte 138 milionë Euro, krahasuar me shumën prej 117 milionë eurove për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Në përgjithësi, ka pasur ca përparim në fushën e tatimit, kryesisht në lidhje me zbatimin e reformave për mbështetjen e strategjisë së përmbushjes së obligimeve tatimore.

Ca përparim është bërë në kuptimin e **kapaciteteve administrative dhe operacionale** të Doganave të Kosovës. Njësitë anti-kontrabandë të Shërbimit Doganor kanë kryer një numër operacionesh për luftimin e kontrabandimit dhe evazionit fiskal. Operacionet e mëdha të udhëhequra nga inteligjenca kanë çuar në sekuestrim të sasive të konsiderueshme të alkoolit, pjesa më e madhe e të cilit ishte e falsifikuar. Ka pasur rritje të përpjekjeve për luftimin e ilaçeve të paligjshme dhe të falsifikuara. Është bërë një shqyrtim organizativ, si dhe ka konfirmuar përpjekjet e konsiderueshme të modernizimit të Shërbimit Doganor, edhe pse mbesin ende mungesa, si dhe ka nevojë për reforma e modernizim të mëtutjeshëm efektiv.

Në kuptimin e kapaciteteve administrative dhe operacionale të administratës tatimore, zyrat e saj rajonale kanë vendosur tregues të performancës për të matur cilësinë e shërbimeve të tyre për tatimpagues. Është themeluar një njësi për menaxhimin e riskut për të rritur kapacitetin e

identifikimit të rrezikut ndaj të ardhurave që rrjedhin nga veprimtaritë ekonomike. Më se 9,000 biznese janë pajisur me arka fiskale elektronike. Janë rritur edhe fushatat vetëdijesuese për tatimpagues, derisa trajnimet e brendshme të zyrtarëve kanë vazhduar. Administrata Tatimore ka kryer më shumë vizita për kontrollimin e përmbushjes së obligimeve në firma, si dhe – bashkë me policinë – edhe kontrollime të kamionëve në lidhje me mallrat me origjinë të paqartë. Në çerekun e katërt të vitit 2010, është krijuar një ndërlidhje me bankat komerciale të Kosovës për të regjistruar automatikisht në Administratën Tatimore gjitha pagesat tatimore të kryera përmes këtyre bankave. Shqyrtimi organizativ ka vërtetuar që janë ndërmarrë tanimë përpjekje të lëvdueshme në procesin e modernizimit të ATK-së. Një spektër mangësish ende ekzistojnë, duke kërkuar kështu reforma të mëtutjeshme efektive dhe modernizim.

Në përgjithësi, zbatimi i tarifave doganore është përmirësuar, sidomos në fushën e luftës kundër kontrabandimit dhe falsifikimit, por ende ka nevojë për më shumë përpjekje. Kapacitetet administrative në zbatim të pagesave tatimore dhe në zvogëlim të sektorit tejet të madh joformal mbesin të vogla. Në këtë kuptim, efikasiteti i punës dhe bashkëpunimi mes Administratës Tatimore, gjykatave dhe policisë duhen avancuar.

4.1.5. Konkurrenca

Ka pasur ca përparim në fushën e **konkurrencës**. Korniza legjislative për **antikartel dhe përqendrim** është përmirësuar përmes zbatimit të legjislacionit që plotëson ligjin për mbrojtjen e konkurrencës së vitit 2010. Ky legjislacion përfshin statutet dhe metodat e punës së Autoritetit Kosovar të Konkurrencës si dhe zbatimin e rregullave të përqendrimit. Ligji i konkurrencës është i përafëruar gjerësisht me standardet e BE-së, por duhet të përafrohet edhe më shumë, p.sh. në lidhje me përkufizimin e pozitës dominuese në treg. Pragu i qarkullimit për obligimin e paraqitjes së përqendrimëve të planifikuara duhet të përshtatet me nivelin e përafërt të madhësisë së ekonomisë së Kosovës.

Përparim i ngjashëm mund të shënohet në zbatimin e rregullave të konkurrencës. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka miratuar vendime në lidhje me shkeljen e rregullave të konkurrencës nga kompanitë aktive në tregjet e karburanteve motorike me pakicë, arka fiskale dhe sigurime. Janë vënë gjoba për disa kompani në këta sektorë. Pagesa e gjobave i nënshtrohet rezultatit të apeleve eventuale të kompanive. Autoriteti nuk ka miratuar ndonjë vendim për përqendrim (bashkim kompanish), si dhe ka vazhduar të ndërtojë përvojën e tij. Autoriteti vuan nga mungesa e personelit me përvojë, si dhe ende nuk ka lokalet e veta. Ai është i vendosur në ndërtesën e Parlamentit të Kosovës. Ka nevojë që t'i ndahen më shumë resurse për avokimin për rregulla të konkurrencës, sidomos mes NVM-ve.

Ligji për **ndihmën shtetërore** është miratuar në korrik, si dhe do të hyjë në fuqi më 1 janar 2012. Ky ligj parashikon të themelohet një Komision të Ndhmës nga Shteti, të përbërë nga përfaqësues të ministrive të ndryshme, shoqërisë civile dhe sektorit privat. Monitorimi i ndihmës së miratuar shtetërore do të bëhet nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës.

Në përgjithësi, ca përparim është bërë në fushën e konkurrencës. Zbatimi i politikave antikartel dhe kundër bashkimeve apo përqendrimëve është ende në fazë të hershme. Ligji për konkurrencë duhet ndryshuar për përafrim më të mirë me *acquis evropiane*. Kapaciteti administrativ i Autoritetit të Konkurrencës është i pamjaftueshëm për detyrat e marra përsipër, derisa personelit të tij i duhet trajnim i mëtutjeshëm. Përafrimi i politikës së ndihmës shtetërore është në fazë tejet të hershme, si dhe nuk ka ndonjë regjistër të zbatimit të saj.

4.1.6. Prokurimi publik

Përparim mund të raportohet në fushën e prokurimit publik. Versioni i parë i ligjit për prokurimin publik është miratuar në nëntor të vitit 2010. Ai përmbante një numër dispozitash që shmangnin në masë të konsiderueshme direktivat e prokurimit publik, duke i ekspozuar zyrtarët e prokurimit ndaj ndërhyrjeve politike dhe presioneve, duke dëmtuar transparencën dhe llogaridhënien e gjithë procesit, si dhe duke hapur mundësi korrupsioni. Versioni i ri i ligjit është miratuar në gusht të vitit 2011, i cili rregullon shumicën e mangësive të ligjit paraprak, si dhe rrit në masë të konsiderueshme përputhshmërinë me standardet evropiane. Ai gjithashtu përforcon pavarësinë e zyrtarëve të prokurimit.

Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik ka lëshuar disa udhëzime administrative, të cilat rregullojnë, mes tjerash, përdorimin e gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik, hapjen publike të propozimeve dhe vlerësimin, vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve, përdorimin e kriterëve të përzgjedhjes, etj. Komisioni i ka dorëzuar raportin e tij të vitit 2010 Parlamentit për miratim. Rreth 13,500 kontrata janë nënshkruar më 2010, prej të cilave procedurat e hapura kanë përbërë 85% të numrit total të kontratave, derisa procedura e kufizuar nuk është përdorur fare. Procedurat e prokurimit të drejtpërdrejtë njëburimor janë zvogëluar më 2010, duke përbërë 7% të kontratave më 2010. 430 ankesa janë pranuar dhe shqyrtuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit më 2010. Kornizë-Kontratat nuk përdoren ende. Kjo do të zvogëlonte numrin e tenderëve dhe do të mundësonte kushte më të mira çmimesh.

Masat kundër rasteve të keqpërdorimeve në procedurat e tenderimit janë marrë në disa raste, duke i lëshuar urdhëresa autoriteteve kontraktuese të përfshira. Organi Shqyrtues i Prokurimit ka lëshuar vetëm një gjobë një autoriteti kontraktues i cili nuk ka respektuar urdhëresën. Shuma minimale e gjobave është relativisht modeste (5,000 euro), duke zvogëluar kështu efektin e largimit nga ato mënyra.

Aktualisht ka 161 autoritete kontraktuese në Kosovë. Ligji aktual përcakton që zyrtarët e prokurimit duhet të kalojnë deri në 15 ditë trajnimi brenda një viti, krahasuar me 10 ditët e rregullave të mëparshme. Trajnimet ofrohen nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike në bashkëpunim me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik. 489 zyrtarë prokurimi janë certifikuar pas përfundimit të trajnimit.

Ka ndërthurje mes tre organeve të prokurimit publik (Agjencia e Prokurimit, Organi Shqyrtues i Prokurimit, si dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik), si dhe ndarja mes kompetencave rregullative dhe ekzekutive nuk është plotësisht e definuar. Bashkëpunimi efikas dhe mekanizmat e bashkërendimit ndër-institucional duhen përmirësuar.

Në përgjithësi, legjislativi i prokurimit ende nuk është në përputhje me standardet evropiane. Kosova ka punë për të bërë në kompletimin dhe përmirësimin e kornizës ligjore në fushën e prokurimit publik. Veçanërisht, ligji për partneritete publiko-private dhe koncesione duhet të ndryshohet për të përmbushur kërkesat e *acquis*. Të tre organet e prokurimit publik duhet të bashkëpunojnë në mënyrë më efektive. Vetëdijësimi i autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomikë për procedurat e prokurimit publik duhet rritur, derisa pavarësia e zyrtarëve të prokurimit publik duhet fuqizuar më tutje.

4.1.7. Ligji për pronën Intelektuale

Ka pasur ca përparim në aspektet legjislative të të **drejtave të pronës intelektuale**.

Ka pasur pak përparim në fushën e **të drejtave të autorit dhe të drejtave të ndërlidhura me to**. Strategjia kundër falsifikimit ka mbetur për t'u zhvilluar. Në Kosovë nuk ekzistojnë shoqata kolektive.

Ka pasur përparim të mirë në lidhje me legjislacionin në fushën e **të drejtave të pronës industriale**. Ligjet e vitit 2010 për patenta, marka tregtare dhe dizajnë industriale janë ndryshuar dhe plotësuar në korrik me qëllim që ato të jenë në pajtim me legjislacionin e BE-së. Është krijuar baza e të dhënave për markat tregtare, por ende nuk është funksionale. Në të njëjtën kohë, digjitalizimi i të dhënave për më shumë se 10,000 aplikacione është përfunduar në maj. Në vitin 2010, janë marrë 1,480 vendime për marka tregtare dhe 147 për patenta. Në vitin 2010, Zyra për Pronën Industriale ka pranuar 550 aplikacione për marka tregtare, 85 për patenta dhe 4 për dizajne industriale. Numri i Aplikacioneve të pashqyrtuara mbetet shumë i lartë, me 17,000 marka tregtare, 4,000 dizajne dhe 500 patenta të pashqyrtuara. Procedurat mbeten të gjata. Zyra për Pronë Industriale është ende pa personel të mjaftueshëm dhe zyrat e tyre nuk janë adekuate.

Është bërë ca përparim në zbatimin e të drejtave të pronës intelektuale. Njësia e të drejtave të pronës intelektuale është themeluar brenda doganave të Kosovës dhe është bërë funksionale në janar. Janë hartuar profilet e rrezikut për mallrat të cilat mund të shkelin të drejtat e pronës dhe janë rritur aktivitetet e vetëdijesimit për të drejtat e pronës intelektuale.

Është nënshkruar një marrëveshje e mirëkuptimit në mes të Shërbimit Doganor dhe Zyrës së Pronës Industriale. Ende duhet të qartësohet ndarja e kompetencave ndërmjet Doganave dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Shërbimi Doganor ka bërë përpjekjet që të zbatohet të drejtat e pronës intelektuale, me ç'rast janë sekuestruar (e në disa raste edhe janë shkatërruar) dhe janë shqiptuar gjopa mjaft të mëdha. Në përgjithësi, produktet e falsifikuara dhe pirateria mbeten çështje brengosëse në Kosovë. Masat ndëshkimore kundër shkeljeve e të drejtave të pronës industriale duhet të qartësohen edhe më tutje. Procedurat e shkatërrimit për mallra të dëmshme për shëndetin e publikut nuk janë tërësisht të definuara. Nuk mund të vihen në praktikë për shkak të zbrazësive në kornizën legjislative si dhe kapaciteteve administrative joadekuate, duke përfshirë mungesën e pajisjeve adekuate për shkatërrimin e mallrave të rrezikshme.

Pirateria ka shtrirje të gjerë dhe tregtia e materialeve të piraterisë ndodh në sy të publikut pa kurrfarë sanksionesh. Kosova duhet të bëjë një vlerësim rigoroz lidhur me nivelin e kësaj sfide me qëllim të dizajnit të mjeteve më të përshtatshme për të vendosur kornizën e nevojshme institucionale për ta luftuar piratërinë.

Në përgjithësi, Kosova i ka filluar përpjekjet e përafritit të kornizës së saj legjislative me standardet Evropiane në fushën e të drejtave të pronës intelektuale. Janë marrë disa hapa për t'i rritur kapacitetet administrative në këtë fushë. Në përgjithësi kapacitetet mbeten të pamjaftueshme dhe zbatimi vazhdon të jetë një sfidë. Falsifikimi dhe pirateria mbeten çështje dhe brenga serioze në Kosovë.

4.1.8. Punësimi dhe politikat sociale, politikat e shëndetit publik

Kosova ka bërë ca përparim në fushën e **politikave të punësimit**. Implementimi i strategjisë së punësimit 2010-2011, ka kontribuar edhe më tutje në krijimin e mundësive të reja të punësimit, kryesisht përmes skemës së punëve publike. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e ka miratuar një strategji sektoriale dhe planin e saj të veprimit për vitet 2011-2013,

duke u përqendruar në politikat e krijimit të punësimit dhe zhvillimit të masave aktive të punësimit. Implementimi i strategjisë së punësimit ka filluar, duke u fokusuar në të rinjtë, personat me aftësi të kufizuar, përfituesit e asistencës sociale dhe personat që vuajnë nga varfëria. Shërbimi i punësimit publik ka vazhduar regjistrimin proaktiv të punëkërkesve. Burimet dhe kapacitetet nuk janë të mjaftueshme për t'u ballafaquar me të gjithë personat që janë në pozitë të pafavorshme të cilët janë kryesisht jashtë tregut të punës. Janë bërë disa përpjekje për modernizimin e zyrave të punësimit. Në të njëjtën kohë kapacitetet e tyre duhet të forcohen. Partnerët social kanë pak ndikim në hartimin e strategjive të punësimit. Shkalla e punësimit mbetet shumë e ulët dhe papunësia e rinisë si dhe papunësia afatgjatë janë të larta në masë alarmuese. Nevojiten zotime shtesë nga Qeveria për të adresuar këtë sfidë dhe veprime vendimtare nga Qeveria.

Mund të raportohet për ca përparim sa i përket politikave sociale.

Miratimi i *Ligjit të Punës* e ka forcuar kornizën ligjore. Kostoja e implementimit të tij mund të mos jetë e qëndrueshme. Implementimi i tij kërkon monitorim të afërt, përkatësisht vëmendje në cënueshmërinë e shtuar të mundshme të grave në tregun e punës, për shkak të zgjatjes së pushimit të lehonisë.

Në fushën e *shëndetit dhe sigurisë në punë*, është bërë përparim i kufizuar. Inspektorët e punës janë gjithashtu duke punuar në Komunën e Obiliqit, Shtërpcës dhe Graçanicës. Inspektorati i punës ende duhet ta përmirësojë efikasitetin e tij në ushtrimin e detyrave të tij. Numri i inspektorëve të punës mbetet i pamjaftueshëm. Aksidentet që ndodhin në vendin e punës duhet të regjistrohen.

Është bërë ca përparim në fushën e *dialogut social*. Ligji për sindikata është miratuar. Ai rregullon krijimin dhe mandatin e tyre. Ligji i ri për këshillin socio-ekonomik është miratuar. Këshilli socio-ekonomik është funksionalizuar. Janë bërë diskutime ndërmjet partnerëve socialë për vendosjen e pagës minimale. Dialogu ndërmjet Qeverisë, organizatave të punëdhënësve dhe sindikatave duhet të përmirësohet. Dialogu social dypalësh në nivel të degëve dhe kompanive kërkon promovim të mëtutjeshëm. Mungesa e të dhënave të besueshme për anëtarësinë e sindikatave e parandalon caktimin e sindikatave përfaqësuese.

Ka pasur përparim të kufizuar në fushën e *përfshirjes sociale përfshirë kundër-diskriminimin (shih gjithashtu kriteret politike)*. Standardet minimale për pesë shërbime të ndryshme sociale janë përcaktuar. Ato paraqesin një model për standardet e shërbimeve tjera sociale, të cilat janë duke u hartuar aktualisht. Procedurat për licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale janë zhvilluar. Komunitetet pakicë rom, ashkali dhe egjiptas vazhdojnë të ballafaqohen me sfidat më serioze sa i përket përfshirjes sociale. Në fushën e barazisë gjinore, mund të raportohet për një përparim deri diku. Kosova ka miratuar programin dhe planin e veprimit kundër dhunës në familje. Veprimet për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje kanë vazhduar me përfshirje aktive të organizatave të shoqërisë civile. Ato monitorohen nga Qeveria, e cila pjesërisht i financon këto aktivitete përkatësisht zbatimin e Ligjit. Hulumtimi për barazinë gjinore është përmirësuar. Implementimi dhe zbatimi i Legjislacionit kërkojnë përpjekje shtesë për të pasur ndikim pozitiv në gjendjen e gruas. Për ta adresuar papunësinë e lartë të femrat, nevojiten më shumë mundësi të punësimit. Përfaqësimi i ulët i femrave në sektorët kyç të shoqërisë mbetet brengë. Mungesa e mundësive të punësimit është një sfidë e përgjithshme për arritjen e nivelit më të lartë të përfshirjes sociale. Për të zbatuar dhe monitoruar politikat në mënyrë efektive kërkojnë statistika zyrtare për përjashtimin social dhe varfërinë si dhe burimet e përshtatura.

Mund të raportohet për përparim të kufizuar në *mbrojtjen sociale*. Decentralizimi i shërbimeve sociale ka vazhduar. Në të njëjtën kohë, nuk janë siguruar burime adekuate për këtë proces. Ligji për skemën e asistencës sociale dhe Ligji për shërbime sociale dhe familjare nuk janë miratuar. Ka pasur raste të ndërhyrjes pavend të politikës në emërimin e drejtorëve të caktuar të Qendrave për Punë Sociale nëpër komuna.

Ka pasur ca përparim në fushën e **politikave të shëndetit publik**. Janë miratuar strategjia dhe plani i veprimit 2010-2020, për sistemin e informimit mbi shëndetin, dhe Kosova ka filluar implementimin e tyre. Implementimi i strategjisë së vitit 2009 për shëndetin është në proces e sipër. Korniza legjislative është forcuar me miratimin e dymbëdhjetë udhëzimeve administrative. Ligji për duhanin vazhdon të zbatohet. Fushatat për ngritjen e vetëdijes si dhe inspektimet në teren janë intensifikuar. Dispozitat lidhur me pirjen e duhanit në vendet publike duhet të zbatohen. Ligji për shëndetësinë dhe sigurimin shëndetësor ka mbetur për tu miratuar. Të dhënat statistikore në nivel komunal mbesin të kufizuara. Shumë pak përparim është bërë në implementimin e legjislacionit për gjakun, indet dhe qelizat. Shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve vazhdon të mbetet e lartë.

Lufta kundër abuzimit të drogës ende nuk është adresuar ashtu sikur politikat për parandalimin e sëmundjeve jo-ngjitëse. Ka pasur shumë pak përparim në implementimin e programeve për kontrollimin e *kancerit* të gjirit, atij cervikal dhe kolo-rektal në pajtim me rekomandimin e Këshillit të BE-së.

Dispozitat për shërbime shëndetësore nuk kanë arritur në mënyrë adekuate deri te komunitetet pakicë. Disponueshmëria e të dhënave për gjendjen shëndetësorë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian (RAE) është e kufizuar. Në kornizën për zhvendosjen e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian të prekur nga plumbi, Ministria e Shëndetësisë e ka miratuar protokollin për kontrollim dhe trajtim nga kontaminimi me plumb. Qendra për Shëndetësi Familjare në Mitrovicë është përgjegjëse për kryerjen e trajtimeve specifike për fëmijët e diagnostikuar me nivel të lartë të plumbit në gjak. Niveli i kontaminimit me plumb në zonën e Mitrovicës mbetet i lartë. Mbulimi me vaksinim të plotë te komunitetet RAE është më i ulët se sa te komunitetet tjera. Nga janari i vitit 2011 Instituti për shëndet publik e ka realizuar një fushatë të vaksinimit ku janë vaksinuar më tepër se 800 fëmijë nga komunitetet RAE, kundër sëmundjeve të ndryshme.

Në fushën e *shëndetit mendor* dispozitat për personat me sëmundje mendore duhet të përfshihen në strategjinë dhe planin e veprimit për shëndetin. Nevojitet financim adekuat për rindërtim të duhur të sektorit. Nevojiten veprime shtesë për promovim të përfshirjes së personave me probleme në shëndetin mendor në sistemin e arsimit dhe për fuqizimin e tyre.

Në përgjithësi Ministria e Shëndetësisë vazhdon të preket nga mungesa e fondeve dhe kapaciteteve adekuate. Buxheti i ulët i sektorit të shëndetësisë ende e pengon përmbushjen e nevojave themelore për shëndetin e nënës dhe fëmijës.

Në përgjithësi, mund të raportohet për ca përparim në sektorët e punësimit, politikave sociale dhe shëndetit publik. Korniza Legjislative është përmirësuar me miratimin e Ligjit të punës, Ligjit për sindikatat dhe Strategjisë për sistemin e informimit shëndetësor. Në të njëjtën kohë kapaciteti administrativ mbetet i kufizuar dhe zbatimi i Legjislacionit kërkon veprim të shpejtë.

4.1.9. *Arsimi dhe hulumtimi*

Ka pasur ca përparim në fushën e **arsimit**, kryesisht sa i përket Legjislacionit. Dokumenti i strategjisë për arsim 2011-2016 është finalizuar dhe është ndarë buxhet për implementimin e saj. Legjislacioni i rishikuar për arsimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe të lartë është miratuar ashtu si politikat për trajtimin e shkollës së lartë të braktisjes së shkollës nga nxënësit, dhe dhunës në shkolla. Korniza kurrikulare është përfunduar. Pjesëmarrja në Tempus është duke u rritur dhe vetëdija lidhur me përfitimet e tij për Institucionet private dhe publike të arsimit është duke u përmirësuar. Kapaciteti administrativ për menaxhimin e projekteve të Tempusit është forcuar. Shoqata Evropiane për Sigurim të Cilësisë në arsimin e lartë i ka dhënë Agjencisë Kosovare të Akreditimit status të asociuar.

Legjislacioni i rishikuar parasheh një numër të organeve të reja, financimi i të cilave nuk është siguruar ende. Kërkohet vëmendje më e madhe në matjen e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në arsim në veçanti në fushën e trajnimit të mësimit dhe sistemit të vlerësimit të studentëve dhe mësimit. Ka pasur ndërhyrje të pavend të politikës në emërimin drejtorëve në disa shkolla të caktuara. Programe të ndryshme të udhëhequra nga fakulteti i edukimit në Universitetin e Prishtinës nuk i kanë plotësuar standardet e akreditimit të autoritetit akreditues. Ligji për arsimim të të rriturve dhe Ligji për trajnim në arsimin profesional duhet të rishikohen për tu sjellë në përputhje me legjislacionin tjetër siç është Ligji për kualifikime nacionale. Kapaciteti institucional i autoritetit për kualifikime duhet të përmirësohet për të zbatuar edhe më tutje Ligjin për kornizën nacionale të kualifikimit. Projekt-procedurat për vërtetimin e kualifikimeve dhe akreditimin e ofruesve të trajnimit në arsimin profesional kërkojnë që të testohen në teren dhe të implementohen në mënyrë efektive. Këshilli për arsimim dhe trajnim profesional duhet të bëhet plotësisht funksional. Qasja e femrave në trajnim profesional duhet të forcohet. Kosova duhet të zhvilloj statistika dhe të dhëna për arsimin përfshi për numrin e studentëve dhe shkollën e punësimit të të diplomuarve. Arsimi përfshirës kërkon vetëdije të ngritur, vëmendje dhe veprime në veçanti për të përmirësuar gjendjen e grupeve të marginalizuara si fëmijët e pakicave dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Shkollat dhe autoritetet lokale duhet të sigurojnë mundësi të barabarta në arsim për fëmijët nga grupet e cenueshme. Strategjia për integrimin e komuniteteve RAE në arsim, ofron një kornizë të mirë. Qendrat e mësimit për nxënësit romë janë hapur. Regjistrimi i thjeshtuar i nxënësve romë, i cili është garantuar përmes një Udhëzimi Administrativ, mbetet të zbatohet nga drejtorët e shkollave. Masat proaktive për inkurajimin e regjistrimit dhe mbajtjes së fëmijëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian në shkollë duhet të zbatohen.

Proporcioni i lartë i fëmijëve të moshës shkollore në popullatë dhe karakteristikat e sistemit të arsimit kërkojnë përkushtim të shtuar dhe burime nga Qeveria për zhvillimin e kapaciteteve në nivelet qendrore dhe komunale për implementimin e legjislacionit.

Sa i përket *hulumtimit dhe inovacionit* mund të raportohet për përparim të kufizuar në përafrimin e standardeve evropiane. Në të njëjtën kohë këto janë deklaruar si politika prioritare në vitin 2010. Programi nacional shkencor është implementuar duke financuar projekte të hulumtimit në gjashtë fusha me prioritet në një shumë totale prej €1 milion. Është dhënë mbështetje në lehtësimin e qasjes në publikimet në gjuhën shqipe si një nga gjuhët zyrtare. Për të stimuluar shkencëtarët, është organizuar një çmim për hulumtuesin kosovar të vitit dhe hulumtuesin e ri të vitit. Pjesëmarrja në programin e shtatë të Kornizës Evropiane të Hulumtimit (FP7) është rritur paksa sa i përket parashtrimeve, por ka qenë shumë e kufizuar në projektet e suksesshme dhe të financuara.

Nuk ka pasur kurrfarë përparimi sa i përket investimit në hulumtim. Prandaj, nevojiten përpjekje thelbësore për të kontribuar në objektivat dhe synimet e Zonës Evropiane të Hulumtimit dhe Unionit të Inovacionit.

Në përgjithësi, Kosova është duke përparuar gradualisht drejt arritjes së prioriteteve të saj në arsim dhe hulumtim. Implementimi i kornizës legjislative duhet të rritet përmes përmirësimit të koordinimit ndërmjet niveleve qendrore dhe lokale dhe përmes ndarjes së më shumë burimeve. Arritja e përparimit në hulumtim kërkon përpjekje shtesë dhe të vazhdueshme.

4.1.10. Çështjet e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT)

Kosova nuk është anëtare e OBT-së dhe nuk ka ndërmarrë asnjë hap formal për anëtarësim në të.

4.2. Politikat sektoriale

4.2.1. Industria dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM)

Ka pasur ca përparim në fushën e **industrisë dhe në NVM**. Në korrik Qeveria miratoi strategjinë për zhvillimin e NVM-ve për periudhën 2012-2016, me vizion drejt vitit 2020. Synimet e strategjisë janë ndërtuar mbi parimet e Aktit të Evropës për Biznese të Vogla. Agjencia për mbështetje të NVM-ve, në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është institucioni kryesor përgjegjës për implementimin e kësaj strategjie. Agjencia, së bashku me Odën Ekonomike dhe Agjencitë rajonale zhvillimore, i kanë rritur përpjekjet për bashkërendim dhe komunikim më të mirë ndërmjet institucioneve arsimore dhe NVM-ve në Kosovë.

Regjistri i biznesit përfshin 105,000 kompani. Të dhënat nga Administrata Tatimore në bazë të numrave të lëshuar fiskalë, tregojnë që vetëm më pak se gjysma e tyre janë aktualisht aktive. Për çregjistrim pasi të bëhen joaktive, kompanitë duhet t'i paraqesin regjistrin të bizneseve deklaraten nga autoriteti tatimor, e cila tregon se të gjitha tatimet e mbetura janë përmbushur. Regjistrimi i kompanive përmes internetit ka qenë i mundshëm vetëm në “one-stop-shop” apo në qendrat komunale të biznesit, të cilat janë themeluar në 22 komuna. Regjistrimi i plotë i bizneseve përmes internetit ende nuk është i mundshëm.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e ka miratuar një strategji industriale në vitin 2009. Qeveria ka mbetur që ta miratoi atë. Industria dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në përgjithësi vazhdon të vuaj nga vështirësitë në përmbartimin ligjor të kontratave, furnizimi i paqëndrueshëm me energji elektrike dhe qasja e kufizuar dhe e shtrenjtë në financa.

Në përgjithësi, bashkërendimi dhe bashkëpunimi ndërmjet hisedarëve relevant duhet të rriten në fushën e politikave të ndërmarrjeve dhe industrisë (agjencitë për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe promovim të investimeve, odat ekonomike, Shoqata e bankiereve, gjykatat, agjencitë rajonale të zhvillimit, etj). Plani i implementimit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe strategjitë industriale duhet të miratohen, duhet të ndahet buxhet adekuat dhe autoritetet përgjegjëse duhet të forcohen.

4.2.2. Bujqësia dhe peshkataria

Në fushën e **bujqësisë dhe politikave të zhvillimit rural**, ka pasur aktivitete të kufizuara legjislative. Ndryshimet në ligjin për verërat janë miratuar në korrik, duke paraparë

specifikime të mëtutjeshme lidhur me klasifikimin, vlerësimin dhe përcaktimin e origjinës së mbrojtur gjeografike.

Ministria dhe Agjencia Kosovare e Ushqimit dhe Veterinës duhet të marrin detyra të reja lidhur me pagesat e drejtpërdrejta dhe bartjen e kompetencave të inspektimit nga komunitetet nga agjencia. Buxheti i përgjithshëm i vitit 2011 për të dy institucionet është diku rreth 7% më i ulët se në vitin 2010. Regjistri i fermave është duke u avancuar për të përfshirë të dhëna nga regjistrat tjerë, siç është regjistri i kafshëve dhe regjistri i vreshtave. Madhësia mesatare e vogël e fermave në Kosovë, numri i madh i fermerëve që jetojnë nga kjo veprimtari dhe pjesa e madhe joformale e sektorit të bujqësisë e komplikojnë mbledhjen e të dhënave për rrjetin e të dhënave për kontabilitet të fermave. Kjo si rezultat ndikon në politikëbërje. Mospërputhjet vazhdojnë të ekzistojnë ndërmjet shifrave të EUROSTAT-it dhe Entit Statistikor të Kosovës lidhur me tregtinë bujqësore ndërmjet BE-së dhe Kosovës.

Ministria e ka vazhduar skemën e vet të pagesës së bashkangjitur për fermerët në sektorët e drithërave dhe bagëtisë, dhe ndihmën për procedimin dhe marketingun në sektorët e produkteve të qumështit, mishit, pemëve dhe perimeve në nivel të fermave, përmes njësisë së pagesave të themeluar vitin e kaluar në kuadër të Ministrisë. Shërbimet këshillëdhënëse ende nuk i informojnë fermerët lidhur me aplikimin për grante. Financimi komercial nga bankat e Kosovës mbetet i kushtueshëm (shpesh i paarritshëm) për fermerët si në aspektin e nivelit të kamatës ashtu edhe në kolateralin e kërkuar.

Pas ndryshimeve vitin e kaluar të Ligjit për menaxhimin e pyjeve, shumë kompetenca lidhur me pyllin i janë bartur komunave, disa nga të cilat kanë hartuar plane afatgjata për menaxhimin e pyjeve. Kjo mundëson lëshimin e lejeve afatgjata për prerjen e drunjve, dhe si rezultat shpie në menaxhim më të qëndrueshëm të pyllit. Në janar plani vjetor i operimit për menaxhimin e pyllit është finalizuar nga Agjencia Kosovare e Pyjeve.

Sa i përket sigurisë së ushqimit, veterinës dhe fitosanitarisë, bordi për monitorim dhe ai shkencor i Agjencisë për ushqim dhe veterinë janë emëruar në fillim të vitit 2011. Bartja e kompetencave për inspektim nga komunitetet në agjenci siç është paraparë nga Ligji i vitit të kaluar nuk është përfunduar ende. Kjo bartje duhet të përfundohet me qëllim të kontrollimit të tregtisë dhe therjes së vazhdueshme e të paligjshme të kafshëve dhe me qëllim të forcimit të kontrollit ndaj tregjeve të bagëtive. Sfidat tjera në këtë aspekt përfshijnë numrin e kufizuar të inspektorëve të veterinës.

Në dhjetor procesi i identifikimit dhe regjistrimit të bagëtive të vogla dhe derrave kishte filluar me qëllim të kryerjes së tij brenda një viti. Infrastruktura e TI-së për sistemin e kontrollit të identifikimit, regjistrimit dhe lëvizjes së kafshëve ende nuk është plotësisht funksionale. Regjistrimi i kafshëve vazhdon që të pengohet nga mos raportimi i lindjeve të kafshëve dhe lëvizja e tyre, si dhe nga kontrabandimi dhe therja e paligjshme.

Proceset e tenderimit për pajisjet e laboratorit të Agjencisë së ushqimit dhe veterinës janë duke u përgatitur. Ky laborator nuk ka staf dhe infrastrukturë të mjaftueshme të fitosanitarisë dhe inspektimi veteriner në kufi mbetet i dobët. Nuk ekziston asnjë impiant për përpunimin dhe asgjësimin e nënprodukteve të kafshëve. Një studim i realizueshmërisë për themelimin e një fabrike për ripërpunimin e nënprodukteve të kafshëve është përfunduar. Diskutimi për deponi urgjente për mbeturina si një zgjidhje e përkohshme nuk ka nxjerrë ndonjë rezultat konkret.

Katër rregullore për higjienën e ushqimit (që kanë dal nga pakoja e re e BE-së për higjienën) janë miratuar. Në tetor të vitit 2010, Agjencia e ushqimit dhe veterinës e ka përfunduar një

vlerësim të ndërtesave të produkteve të qumështit, thertoreve dhe fabrikave të përpunimit të mishit, si hap i parë drejt hartimit të strategjisë për avancimin e këtyre ndërtesave. Është themeluar një grup punues në fushën e mbrojtjes së bimëve, për të hartuar një liste të sëmundjeve të bimëve që ekzistojnë aktualisht në Kosovë.

Shumica e standardeve evropiane për peshkimin nuk vlejnë për Kosovën, e cila nuk ka peshkim detar.

Në përgjithësi, Kosova ka bërë përparim të kufizuar në fushën e bujqësisë dhe sigurisë së ushqimit. Implementimi i kornizës legjislative mbetet sfida kryesore, e ndërlidhur me ndërtimin e kapaciteteve administrative në institucione të ndryshme të përfshira së bashku me buxhetin e ulët të ndarë për këta sektorë. Regjistrimi i kafshëve, asgjësimi i nënprodukteve të kafshëve dhe vlerësimi i impianteve të agroushqimit si hap i parë për avancimin e tyre, meritojnë vëmendje të veçante.

4.2.3. Mjedisi

Sa i përket **mjedisit**, ka pasur përparim të kufizuar në fushën e *legjislacionit horizontal*.

Një Udhëzim Administrativ për pjesëmarrjen dhe informimin e hisedarëve të publikut në procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis është miratuar në korrik. Janë miratuar edhe rregulla tjera për implementimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe për vlerësimin strategjik mjedisor. Implementimi i Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis ka filluar, por cilësia e raporteve kërkon përmirësim. Direktiva për krime mjedisore është inkorporuar pjesërisht. Bashkëpunimi ndërmjet OJQ-ve dhe Ministrisë duhet të forcohet. Organizatat e shoqërisë civile nuk janë të përfshira dhe të konsultuara sa duhet gjatë politikëbërjes. Debatet politik për çështjet mjedisore duhet të zhvillohet edhe më tutje. Dhjetë projekte kapitale nga plani mjedisor i veprimit janë implementuar; edhe njëmbëdhjetë projekte tjera janë në proces e sipër.

Ka pasur ca përparim në fushën e *cilësisë së ajrit*. Udhëzimet Administrative që përcaktojnë (ndër të tjera) normat e cilësisë së ajrit, pikat e monitorimit dhe numrin dhe frekuencën e matjeve janë miratuar në vitin 2010. Një Udhëzim tjetër Administrativ për normat e cilësisë së ajrit është miratuar në korrik. Tri stacionet e para të rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit janë vënë në funksion, tjerat priten gjatë vitit 2011. Aglomeratet dhe zonat nuk janë identifikuar ende dhe inventari i ndotësve të ajrit gjithashtu mbetet të përpilohet. Bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Energjisë është përmirësuar. Sektori i Energjisë vazhdon të jetë burimi kryesor i emetimit të pluhurit, SO₂ dhe NO_x, të cilat janë në mënyrë substanciale përmbi kufijtë e BE-së.

Ka pasur pak përparim në fushën e *menaxhimit të mbeturinave*.

Ligji për mbeturina nuk është miratuar ende. Riciklimi dhe ndarja e mbeturinave nuk janë trajtuar ende. Tarifa e mbledhjes së mbeturinave ka shënuar një rritje të vogël në vitin 2010, por ende mbetet e ulët. Planet lokale të veprimit për mjedisin të hartuara nga Komuna, gjithashtu përfshijnë edhe komponentin e menaxhimit të mbeturinave.

Sa i përket *cilësisë së ujit*, ka pasur shumë pak përparim. Ligji për ujin nuk është miratuar ende. Kosova aktualisht i ka dy impiante për trajtimin e ujërave industriale; një tjetër është në proces të kompletimit. Zonat e cënueshme dhe vendet e mbrojtura nuk janë përcaktuar ende dhe ende nuk ka program për monitorimin e cilësisë së ujit. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm mbetet me zhvillim të dobët dhe një pjesë e mirë e popullatës ende nuk është e lidhur

me të. Investimet në këtë sektor kanë qenë të pamjaftueshme. Shkalla e pagesës së tarifave të ujit ka shënuar një rritje të lehtë në vitin 2010, por në përgjithësi mbetet e ulët.

Është arritur përparim i vogël në fushën e *mbrojtjes së natyrës*. Janë miratuar disa Udhëzime Administrative të ndërlidhura me Ligjin e vitit të kaluar për mbrojtjen e natyrës. Strategjia dhe plani i veprimit për bio-diversitetin janë miratuar në korrik. Kapacitetet institucionale dhe administrative në këtë fushë mbesin të dobëta.

Është arritur përparim i kufizuar në fushën e *kontrollit të ndotjes industriale dhe menaxhimit të rrezikut*. Janë miratuar udhëzimet administrative për format dhe përmbajtjen e aplikacionit për leje të integruar dhe për procedurat për zhvillimin dhe miratimin e dokumenteve referuese për praktikat më të mira në dispozicion, si dhe për parandalimin e aksidenteve të mëdha.

Në fushën e *kimikaleve*, ka pasur pak përparim, me miratimin e Udhëzimit Administrativ për vlerësim të rrezikut. Nuk ka pasur asnjë zhvillim përkitazi me, mbrojtjen nga *zhurma dhe mbrojtjen civile*.

Ka pasur pak përparim në fushën e **ndryshimeve klimatike**. Kosova nuk është palë e Konventës Kornizë të OKB-së për Ndryshime Klimatike. Kosova nuk ka strategji të ndryshimeve klimatike, por ka filluar ta përpilojë inventarin e vet të gazrave serrë. Kosova ka marrë pjesë aktivisht në punët klimatike në kuadër të rrjetit rajonal mjedisor për anëtarësim (RENA). Kosova duhet të ndërmarr hapa konkretë drejt transponimit dhe zbatimit të *acquis*, së BE-së për klimën, në veçanti të vendimin për mekanizmin e monitorimit.

Kapaciteti administrativ mbetet shumë i dobët në fushën e mjedisit dhe ndryshimit klimatik. Kërkohen përpjekje të mëtutjeshme për përmirësim të aranzhimeve institucionale për të siguruar koordinimin dhe bashkëpunim ndërmjet institucioneve të përfshira në sektorët mjedisor. Duhet të bëhen përpjekje për të ndarë funksionet politike nga ato operationale në ministri. Në shtator, është nënshkruar Udhëzimi Administrativ lidhur me organizimin dhe strukturën e Agjencisë Kosovare për mbrojtjen e mjedisit (AKMM), i cili e inkorporon institutin hidrometeorologjik në kuadër të AKMM-së. Planin për zhvillim strategjik për Ministrinë e Mjedisit nuk është miratuar ende.

Buxheti i Ministrisë së Mjedisit, edhe ashtu i pamjaftueshëm, është zvogëluar. Kjo ka ndikim të madh negativ në aftësinë e institucioneve të ndryshme për kryerjen e funksioneve të tyre në mënyrë efektive. Rregullatori për ujë dhe mbeturina gjithashtu vazhdon të preket nga mungesa e burimeve njerëzore dhe ballafaqohet me kufizime të mëdha financiare.

Në përgjithësi, përafrimi me standardet evropiane në fushën e mjedisit dhe ndryshimit klimatik mbetet në një fazë të hershme. Ka pasur një përparim shumë të kufizuar në miratimin e legjislacionit. Implementimi dhe zbatimi i Legjislacionit aktual është i dobët. Mjedi dhe ndryshimet klimatike vazhdojnë të jenë prioritet i ulët për Kosovën. Ekziston nevojë urgjente për ngritje të vetëdijes dhe planifikim strategjik në fushën e mjedisit dhe ndryshimit klimatik. Kërkohen përpjekje të mëtutjeshme për përmirësimin e aranzhimeve institucionale në mënyrë që të sigurohet bashkërendimi dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të përfshira në çështjet mjedisore dhe ndryshimin klimatik. Buxheti i zotuar në këtë sektor është i pamjaftueshëm për t'u ballafaquar në sfidat e mëdha mjedisore që i ka Kosova, në veçanti nevojat e konsiderueshme për investim në infrastrukturë. Cilësia e ujit dhe ajrit kërkojnë vëmendje thelbësore për të plotësuar kërkesat minimale për shëndetin e njeriut. Kosova duhet të ndërmarr hapa drejt themelimit të politikave të klimës, në veçanti përkitazi me *acquis*-in e BE-së për ndryshime klimatike.

4.2.4. Politikat e transportit

Në fushën e **rrjeteve trans-evropiane**, Kosova ka vazhduar të marrë pjesë aktive në implementimin e memorandumit të mirëkuptimit të vitit 2004 për zhvillimin e rrjetit kryesor rajonal të transportit në Evropën Juglindore dhe në observatorin e transportit evropian në Evropën Juglindore. Ndërtimi i Korridorit 7 ka vazhduar. Deri në një masë është bërë rehabilitim dhe mirëmbajtje e Korridorit 6. Projekti kryesor i Kosovës në infrastrukturën rrugore (autostrada në drejtim të kufirit me Shqipërinë), mbetet një çështje brengosëse për shkak të kostos disproporcionalisht të lartë si pjesë e buxhetit të Kosovës, e cila vazhdon që t'i marr investimet nga fushat tjera të transportit. Strategjia multimodale e transportit dhe plani i veprimit janë duke u përditësuar dhe disa objektiva operacionale duke u modifikuar.

Ka pasur përparim të kufizuar në fushën e **transportit rrugor**. Janë miratuar kriteret e reja për licencimin e operatorëve të ri të transportimit të mallrave përmes Udhëzimit Administrativ. Këshilli për siguri në rrugë nuk është takuar qysh nga shtatori i vitit 2010 dhe programi për siguri në rrugë është pezulluar në praktikë. Shkalla e aksidenteve të trafikut, ndonëse ka shënuar rënie të lehtë në vitin 2010, mbetet shumë e lartë. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal është i pamjaftueshëm. Divizionit të ri për politika të transportit në Ministrinë e Infrastrukturës (i cili mbulon planifikimin) ende i mungon financimi adekuat dhe burimet njerëzore.

Mund të raportohet për përparim deri në diku në **transportin hekurudhor**. Shturja e infrastrukturës së hekurudhave të Kosovës (Infrakos) dhe operimeve të trenave pritet që të ndodhë: dy kompani të reja (Trainkos dhe Infrakos) janë regjistruar në shtator. Shturja e tyre operative dhe financiare duhet të ndodhë në të ardhmen. Deklarata për rrjetin e hekurudhave është hartuar nga Hekurudhat e Kosovës, por nuk është publikuar për shkak se janë duke u diskutuar disa ndryshime në të. Organi rregullativ i hekurudhave tani është funksional, por i mungon si stafi ashtu edhe kapacitetet; buxheti i tij është i pamjaftueshëm për të kryer detyrat e tij në mënyrë efektive. Funksionet e sigurisë dhe aksidenteve në hekurudhë duhet të ndahen. Marrëveshja për kalimin e përbashkët kufitar me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë është nënshkruar. Hekurudhat e Kosovës vazhdojnë të ndikohen nga mungesa serioze e burimeve njerëzore dhe ndarja adekuate e fondeve. Një studim i realizueshmërisë për linjën hekurudhore 10, e cila është pjesë e rrjetit kryesor rajonal, është kryer por nuk ka institucione financiare ndërkombëtare të interesuara për të.

Nuk ka asnjë përparim për t'u raportuar lidhur me transportin e kombinuar.

Ka pasur ca përparim në fushën e **transportit ajror**. Implementimi i legjislationit nacional ka përparuar sa i përket rregulloreve ekonomike dhe fushave tjera që kërkohen në fazën e parë të Marrëveshjes evropiane për zonën e përbashkët të aviacionit (EKAA). Sa i përket disa ligjeve që kërkohen në fazën e dytë, janë miratuar masat nacionale për zbatim, por duhet të kontrollohet cilësia e tyre. Aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës është riklasifikuar si "lehtësues i orareve" nga korriku pas analizave për kapacitetet e tij. Kosova ende duhet t'i zbatojë elementet e rregullores së BE-së për ndarjen e slloteve.

Autoriteti i Kosovës për Aviacion Civil (AKAC) nuk është pjesë e standardizimit të sistemit dhe vlerësimit të sigurisë për aeroplanët e huaj, si pasoje e mosmarrëveshjes për statusin. Qendra e parë mjekësore e aviacionit është miratuar në janar dhe ka lëshuar certifikatat e para mjekësore për kontrolluesit e trafikut ajror në mars. Ligjet për krijimin e shërbimeve të navigacionit ajror si dhe hetimeve për aksidentet mbetet që të miratohen. Në menaxhimin e trafikut ajror, Kosova vazhdon të bëjë përparim të mirë sa i përket përafrimit rregullator me *acquis-in*, obligimet e saj të AKAC-it, me theks të veçantë tani në implementimin dhe

sigurimin e strukturës së qëndrueshme për autoritetin nacional mbikëqyrës. Sektori i Aviacionit në Kosovë vazhdon të vuaj si rezultat i kufizimeve të fluturimit përmbi Serbinë për fluturimet që vijnë dhe shkojnë nga Prishtina, gjë që ka edhe ndikim financiar për operatorët ajror dhe ndikim mjedisor për rajonin.

Në përgjithësi, përafrimi me *acquis*-in e BE-së për transportin është në proces e sipër. Kosova vazhdon të bëjë përparim solid në aviacion, por pengohet nga çështjet që ndërlidhen me statusin. Zhvillimi i hekurudhave ballafaqohet me buxhet të ulët që ndahet për këtë lloj të transportit, si pasojë e investimit tepër të madh në projektin rrugor. Kërkohen përpjekjet e mëtutjeshme për përmirësimin e sigurisë në rrugë dhe për zhvillim të hekurudhave të Kosovës.

4.2.5. Energjia

Sektori i energjisë vazhdon të vuaj nga probleme serioze. Ndërprerjet e rrymës vazhdojnë si pasojë e gjendjes së vështirë financiare të shërbimit të rrymës që rezulton nga vështirësitë lidhur me faturimin dhe arkëtimin e energjisë elektrike.

Nuk ka pasur asnjë zhvillim lidhur me sigurinë e **furnizimit me rrymë**. Kosova ende nuk ka asnjë strategji për krijimin e nivelit të kërkuar të rezervave të naftës. Implementimi i investimeve dhe mirëmbajtjes në pajtim me planin zhvillimor për transmisionin e energjisë elektrike 2010-2019 e ka bërë sistemin e transmisionit të Kosovës më të besueshëm. Operatori i sistemit të transmisionit të energjisë elektrike në Kosovë ende nuk merr pjesë në mekanizmat rajonal për të planifikuar dhe shpërblyer transitin e energjisë elektrike, për shkak të dallimeve lidhur me statusin e saj. Mungesa e kontrollit që rezulton nga kjo e vë në rrezik stabilitetin e sistemit të energjisë elektrike në Kosovë dhe Kosova i humb të hyrat nga transiti.

Ka pasur ca përparim lidhur me tregun e **brendshëm të energjisë** dhe implementimin e traktatit të komunitetit për energjinë. Në tetor, Kuvendi miratoi Legjislacionin për implementimin e Ligjeve për energjinë, energjinë elektrike dhe rregullatorin e energjisë për ta përafuar Kosovën edhe më tutje me pakon e dytë të tregut të brendshëm të energjisë në BE. Puna për zhvillimin e termocentralit të ri me ndezje të linjtit ka vazhduar. Kërkesa e fundit për propozime iu është dërguar katër ofertuesve të parakualifikuar. Në fund të vitit 2010, ka filluar eksploatimi i thëngjillit në minierën e Sibovcit, e cila do t'i ofrohet investitorëve si pjesë e termocentralit Kosova e re. Vështirësitë lidhur me shpronësimin e bëjnë të pamundshëm zbulimin e masës së nevojshme të thëngjillit, duke rrezikuar kështu furnizimin me thëngjill për termocentralet ekzistuese në një të ardhme të afërt. Sthurja ligjore e funksioneve të distribucionit dhe furnizimit të Korporatës Energjetike të Kosovës nuk ka ndodhur ende, përkundër obligimit për ta bërë këtë që buron nga Ligji për Energjinë Elektrike dhe nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Privatizimi i funksioneve të distribucionit dhe furnizimit të Korporatës Energjetike të Kosovës mbetet që të përfundohet. Deri në kompletimin e projektit të termocentralit Kosova e re, funksionet tjera mbeten të integruara në Korporatën Energjetike të Kosovës. Kompania e Serbisë për Energji Elektrike ende e mban një degë të palicencuar në veri të Kosovës. Si rezultat, Kosova nuk ka kontroll në rrjetin e vet, gjë që e privon Korporatën Energjetike të Kosovës nga të hyrat posaçërisht duke pasur parasysh se energjia elektrike devijohet nga Hidrocentrali i Gazivodës për ta furnizuar veriun.

Në mars, Qeveria e ka filluar implementimin e planit të veprimit për dekomisionimin e njësisive të mbetura operationale në Kosovën A me qëllim që ta përmbush direktivën për

centralet me djegie të lart. Mbyllja e planifikuar është shtyrë nga zotimi që ishte marrë nga Kryeministri në vitin 2009.

Zyra e rregullatorit të energjisë i ka mbajtur tarifat ekzistuese të energjisë elektrike, për shkak të rënies së çmimeve të importit dhe subvencioneve të vazhdueshme të Qeverisë për Korporatën Energjetike të Kosovës. Për shkak të privatizimit të pritshëm të funksioneve të distribucionit dhe furnizimit në korporatë dhe në mënyrë që tarifat të reflektojnë nivelet e kostos aktuale, rritja graduale është e pashmangshme. Zvogëlimi i subvencioneve të Qeverisë do ta lehtësonte këtë proces. Performanca e korporatës në faturim dhe inkasim është përmirësuar, por prapë mbetet brengë. Proporcioni i energjisë së furnizuar që paguhet aktualisht mbetet rrezikshmërisht i ulët: humbjet (qofshin ato teknike apo jo-teknike shkojnë më tepër se 30% të energjisë në dispozicion për shitje), që rezultojnë në humbje të afërsisht 100 milion eurove. Si rezultat i investimeve, janë zvogëluar humbjet në transmision. Nivelet e ulëta të inkasimit të faturave (dhe tarifave që nuk ndërlidhen me kthimin e kostos) vazhdojnë që të stimulojnë rritjet e paqëndrueshme të kërkesës për energji elektrike.

Ligji për **efiçencë të energjisë** është miratuar në qershor. Plani i veprimit që e shoqëron atë e që synon të rritë efiçencën e energjisë me 9% deri në vitin 2018, ende nuk është miratuar. Ligji parasheh përafrim me *acquis-in* në fushat siç është klasifikimi i energjisë, ekodizajni, performanca e energjisë së ndërtesave dhe efikasiteti në përdorimin përfundimtar të energjisë. Përveç kësaj, ai përbën bazën ligjore për themelimin e agjencisë për efikasitet të energjisë dhe parasheh procedurat për krijimin e fondit për efikasitet të energjisë për të promovuar projekte për efikasitetin e energjisë dhe burimet e ripërtërishme të energjisë. Në shtator, Kosova ka miratuar strategjinë e ngrohjes qëllimi i së cilës është, ndër të tjera, që të zvogëlojë përdorimin e energjisë elektrike për ngrohje të hapësirave. Janë bërë përgatitjet e mëtutjeshme teknike për projektin e bashke-gjenerimit në termocentralin Kosova B, për përdorimin e nxehtësisë së humbur për ngrohje të zonës, duke zvogëluar kështu edhe emetimin e CO₂-shit. Investimi aktual është në dyshim duke i pasur parasysh vështirësitë financiare në sektorin e ngrohjes së qytetit.

Drafti i parë i planit të thjeshtuar të veprimit për energji të ripërtërishme është përgatitur brenda kornizës së komunitetit të energjisë. Një synim i detyrueshëm për ndarje të energjisë së ripërtërishme në konsumin final të energjisë në vitin 2020 është përgatitur për Kosovën brenda kornizës së komunitetit të energjisë. Tri kompani ndërkombëtare kanë shprehur interesin e tyre për ndërtimin e hidrocentralit 300 MW. Janë paraqitur 15 aplikacione për ndërtimin e hidrocentraleve tjera të vogla me kapacitet të përgjithshëm prej 128 MW. Tri turbinat e para të erës në Kosovë me kapacitet të përgjithshëm prej 1.35 MW u funksionalizuan dhe rregullatori e autorizoi një kapacitet shtesë të energjisë së erës prej 126 MW. Kosova duhet të bëjë përpjekje të mëtutjeshme për të rritur sasinë e energjisë së ripërtërishme në konsumin final të energjisë dhe të ndërmarrë masa për të promovuar përdorimin e biokarburanteve në transport.

Në fushën e **sigurisë bërthamore dhe mbrojtjes nga rrezatimi**. Agjencia për mbrojtje nga rrezatimi dhe për siguri bërthamore është në proces të themelimit, në bazë të Ligjit të vitit të kaluar për mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizues, rrezatimi jonizues dhe siguria bërthamore. Drejtori dhe dy persona nga personeli janë emëruar dhe rekrutimet tjera janë në proces e sipër. Nuk ka asnjë operator për menaxhimin e mbeturinave radioaktive. Ligji i vitit të kaluar është shumë i përgjithshëm dhe duhet të ndryshohet dhe plotësohet me qëllim të transponimit të *acquis-it* të BE-së për siguri bërthamore dhe mbrojtje nga rrezatimi. Nevojiten përpjekje të konsiderueshme shtesë për Kosovën që ta inkorporoj këtë *acquis* dhe të jetë në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Në përgjithësi autoritetet kanë bërë ca përparim në përafrimin ligjor dhe në implementimin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Me qëllim të tërheqjes së investimeve nevojiten përpjekje të vazhdueshme në përmirësimin e faturimit dhe inkasimit të energjisë elektrike dhe nevojitet të kalohet në tarifa të pasubvencionuara që reflektojnë koston reale. Kërkohen përpjekje shtesë në përmirësimin e efikasitetit të energjisë nëpër të gjithë sektorët relevant përfaqësues krijimin e mekanizmave monitorues si dhe përmirësimin e përdorimit të energjisë së ripërtërishme në të gjithë sektorët. Kosova vazhdon të ndikohet negativisht nga ndërhyrja e Serbisë në sistemin e saj të energjisë elektrike.

4.2.6. *Shoqëria informative dhe mediet*

Ka pasur pak përparim sa i përket teknologjisë së komunikimit elektronik dhe të informimit. Politikat e sektorit të telekomunikacionit të vitit 2007 janë caktuar për rishikim këtë vit. Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART) i ka miratuar disa rregullore implementuese: rregulloren për analiza të tregut dhe përcaktimin e ofruesve me fuqi të ndjeshme në treg, rregulloren për bashkë-shfrytëzim të plotë dhe të përbashkët të nyjes lokale dhe rregullorja për sigurimin e qasjes dhe interkoneksionit. Kosova ka ngecur prapa me implementimin e garancive të konkurrencës dhe ende nuk ka kod telefonik ndërkombëtar, e as emër të domenit të kodit të internetit për shtetin. Kompanitë e palicencuara (të Serbisë) vazhdojnë të operojnë në Kosovë. Kjo ndërhyrje në menaxhimin e spektrit nga Kosova.

Procesi i privatizimit të Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK) është në vazhdim e sipër, por vonesat procedurale kanë ndikim negativ në zhvillimin rregullator të tregut. Menaxhimi i sektorit të telekomunikimeve iu është transferuar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, por pa ndonjë përmirësim në kapacitetin administrativ. Kapaciteti njerëzor dhe financiar i rregullatorit për të siguruar implementim dhe zbatim është i pamjaftueshëm, dhe ART ka vështirësi në tërheqjen dhe mbajtjen e stafit. Pavarësia financiare e rregullatorit është e ndrydhur, pasi që financohet tërësisht nga buxheti i shtetit.

Nuk ka pasur zhvillime në fushën e **shoqërisë informative**. Ligji për organet qeveritare të shoqërisë informative nuk është miratuar. Ky Ligj është i rëndësishëm për të krijuar bazën ligjore për agjenci të e-Qeverisjes dhe një forum të Qeverisë për shoqërinë informative. Ndarja e përgjegjësisë dhe detyrave ndërmjet Ministrive të ndryshme dhe niveleve të Qeverisë për çështjet e shoqërisë informative duhet të qartësohet. Mund të raportohet për një masë të përparimit në fushën e **politikave audio-vizuale**. Komisioni i Pavarur për Media (KPM) ka lëshuar disa rregullore siç është rregullorja për mbrojtjen e të miturve dhe fëmijëve, rregullorja për tarifën e licencimit në KPM dhe rregullorja për operatorët kabllor me qëllim të përafrimit të legjislacionit në Kosovë me direktivën e BE-së për media audio vizuale. Për herë të parë, KPM ka monitoruar fushatën zgjedhore. Këshilli i KPM-së gjithashtu e ka kompletuar edhe procesin e licencimit të transmetuesve tokësor dhe operatorëve kabllor. Gjatë vitit 2010, KPM i ka ripërtërirë licencat e punës të të gjitha stacioneve ekzistuese televizive që përdorin frekuenca për transmetim. Nuk ka ndonjë kërkesë të domosdoshme për operatorët kabllor lidhur me përfshirjen e TV stacioneve lokale tokësore dhe atyre me mbulim në tërë Kosovën në pakot e tyre kabllore. Shumica e operatorëve kabllorë mbajnë stacione me shtrirje në mbarë Kosovën dhe stacione lokale televizive vetëm në bazë të një tarife (dhe i heqin ato nga pakoja e tyre në rast të vonës në pagesa), gjë që në mënyrë serioze e kufizon të drejtën e audiencës për të pasur qasje në kanalet tokësore pa pagesë.

Kuvendi i Kosovës ende nuk ka bërë emërimin e pesë anëtarëve të Këshillit të KPM-së. Gjykata Supreme ende nuk i ka emëruar anëtarët/kryesuesin e bordit të KPM-së për ankesa të

medie. Kapaciteti administrativ i komisionit është forcuar, por pagat e ulëta relative për këtë industri e bënë të vështirë që KPM-ja të tërheqë dhe të mbaj stafin.

Kuvendi e ka vazhduar procesin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim. Një projektligj i cili kishte dështuar ta ruajë pavarësinë e KPM-së ashtu siç kërkohet nga standardet evropiane për rregullimin e transmetimit, është tërhequr. KPM-ja ka bërë ca përparim sa i përket procesit të digjitalizimit përfshirë krijimin e pesë grupeve punuese. Strategjia e digjitalizimit nuk është miratuar ende. Kosova nuk është anëtare e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), prandaj edhe nuk ka qenë në pozitë për të kërkuar frekuenca digjitale. Serbia ka kërkuar nga ITU-ja që ta ndaj një frekuencë në emër të Kosovës. Kjo është e pamjaftueshme.

Kuvendi i Kosovës ka dështuar që të ndërmarrë veprime lidhur me financimin e qëndrueshëm të transmetuesit publik të Kosovës Radiotelevizionit të Kosovës. Në të njëjtën kohë ka pasur diskutime të shumta dhe një projektligj i pakënaqshëm është tërhequr në gusht. Financimi i tij ka ardhur nga buxheti i Kosovës në baza ad-hok gjatë vitit 2011, dhe buxheti i transmetuesit është zvogëluar nga €10.5 milion në rreth €8 milion. Mungesa e financimit të qëndrueshëm e dëmton pavarësinë e RTK-së.

Për shkak të pezullimit të mbledhjes së tarifës publike për RTK-në, transmetuesi nuk ka mundur t'i ndajë 5% të tarifës së vet për fondin për mbështetje të medieve të pakicave, shumetnike dhe medieve tjera të veçanta, siç kërkohet me Ligj. Shpërndarja e fondit e cila ishte e rinisur në vitin 2009, është ndaluar prapë. Medieve të pakicave nuk iu është dhënë informatë për dhënien e fondeve fillestare, edhe pas disa kërkesave zyrtare të bëra nga ta. Papajtueshmëritë ndërmjet Ligjit për Shpifje dhe Fyerje dhe Kodit Penal nuk janë zgjidhur ende. Sipas standardeve evropiane shpifja nuk është vepër penale. Kosova nuk i aplikon dispozitat penale për shpifje, mirëpo për shkak se ato vazhdojnë të mbeten në ligj, pasiguria ligjore është ende e pranishme.

Në përgjithësi kapacitetet administrative si të organeve rregullatore ashtu edhe Ministrisë duhet të forcohen. Sa i përket komunikimeve elektronike, Kosova duhet ta kompletojë futjen e garancive të konkurrencës dhe të ndërtoj kapacitete për zbatimin e vendimeve të rregullatorit. Si çështje urgjente, Kosova duhet të zhvilloj një zgjidhje për financim të qëndrueshëm të transmetuesit të shërbimit publik: financimi aktual vetëm nga buxheti e minon pavarësinë e RTK-së. Përveç kësaj, ligji i ardhshëm i Komisionit të Pavarur për Media duhet ta ruajë pavarësinë e Këshillit të KPM-së.

4.2.7. *Kontrolli Financiar*

Ka pasur ca përparim në **kontrollin e brendshëm financiar publik**. Një dokument i politikave të kontrollit të brendshëm financiar publik është miratuar në maj. Njësia qendrore për harmonizim të menaxhimit dhe kontrollit financiar ka publikuar një doracak për menaxherët në organizatat buxhetore në mënyrë që të respektojnë rregullin e miratuar vitin e kaluar për menaxhim dhe kontroll financiar. Materiale trajnuese në fushën e kontrollit të brendshëm financiar janë duke u zhvilluar. Është miratuar një Udhëzim Administrativ për detyrat dhe funksionimin e këshillave të auditimit të brendshëm në organizatat buxhetore. Trajnimi në fushën e auditimit të brendshëm ka vazhduar, gjë që ka shpjerë në certifikimin e më shumë auditorëve të brendshëm. Ky proces i certifikimit duhet të vazhdoj dhe numri i përgjithshëm i auditorëve të brendshëm duhet të rritet. Njësia qendrore e harmonizimit për auditim të brendshëm e ka kompletuar doracakun për menaxhimin e rrezikut dhe të dhënave dhe ka filluar një program për ngritjen e vetëdijes së ministrive, sekretarëve të përhershëm

dhe kryeshefave ekzekutive të ndërmarrjeve publike lidhur me rëndësinë e auditimit të brendshëm.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm e ka përditësuar strategjinë e saj për zhvillim të përbashkët. Objektivi kryesor që kërkohet të arrihet deri në vitin 2014 është themelimi i zyrës si një institucion i qëndrueshëm i cili e kryen punën e vet sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe siguron që organet e audituara t'i adresojnë rekomandimet në mënyrë efektive. Që nga shtatori i vitit 2010, Zyra ka kryer një numër të auditimeve të performancës dhe menaxhmentit si dhe kontrollove të menaxhimit financiar në të gjitha organizatat buxhetore të cilat nuk janë audituar plotësisht, për t'u siguruar që të gjithë shpenzuesit e buxhetit do të vizitohen në çdo sezon të auditimit. Numri i auditimeve të rregullta është rritur dhe një numër i vogël i auditimeve për komunat është kontraktuar me firmat private të auditimit.

Në përgjithësi, është arritur ca përparim në kontrollin financiar. Sa i përket auditimit të brendshëm është krijuar korniza ligjore baze dhe përqendrimi tani duhet të bartet tek implementimi i saj. Implementimi në praktikë i kontrollit të brendshëm financiar publik ka mbetur në faza të hershme. Auditimi i brendshëm duhet të përparojë nga testimi i pajtueshmërisë në përdorimin e tij si vegël për menaxhim. Kërkohet ngritje e mëtutjeshme e vetëdijes për zhvillim të të kuptuarit më të gjere të llogaridhënës brenda menaxhmentit dhe të mishërimit të menaxhimit financiar dhe sistemeve të kontrollit. Praktikrat e auditimit të jashtëm janë duke përparuar mirë.

4.2.8. *Statistikat*

Ka pasur ca përparim sa i përket **infrastrukturës statistikore**. Bashkëpunimi i Entit Statistikor të Kosovës në institucionet tjera është përmirësuar. Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për procedurat tatimore tani e lejojnë administratën tatimore që t'i ofrojë entit të dhënat e nevojshme administrative për regjistrin statistikor të bizneseve. Infrastruktura statistikore e Kosovës duhet të forcohet. Entit i mungojnë burimet e nevojshme si dhe korniza ligjore për kryerjen e mandatit të saj.

Ka pasur përparim të kufizuar në **klasifikim dhe regjistra**. Nevojiten përpjekje për implementimin e aktiviteteve të klasifikimit ekonomik evropian NACE Rev. 2 (NACE = Nomenklatura Statistikore e Aktiviteteve Ekonomike në Komunitetin Evropian).

Sa i përket **statistikave sektoriale**, është arritur ca përparim shumë i mirë në fushën e statistikave të popullatës. Në prill, enti statistikor e ka bërë regjistrimin e shtëpive dhe popullatës. Gjate tërë fazës përgatitore, Zyra i ka respektuar të gjitha afatet e punës dhe ka qene e gatshme që ti shpërndaj gati 5000 numërues me 1 prill. Në shtatë komuna numërimi është shtyrë për katër ditë për shkak të numërimit të vogël apo vështirësive teknike. Është bërë një hulumtim pas numërimit me qëllim të verifikimit të cilësisë së të dhënave. Një fushate intensive një mujore i ka paraprirë fazës së numërimit. Janë bërë përpjekje të posaçme përmes daljes në teren për t'i informuar komunitet pakice lidhur me regjistrimin. Të dhënat preliminare janë publikuar në qershor. Përpunimi i më shumë të dhënave të detajuara është në proces e sipër.

Regjistrimi në tri komunat veriore dhe në Mitrovicë të Veriut nuk ka ndodhur. UNOPS (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve) ishte mandatuar për implementimin e regjistrimit në komunat veriore, por mungesa e bashkëpunimit nga komunat e mbështetura nga Serbia i ka pamundësuar UNOPS-it kryerjen e numërimit.

Sa i përket fushave tjera të statistikave sektoriale, është arritur përparim i kufizuar. Kjo kryesisht për shkak të burimeve të shpenzuara në regjistrim dhe buxhetit të limituar të entit statistikor: si anketa për fuqinë punëtore ashtu edhe anketa për ekonominë familjare që merren me bujqësi janë anuluar në vitin 2010 për shkak të mungesës së burimeve. Statistikat makroekonomike janë prodhuar me kohe. Që nga nëntori e tutje, Ministria e Financave publikon të dhënat mujore për shpenzimet dhe të hyrat publike në faqen e saj të internetit. Llogaritë ekonomike për bujqësi janë publikuar për herë të parë në korrik të vitit 2011, dhe kanë mbuluar periudhën 2005-2008.

Në përgjithësi është arritur ca përparim në fushën e statistikave. Autoritetet kanë realizuar regjistrimin e popullatës dhe shtëpive në mënyrë të kënaqshme. Kjo ofron një bazë të rëndësishme për përmirësim të statistikave në Kosovë. Regjistrimit nuk ka mund të organizohet në komunat veriore. Për shkak të burimeve të kufizuara të entit statistikor, përparimi është ngadalësuar në fushat tjera. Korniza Ligjore duhet të përmirësohet dhe kapaciteti i entit statistikor duhet të forcohet. Statistikat janë esenciale për vendimmarrje të bazuar në dëshmi, dhe mungesa e statistikave të besueshme në Kosovë duhet të adresohet si çështje prioritare.

4.3. Drejtësia, liria dhe siguria

4.3.1. Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migrimi

Kosova nuk ka asnjë **politikë të vizave**. Qeveria e ka iniciuar procedurën për krijimin e sistemit të politikave për vizat, dhe Ministria për Punë të Jashtme e ka krijuar grupin punues për këtë qëllim. Në pajtim me Ligjin për të huajt, Ministria e Punëve të Brendshme e ka filluar implementimin e “procedurës së vizitorëve” me anë të së cilës të huajt kërkohen që të dërgojnë një numër të dokumenteve para ardhjes në Kosovë.

Deri në fund të qershorit, më tepër se 827,000 pasaporta janë lëshuar nga Agjencia e regjistrimit civil, rreth 1,600 e së cilëve për serbët e Kosovës, numri i vogël i mbetur i dokumenteve valide të udhëtimit të UNMIK-ut (30) do të skadojnë në dhjetor të vitit 2011. Disa banorë të Kosovës i kanë mbajtur pasaportat e vjetra jugosllave, të cilët mbesin të vlefshme deri në dhjetor të vitit 2011.

Ligji i ndryshuar dhe i plotësuar për gjendjen civile është miratuar në qershor. Ministria e Punëve të Brendshme ka filluar t’i adresojë mangësitë në sistemin e saj të regjistrimit civil përmes procesit të digjitalizimit duke finalizuar skanimin e 14,000 librave të regjistrimit të gjendjes civile (4 milionë regjistrime). Kjo do të përcillet me fazën e dytë të futjes së të dhënave në bazën e re qendrore të të dhënave të gjendjes civile. Baza e të dhënave duhet të integrohet në regjistrin civil të Kosovës. Njësia e inspektoratit e Agjencisë së regjistrimit civil e themeluar në fillim të vitit 2011 me mandat për të kontrolluar integritetin e procesit lidhur me gjendjen civile, librat e regjistrimit civil, regjistrimin e veturave dhe lëshimin e patentë shofereve, është duke punuar mirë ndonëse me kapacitet të kufizuar.

Përgatitjet për lëshimin e pasaportave biometrike të Kosovës. Procesi i lëshimit të pasaportave biometrike duhet të përcillet me regjistrim civil të saktë dhe të besueshëm. Bashkëpunimi ndërmjet ambasadave/zyrave lokale dhe agjencisë për nevojat e regjistrimit civil duhet të forcohet për të përmirësuar trajtimin e duhur të mashtrimeve të raportuara që përfshijnë certifikatat e gjendjes civile apo dokumentet e identitetit.

Në përgjithësi, Kosova është në fazat e hershme sa i përket politikave të vizave.

Përkitazi me **menaxhimin e kufijve**, Kosova ka arritur ca përparim. Versioni i përmirësuar i sistemit të TI-së për menaxhimin e kufijve i financuar nga BE-ja u funksionalizua në pothuajse të gjitha vendkalimet kufitare si dhe në qendrat e komandës policore si qendrore ashtu edhe rajonale. Task-forca e përbashkët e doganave dhe shërbimeve policore e cila u themelua për të luftuar kriminalitetin tej kufitar dhe kontrabandën ka filluar që të bëjë vlerësimet e përbashkëta të rrezikut. Tri agjencitë e përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit (policia kufitare, doganat dhe agjencia e ushqimit dhe veterinarisë) kanë organizuar patrullat të përbashkëta përgjatë vijës kufitare. Janë organizuar edhe veprimet e përbashkëta operacionale në pikat e kalimeve kufitare. Shumë struktura të menaxhimit të integruara të kufirit janë krijuar.

Marrëveshjet që mundësojnë patrullime të përbashkëta dhe të sinkronizuara të policisë në kufi janë nënshkruar ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Patrullat e përbashkëta janë filluar. Policia kufitare e Kosovës ka nxjerrë procedura të reja standarde të operimit për procedurat e kontrollit në kufi. Policia e Kosovës e ka marrë përgjegjësinë nga KFOR-i për vëzhgimin e kufirit me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi. Procesi i demarkacionit të kufirit me Malin e Zi nuk është filluar ende.

Në janar, doganat kanë nënshkruar dy memorandume të mirëkuptimit me Agjencinë Kosovare të Inteligjencës dhe me Prokurorin e Shtetit me qëllim të forcimit të bashkëpunimit. Policia kufitare dhe doganat e kanë nënshkruar një protokoll të bashkëpunimit në muajin maj, i cili synon përmirësimin e bashkëpunimit lidhur me procedurat e kufirit, luftën kundër trafikimit të paligjshëm dhe implementimin e menaxhimit të integruar të kufirit.

Cilësia dhe njëtrajtshmëria e kontrolleve kufitare ende duhet të përmirësohet. Parimet e menaxhimit të integruar të kufirit nuk zbatohen sa duhet në praktikë. Qendra e përbashkët operative për kontrollin e kufirit nuk është plotësisht funksionale, pasi që policia kufitare nuk ka qasje në bazën e vet të të dhënave. Nevojiten ndërlidhje të mëtutjeshme ndërmjet hisedarëve të ndryshëm në mënyrë që të zhvillohen dhe zbatohen plane të përbashkëta operative, të përdoren pajisje të përbashkëta dhe sisteme të integruara të menaxhimit të të dhënave në bazë të procedurave standarde të operimit të miratuara. Shkëmbimi i pamjaftueshëm i informatave me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë pengon luftimin e krimin të kufitar. Veriu i Kosovës mbetet sfidë në veçanti për menaxhimin e integruar të kufirit.

Në përgjithësi, Kosova ka arritur ca përparim, por është ende në një fazë të hershme të adresimit të sfidave të menaxhimit të integruar të kufirit.

Në fushën e **azilit** është arritur përparim. Kosova është ballafaquar me rritje të kërkesave për azil (31 persona kane kërkuar azil në vitin 2009, në vitin 2010 ky numër ka arritur në 271, dhe ka pasur 147 kërkesa në gjysmën e parë të vitit 2011). Me implementimin e modelit të ri të azilit të prezantuar në vitin 2010 numrat priten të jenë më të ulët në të ardhmen. Numri i azilkërkuësve në procedure ishte 25 në korrik. Shumica e kërkuësve e kishin keqpërdorur procedurën e azilit për ta legalizuar hyrjen dhe qëndrimin e tyre në Kosovë para fillimit të udhëtimit të tyre drejt shteteve të BE-së.

Në bazë të Ligjit për Azilin, autoritetet e Kosovës e kanë sistematizuar lëshimin e dokumenteve të identifikimit për azilkërkuësit. Deri në fund të qershorit, përmbi 300 vendime të shkallës së parë janë lëshuar nga Departamenti për Azil, Shtetësi dhe Migracion. Shumica e vendimeve të marra lidhur me kërkesat e azilit kanë qenë negative *në mungesë* (azil kërkuësit ishin larguar nga Kosova). Vetëm një numër i kufizuar i rasteve janë shqyrtuar në

bazë të meritës. Një udhëzues sqarues lidhur me obligimet dhe të drejtat e azil kërkuesve është zhvilluar dhe shpërndarë. Sistemi i azilit i themeluar me ndihmën e EULEX-it i lejon Kosovës që të veprojë sipas obligimeve të veta ndërkombëtare, duke ia mundur Kosovës që të bëjë dallim ndërmjet personave që kanë nevojë për ndihmë ndërkombëtare dhe atyre që nuk e kanë këtë nevojë. Zbatimi i tij mbetet sfidë.

Ekzistojnë mangësi në procedurat e azilit. Kapacitetet dhe trajnimet janë aktualisht të pamjaftueshme. Mungesa e shërbimeve të duhura të përkthimit e pengon komunikimin me azil kërkuesit dhe kontrollimin fillestar të rastit, përcaktimin e origjinës së personit dhe informatat operative që mund të merren. Ka mungesë të ndërtesave adekuate për ata azil kërkues që janë në pritje për t'u kthyer pas refuzimit të kërkesave të tyre. Kapaciteti i qendrës së azilit është i kufizuar me 25 persona. Nëse qendra është plot, azil kërkuesit strehohen nëpër hotele. Mungesa e marrëveshjeve për ripranim me shtetet e origjinës apo të transitit është gjithashtu brengë e madhe. Ka raste për përcaktimin e statusit të refugjatit të cilat nuk janë procesuar brenda periudhës kohore të parapare me Ligj. Kapaciteti i Komisionit Nacional për refugjatë për t'i trajtuar ankesat kundër vendimeve të shkallës së parë janë të pamjaftueshme. Nga shtatë ankesa të bëra kundër vendimeve të shkallës së parë, Komisioni Nacional për refugjatë ka marrë vendim negativ në gjashtë raste. Nuk është bërë asnjë ankesë në Gjykatën Supreme.

Ekzistojnë edhe raste në të cilat është marrë vendim negativ, por për to nuk është parashtruar ankesë. Këta azil kërkues të refuzuar kanë qëndruar të akomoduar në vende të përkohshme, në pritje të ekzekutimit të vendimeve për kthim apo të ndonjë mase tjetër. Një bazë e besueshme e të dhënave për azil kërkuesit ende mungon. Ekziston një bazë e thjeshtë të të dhënave, por lidhja ndërmjet Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim dhe policisë përgjegjëse për kontrollin fillestar, ende mungon. Të gjitha këto sfida kontribuojnë në faktin që shumica e azil kërkuesve e braktisin Kosovën edhe para finalizimit të procedurës.

Në përgjithësi, është arritur përparim në çështjen e azilit. Kosova duhet ta vazhdojë adresimin e sfidave të mbetura.

Kosova ka arritur përparim në fushën e migrimit. Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim ka lëshuar leje qëndrimi dhe letërnjoftime për të huajt. Ka pasur një rritje të migruesve të parregullt që kanë bërë përpjekje të hyjnë në Kosovë përmes kufijve ajrorë apo tokësorë, në veçanti atyre me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërinë. Policia kufitare e Kosovës ua ka ndaluar hyrjen disave prej tyre në bazë të Ligjit për të huajt.

Kosova ka nënshkruar marrëveshje të reja të ripranimit me vendet e treta. Gjithsej trembëdhjetë shtete janë përfshirë në ato marrëveshje (Shqipëria, Austria, Belgjika, Republika Çeke, Danimarka, Franca, Gjermania, Luksemburgu, Mali i Zi, Holanda, Norvegjia, Sllovenia dhe Zvicra). Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim ka vazhduar të merret me kërkesat për ripranim nga Shtetet Evropiane në mënyrë efektive. Kosova ka arritur përparim të konsiderueshëm sa i përket riintegrimin të personave të riatdhesuar. Ajo i ka forcuar kapacitetet e veta për riintegrimin e personave të riatdhesuar, përfshirë edhe në nivelin komunal. Përmbi 3 milionë € janë ndarë për riintegrimin e personave të riatdhesuar nga buxheti i vitit 2011. Një zyrë që merret me personat e riatdhesuar është hapur në aeroport. Ka pasur përpjekje të serishme për të trajnuar zyrtaret komunal dhe për të përmirësuar komunikimin dhe informimin e personave të riatdhesuar. Regjistri civil është përmirësuar. Koordinimi ndërministror është përmirësuar, si dhe komunikimi dhe bashkërendimi ndërmjet niveleve lokale dhe qendrore. Shërbime të përkohshme si kujdesi

mjekësor, transportimi dhe akomodimi janë krijuar dhe ofruar. Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare është përmirësuar.

Kosova duhet të bëjë përparim shtesë në menaxhimin e rrjedhës së migrimit, në bazë të sistemit të integruar profesional të informatave. Kjo do ta bënte të mundshëm gjurmimin e personave të riatdhesuar dhe plotësimin e nevojave të tyre, si dhe do të ofronte të dhëna të besueshme statistikore dhe informata. Numri i propozimeve për asistencë në riintegrim të personave të riatdhesuar nga komunat është duke u rritur, por është ende i ulët. Vetëm një numër i kufizuar i personave kanë përfituar nga fondi i riintegrimit. Trajnime të përditësuar dhe të përmirësuar janë të nevojshme. Shkëmbimi i informatave ndërmjet shteteve dërguese dhe Kosovës duhet të forcohet. Zyrat e riatdhesimit duhet të themelohen edhe në katër komuna. Papunësia vazhdon të jetë një pengesë për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

Kosova gjithashtu duhet të bëjë përpjekje të mëtutjeshme për t'u siguruar përputhje të plotë me *acquis* e BE-së në çështjen e migracionit të ligjshëm, pra në të drejtën për ribashkimin familjar.

Në përgjithësi, është arritur përparim në çështjen e migrimit. Ripranimi ka vazhduar të funksionoi në mënyrë të kënaqshme dhe ka pasur përmirësim të konsiderueshëm sa i përket riintegrimit të personave të riatdhesuar, kryesisht në nivel komunal. Përpjekjet për të trajtuar migrimin e parregullt duhet të vazhdojnë. Kanë mbetur disa sfida në procesin e riintegrimit dhe përpjekjet e pandërprera dhe përkushtimet në këtë fushë duhet të vazhdojnë.

4.3.2. *Pastrimi i Parave*

Kosova ka pasur përparim të kufizuar në adresimin e krimit ekonomik / financiar dhe pastrimit të parave. Ka filluar zbatimin e legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave. Ka filluar një transferim gradual i përgjegjësisë të Qendrës së Inteligjencës Financiare nga EULEX-i tek autoritetet e Kosovës. Drejtori Kosovar për Qendrën është emëruar në mars. EULEX-i ka mbajtur disa kompetenca ekzekutive. Korniza organizative që ka të bëjnë me krimet ekonomike, financiare dhe pastrimin e parave është komplekse. Njësia për Hetime Financiare në kuadër të Drejtorisë për Hetimin e Krimit të Organizuar është përgjegjëse vetëm për të ashtuquajturat raste të integruara (rastet financiare të lidhura ngushtë me krim të organizuar), por jo për rastet e krimit të pavarur financiar. Drejtorja për Hetime të Krimit Ekonomik dhe për Korrupsion e Policisë së Kosovës (DHKEK) dhe Task-Forca e sapokrijuar për anti-korrupsion e mbikëqyrur nga Prokuroria Speciale (PSRK-AKTF), merret me të gjitha llojet e krimeve financiare. DHKEK trajton krimin e rregullt financiar dhe rastet e pastrimit të parave dhe PSRK-AKTF përqendrohet në rastet e profilin të lartë dhe rastet e ndërlikuara.

Tetë bankat e Kosovës e kanë përmirësuar cilësinë dhe besueshmërinë së raporteve të tyre financiare për Qendrën e Inteligjencës Financiare. Zyrat e këmbimit dhe dërguesit e parave kanë përmirësuar po ashtu mënyrën në të cilën ata i përmbushin detyrimet e tyre të raportimit. Bashkëpunimi në mes të Qendrës dhe doganave ka mbetur i mirë dhe një nga oficerët doganorë të Kosovës është deleguar në Qendër, si analist financiar dhe zyrtar i ndërlidhjes. Në vitin 2010, Drejtorja kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit ka hetuar mbi 700 raste nga të cilat rreth 500 me kryerës të njohur të veprës janë dërguar në prokurori. Mbi 170 të dyshuar janë arrestuar. Dëmi i vlerësuar është rreth €27 milion. Agjencia për menaxhimin e aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara, e themeluar në vitin 2010, është pothuajse e plotësuar me personel. Personeli ka pasur disa trajnime. EULEX-i gjithashtu ka trajnuar gjyqtarë dhe prokurorë për zbatimin e legjislacionit ekzistues për konfiskimin e aseteve. Shumë pak asete janë konfiskuar deri më tani.

Niveli i bashkëpunimit ndërmjet Qendrës dhe subjekteve raportuese është i përzier. OJQ-të duhet të përmbushin detyrimet e tyre financiare të raportimit në zyrën e regjistrimit të OJQ-ve në Ministrinë e Administratës Publike. Ky raportim nuk është sistematik, dhe është një çështje për brengosje, për shkak të statusit heterogjen të OJQ-ve në Kosovë. Sipas ligjit aktual kundër shpëlarjes së parave, ndryshe nga rregullorja e mëhershme e UNMIK-ut 2004/2, organizatat afariste nuk duhet t'ia raportojnë Qendrës transaksionet me para të gatshme prej më tepër se 10.000 € Kapaciteti i Kosovës për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet ekonomike mbetet i kufizuar. Përcjellja e raporteve të Qendrës nga organet e zbatimit të ligjit është e kufizuar. Konfiskimi i pasurive në rastet e pastrimit të parave dhe krimet ekonomik duhet të forcohet dhe adresohet në një fazë më të hershme të hetimit.

Shuma të mëdha parash vazhdojnë të investohen në pasuri të patundshme, restorante dhe kazino pa mbikëqyrje adekuate. Transaksionet financiare të ndërlidhura me bizneset në xhirollogari private dhe një numër i madh i subjekteve që bëjnë biznes pa qenë të regjistruara vazhdojnë të jenë të përhapura. Operacioni që filloi në vitin 2010 me qëllim të identifikimit të aktivitetit të paligjshëm në lidhje me importin dhe eksportin e sasive të mëdha të parave në aeroportin e Kosovës ka mbetur ad-hok. Kjo nuk është përfshirë në punën rutinore të doganave.

Prokurorëve dhe gjyqtarëve u mungon përvoja dhe specializimi në këtë fushë. Ka vështirësi të mëdha për të identifikuar, monitoruar dhe konfiskuar të ardhurat nga krimi i lidhur me grupe të organizuara. Ekzistojnë zbrazëtira në legjislacionin ekzistues, veçanërisht në dispozitat dhe sanksionet e kodit penal për pastrimin e parave. Këto nuk janë adekuate, dhe duhet të adresohen urgjentisht.

Në përgjithësi, pastrimi i parave mbetet një çështje serioze brengosëse dhe Kosova është në një fazë fillestare në këtë fushë. Kosovës vazhdojnë t'i mungojnë burimet adekuate teknike dhe njerëzore për adresimin e këtyre veprave penale.

4.3.3. Droga

Kosova ka bërë përparim të kufizuar në luftën kundër trafikimit të drogës. Flukset vazhdojnë të përfshijnë heroinën dhe drogat sintetike që vijnë nga Lindja e Mesme përmes Turqisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë përmes njërit nga korridoret kryesore të Ballkanit për tregjet e Evropës, dhe kokainën që vjen përmes Shqipërisë dhe Malit të Zi. Dërgesat e drogës ripaketohen në Kosovë dhe dërgohen në tregjet Evropiane në sasi më të vogla. Tregu i brendshëm është rritur gjithashtu, sidomos për kokainë. Ka pasur lëvizje të narkotikëve në të gjithë kufijtë ku janë përfshirë kamionë, autobusë dhe automjete private.

Ka disa rezultate të prekshme në luftën kundër trafikimit të drogës. Policia e ka rritur numrin e arrestimeve për veprat e narkotikëve, përfshirë veprat penale të trafikimit; janë hetuar rreth 200 raste për narkotikë prej mesit të tetorit deri në fund të qershorit dhe kanë rezultuar në arrestimin e mbi 300 të dyshuarve. Në gjysmën e parë të vitit 2011, policia bëri më shumë se 200 arrestime. Rreth 180 nga këta të arrestuar u ndaluan në pritje të procedurës gjyqësore. Janë shkatërruar disa grupe kriminale të përfshira në trafikim të drogës. Kosova ka bërë edhe disa operacione të përbashkëta me vendet fqinje. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i të dhënave me Shqipërinë dhe me Malin e Zi është i mirë dhe janë bërë kontaktet e para me kolegët nga ish Republika Jugosllave e Maqedonisë. Drejtoria e policisë për Hetime të trafikimit të drogës ka ndërtuar kapacitetet dhe ka rekrutuar personel të ri. Ajo ka marrë pjesë në një ushtrim të përbashkët për të dërgimin e kontrolluar të drogave të paligjshme ku ka pasur bashkëpunim me agjencitë tjera të zbatimit të ligjit nga Kosova dhe vendet e treta. Është përmirësuar

mbledhja e të dhënave dhe metodologjia për regjistrimin e të dhënave. Pas implementimit të vazhdueshëm të strategjisë kundër drogës ka një përmirësim të bashkëpunimit në mes të policisë, doganave dhe shërbimeve korrektuese.

Sasia e aseteve të sekuestruara mbetet e ulët: në gjysmën e parë të vitit 2011, mbi 30 kg heroinë, rreth 90 kg marihuanë, 2.5 kg kokainë dhe rreth 700 tableta ekstazë janë sekuestruar. Rastet nuk përcillen në mënyrë adekuate nga Gjyqësori. Ka mungesë të prokurorëve me përvojë dhe të specializuar. Pozita e koordinatorit për ndjekjen e narkotikëve mbetet e pa plotësuar. Burimet për zbatimin e politikave për ndjekjen e narkotikëve janë të pamjaftueshme (ka mungesë të personelit, hapësirës së punës dhe pajisjeve) dhe gjithashtu mungon një qasje e udhëhequr nga inteligjenca. Me përjashtim të disa oficerëve të trajnuar, nuk ka njësi të fshehtë adekuate në polici. Njësitë policore me qen janë të pranishme në disa pika kufitare dhe janë duke punuar në përputhje me planin e departamentit të policisë kufitare. Njësi të tjera të policisë mund të kërkojnë ndihmën e njërive policore me qen, nëse kërkohet, por shërbimet e tyre nuk janë shumë të kërkuara. Shkëmbimi i të dhënave me Malin e Zi dhe ish-Republikën Jugosllave Republikën e Maqedonisë është ende i kufizuar. Ka mangësi serioze në adresimin e sfidave të kërkesës për drogë në vend, duke përfshirë kapacitetet e papërshtatshme për trajtim në spital. Programi i mirëmbajtjes me Metadon nuk është në dispozicion.

Në përgjithësi, përpjekjet e Kosovës në luftën kundër trafikimit të drogës nuk kanë qenë të mjaftueshme për të adresuar sfidën me të cilën Kosova është duke u ballafaquar në këtë fushë.

4.3.4. Policia

Kosova ka pasur ca përparim për sa i përket policisë. Drejtori i Përgjithshëm i policisë i emëruar në tetor të vitit 2010 mori një sërë vendimesh në përmirësimin e funksionimit të policisë, p.sh. duke e integruar më mirë shtyllën e krimit, dhe duke synuar për të kufizuar nivelin e ndikimit politik. Është miratuar plani vjetor i veprimit për vitin 2011 dhe ai zbatohet në përputhje me planin për zhvillim për vitet 2011-2015. Është përfunduar rishikimi gjashtëmujor i organizatës dhe ka çuar në miratimin e një strukture organizative të përmirësuar. Kosova ka finalizuar planin strategjik për informim, i cili është një përvijim i planit të përgjithshëm që ka për qëllim të bëjë zhvillimet e TI-së të më të qëndrueshme gjatë viteve të ardhshme. Është miratuar Ligji për Inspektoratin e Policisë dhe janë qartësuar përgjegjësitë në mes të Inspektoratit dhe njësisë së standardeve të policisë. Komandanti i Policisë rajonale në Prizren është arrestuar dhe akuzuar si pjesë e hetimeve për krime të luftës. Kontratat e katër nga shtatë komandantët e stacioneve policore në veri të Kosovës janë ndërprerë, bazuar në një rekomandim nga komisioni për emërimet të larta dhe nga komisioni disiplinor i policisë.

Në qershor Policia ka themeluar edhe Njësinë për koordinimin e zbatimit ndërkombëtar të e ligjeve për të lehtësuar bashkëpunimin me agjencitë e zbatimit të ligjit nga vendet e treta. Zyra Ndërlidhëse e Interpolit është ende nën përgjegjësinë e UNMIK-ut dhe disa policë të Kosovës në janë caktuar në këtë zyrë. Është përmirësuar bashkëpunimi në mes zyrës ndërlidhëse të Interpolit të UNMIK-ut, Policisë së Kosovës dhe autoriteteve gjyqësore. Në vitin 2010, zyra e UNMIK-ut ka ndihmuar një numër të shtuar të urdhër-arresteve ndërkombëtare të publikuara kundër personave të kërkuar ndërkombëtarisht për arrest të përkohshëm (27 krahasuar me 4 në vitin 2009 dhe 12 në vitin 2008) dhe shtatë ekstradime janë kryer nga/në Kosovë.

Bashkëpunimi në mes policisë së Kosovës dhe EULEX-it nuk ka qenë i njëtrajtshëm gjatë periudhës së raportimit. Janë iniciuar hetime të përbashkëta në disa raste penale. Policia mori përsipër përgjegjësi të plotë nga KFOR-i për mbrojtjen e disa objekteve fetare. Ajo sukses ka mbikëqyrur ngjarje të tilla si zgjedhjet në Kosovë apo shugurimi i kreut të ri të dioqezës së Rashkës-Prizrenit të Kishës Ortodokse Serbe.

Ka pasur ndërhyrje të pavend nga politika në emërimet të larta të policisë dhe në kryerjen e operacioneve të ndjeshme të policisë. Policia ka bërë përparim të kufizuar në implementimin e metodologjisë së policisë në bashkësi në të gjitha rajonet. Nuk ka pasur kontakt sistematik në mes të policisë dhe komunave në komitetet lokale për siguri publike. Nuk janë themeluar Stacione të reja policore në të gjitha komunat e themeluara rishtazi. Inspektorati Policor, nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ende nuk e ka kryeshefin ekzekutiv dhe nuk e ka iniciuar asnjë hetim në vitin 2011. Mbledhja e të dhënave është përmirësuar, por aftësia për të transformuar informacionin në inteligjencë vepruese vazhdon të jetë e kufizuar. Policia e udhëhequr nga inteligjenca mbetet një sfidë. Ka sfida serioze në drejtim të menaxhimit të burimeve njerëzore. Sistemi i treguesve të bazuar në performancë sistemi i promovimit ende duhet të themelohen. Shtylla e operativës e policisë nuk ka kapacitet për sa i përket planifikimit strategjik dhe aftësive analitike. Drejtorja e komunikacionit nuk i ka kapacitetet e nevojshme për të gjeneruar analizat e komunikacionit në mënyrë që të zhvillojë një strategji të trafikut policor. Kapacitetet e Policisë në fushën e zhvillimit të infrastrukturës së TI-ve (TIK) duhet të forcohen edhe më tutje.

Mjedisi në veri të Kosovës ka mbetur sfidues për polici.

Në përgjithësi, policia ka marrë përgjegjësi të shtuara. Policia duhet të adresojë sfidat strukturore dhe organizative për të përmirësuar aftësitë e saj për të luftuar llojet e ndërlikuara të krimit. Duhet të merren hapa për të shmangur ndërhyrjen politike në çështjet policore.

4.3.5. *Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit*

Është arritur përparim i kufizuar në luftimin e **krimit të organizuar**. Bashkëpunimi me EULEX-in në rastet e krimit të organizuar ka qenë i mirë në nivelin e policisë dhe prokurorisë. Policia me sukses ka siguruar mbrojtje të afërt për prokurorët special të përfshirë në hetime në rastet e krimit të organizuar. Policia e Kosovës e ka filluar ndërtimin e kapaciteteve për trajtimin e dëshmitarëve të mbrojtur. Asetet e sekuestruara kanë qenë të ruajtura përkohësisht në lokalet e shërbimit korrektues të Kosovës. Gjithnjë e më shumë Policia ka përdorur dhe shpërblyer informatorët në rastet e krimit të organizuar dhe ka përmirësuar aftësitë e tyre ligjore për përgjim. Në mungesë të një ligji mbi përgjimin e telekomunikimeve, policia ka nënshkruar marrëveshje me operatorët e telekomunikacionit, duke siguruar një kornizë ligjore për të iniciuar përgjim të ligjshëm. Legjislacioni i përgjimit në të ardhmen duhet të bëjë dallim të qartë ndërmjet përgjimit gjyqësor dhe përgjimit për shërbime të inteligjencës, në përputhje me praktikën më të mira evropiane.

Një numër i hetimeve, aktakuzave dhe dënime janë arritur në rastet e krimit të organizuar. Disa operacione kanë shënjestruar zyrtarë dhe ndërtesa të Qeverisë. Gjashtë persona janë dënuar (nga kolegje të përziera të EULEX-it dhe gjyqtarëve të Kosovës), dhe pesë raste janë në pritje për gjykim. Gjashtë raste janë sjellë për shqyrtim gjyqësor në mes të janarit dhe qershorit (katër trajtohen nga Prokuroria Speciale e Kosovës dhe dy nga prokurorët e EULEX-it). Në qershor, në gjykimin e rastit të lumit Tisa - një rast i kontrabandimit të emigrantëve - një kolegji i përzier prej gjyqtarëve të Kosovës dhe EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë i ka dënuar shtatë të pandehur me gjithsej 66 vjet burgim (dënimet

dallonin duke filluar nga 2 deri 19 vjet burgim) dhe dënime me gjoba pre 450.000 € për rolin e tyre në vdekjen e pesëmbëdhjetë personave që u mbytën në lumin Tisa në përpjekje për ta kaluar kufirin ndërmjet Serbisë dhe Hungarisë në Tetor të vitit 2009. Bashkëpunimi rajonal ka qenë i rëndësishëm në këtë rast dhe udhëheqja e rastit ishte marrë nga institucionet e Kosovës për sundim të ligjit. Rasti ndër të tjera ka ekspozuar një grup për krim të organizuar që ju ka ofruar emigrantëve kalim të paligjshëm në vendet e BE-së dhe vendeve të tjera evropiane, duke krijuar përfitime të paligjshme në masë të konsiderueshme.

Kapacitetet për zbulimin e krimit tej-kufitar mbeten të ulëta. Rrjedha e informatave ndërmjet Departamentit kundër Krimit të Organizuar dhe qendrave rajonale të policisë nuk është në nivel të duhur. Sfidat logjistike, duke përfshirë mungesën e hapësirës së zyrave, personelit, identifikimit të lokacioneve të sigurta për aktivitete të fshehta, vetura dhe pajisjeve të specializuara të pamjaftueshme mbeten çështje brengosëse. Departamenti është i ngadalshëm në përshtatjen ndaj ndryshimit të vazhdueshëm të teknikave të krimit dhe ndryshimit të legjislacionit. Vetëm disa raste të vogla janë iniciuar nga policia. Programi i dobët aktual i mbrojtjes së dëshmitarëve në Kosovë dhe legjislacioni nuk i japin besimin e nevojshëm e publikut për të bashkëpunuar si dëshmitarë me autoritetet.

Në përgjithësi, kapacitetet e Kosovës për të luftuar krimin e organizuar janë ende në një fazë të hershme. Përpjekje serioze janë të nevojshme për të adresuar këto sfida, në veçanti për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Kosova ka bërë ca përparim në trajtimin e **trafikimit të qenieve njerëzore**. Kosova mbetet vend i origjinës, transitit dhe i destinimit për viktimat e trafikimit. Ka vazhduar trendi i trafikimit të femrave përbrenda Kosovës por edhe në shtete tjera kudo në Evropë për qëllime të shfrytëzimit seksual. Ka pasur shtim në numër të viktimave të mitura të trafikuar për shfrytëzim seksual. Trafikimi i fëmijëve- dhe shfrytëzimi për qëllime të lëmshës mbetet në nivele të larta. Numri i viktimave të identifikuar ka shënuar një rritje të lehtë gjatë periudhës raportuese.

Strategjia dhe plani i veprimit kundër trafikimit me qenie njerëzore për vitin 2011-2014 është miratuar më 1 shtator dhe në vjeshtë të vitit 2010 është organizuar një fushatë për vetëdijesim në lidhje me trafikimin. Grupi punues ndërministror kundër trafikimit i ka vazhduar takimet e rregullta. Është emëruar një koordinator kombëtar i cili është përgjegjës për të siguruar implementimin e strategjisë.

Ka pasur rritje të efikasitetit dhe kapacitetit të Drejtorisë së policisë për hetime të trafikimit me qenie njerëzore. Policia ka identifikuar mbi 20 raste të trafikimit të qenieve njerëzore. Ata kanë arrestuar më shumë se 70 persona të dyshuar dhe kanë identifikuar më shumë se 30 viktima të trafikimit. Shkalla e dënimeve mbetet shumë e ulët. Vetëm një rast i krimit të organizuar në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore është sjellë në gjykim në gjysmën e parë të vitit 2011 (rasti i Medicus-it) pasi që ishin konfirmuar aktakuzat nga një kolegji i përzier i apelit nga gjyqtarë të EULEX-it dhe të Kosovës në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Prokuroria e këtij rasti është nën mbikëqyrjen e Prokurorisë Speciale të Kosovës.

Numri i përgjithshëm i viktimave të identifikuar mbetet relativisht i ulët me një mesatare prej një viktimitë për çdo dhjetë bastisje të kryera. Kapaciteti i prokurorisë së Kosovës dhe gjykatave për të bërë hetime, për të ndjekur penalisht dhe për të marrë aktgjykime në rastet e trafikimit është ende i kufizuar. Trafikimi i qenieve njerëzore rrallë herë përcillet nga gjykatat nga një perspektivë e krimit të organizuar. Kryerësit, edhe kur veprojnë në grup, akuzohen individualisht, duke marrë dënime më të ulëta se sa po të ishin akuzuar për veprim në grup.

Në përgjithësi, Kosova ka arritur ca përparim në trajtimin e trafikimit të qenieve njerëzore, por është e nevojshme që të rriten përpjekjet për të zbatuar strategjitë dhe legjislacionin. Përcjellja nga gjyqësori mbetet kryesisht e joefikase dhe kapacitetet duhet të forcohen.

Kosova ka pasur përparim të kufizuar në **luftën kundër terrorizmit**. Kryesisht ka pasur zbatim të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ekzistojnë brenga në lidhje me grupe ekstremiste, si fetare ashtu edhe nacionaliste dhe të trafikimit tej-kufitar të paligjshëm në Kosovë. Ekstradimi i terroristit të dyshuar në SHBA për ndjekje penale ka dështuar, për shkak të mungesës të një marrëveshjeje të vlefshme ekstradimi.

Kapaciteti i Kosovës për të zbatuar legjislacionin përkatës dhe dokumentet strategjike si strategjia e sigurisë së Kosovës, strategjia e kundër terrorizmit, ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit mbetet një brengë. Drejtoria e Kundër Terrorizmit ballafaqohet me disa sfida operationale dhe organizative. Ekziston mungesë e kapaciteteve të planifikimit strategjik, që do të thotë se janë ndërmarrë shumë pak hetime. Kapacitetet e mbikëqyrjes janë në rritje për shkak të bashkimit të njësisë së vëzhgimit të policisë kundër terrorizmit dhe njësisë së vëzhgimit të krimit të organizuar në reformën e fundit të policisë. Lidhja me Agjencinë Kosovare të Inteligjencës është mbajtur jashtë Drejtorisë vetëm në nivel strategjik. Kur është fjala për luftën kundër terrorizmit, bashkëpunimi me vendet në rajon është i kufizuar dhe Drejtoria nuk është e përfshirë drejtpërdrejt.

Në përgjithësi, në **luftën kundër terrorizmit** Kosova duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për t'i zbatuar politikën dhe legjislacionin e saj.

4.3.6. Mbrojtja e të dhënave personale

Kosova ka bërë pak përparim në mbrojtjen e të dhënave personale. Në maj, Kuvendi ka miratuar pesë anëtarë të këshillit (shëfën e mbikëqyrësve kombëtar dhe katër mbikëqyrësit kombëtar) të agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale të cilët janë propozuar nga qeveria, e cila është përcjellë me themelimin e agjencisë në korrik. Vetëdijesimi i mbrojtjes së të dhënave mbetet shumë i ulët. Kapacitetet nga të gjitha institucionet në përputhje me legjislacionet për mbrojtjen e të dhënave kanë vazhduar të jenë shumë të kufizuara. Për shkak të mungesës të mekanizmave që rregullojnë përdorimin e të dhënave personale, procedura rishtazi e paraqitur për regjistrimin e SIM kartelave që përfshinë grumbullimin e të dhënave personale nga operatorët celularë, ngritë disa brenga.

Në përgjithësi, mungesa e mbrojtjes së të dhënave personale mbetet një çështje brengosëse. Kosova duhet të bëjë përpjekje të mëdha në këtë fus

Shtojca Statistikore

Të dhënat statistikore (deri më 30.09.2011) Kosovë

Të dhëna themelore	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Popullsia (mijë)		:	:	:	1 985	2 016	2041	2100	2127	2153	2181p	2208p
Territori gjithsej (km ²)		10887	10887	10887	10887	10887	10887	10887	10887	10887	10887	:

Llogaritë nacionale	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Bruto Produkti Vendor (BPV) (për milion euro)	1)	:	1624	1735p	1797p	2913p	3003p	3120p	3394p	3851p	3912p	:
BPV (Euro për kokë banori)		:			905p	1427p	1451p	1486p	1593p	1789p		
BPV (sipas Standardeve të fuqisë blerëse (SFB) për kokë banori)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
BPV për kokë banori në SFB (BE-27 = 100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Shkalla reale e rritjes së BPV-së, vëllimi, monedha, ndryshimi në % nga viti i kaluar		:	:	1.2p	3.1p	:	:	:	:	:	:	:
Rritja e punësimit (llogaritë nacionale ndryshimi në % në vitin e mëparshëm)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Rritja e produktivitetit të punës: rritja e BPV-së për person të punësuar (ndryshimi në % në vitin e kaluar)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Rritja reale e njësisë së kostos së punës (llogaritë nacionale në % ndryshimi në vitin e kaluar)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Produktiviteti i punës për një person të punësuar (BPV në SFB për person të punësuar, EU-27=100)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Vlera e shtuar bruto sipas sektorëve kryesor (%)												
Bujqësia dhe peshkimi	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Industria	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Ndërtimtaria	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Shërbimet	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Shpenzimet e konsumit final, si pjesë e BPV-së (%)	:	:	163.1	151.6	147.5	110.3p	112.1p	111.1p	112.3	112.8	109.4	
Formimi i kapitalit të fiksuar bruto, si pjesë e BPV-së (%)	2)	:	40.7	34.5	29.3	20.0p	19.7p	21.1p	21.9p	24.4p	26.2	:
Ndryshimet në inventar, si pjesë e BPV-së (%)	:	:	:	:	:	4.0	4.3	4.5	4.4p	4.1p	3.6	:
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve si pjesë e BPV-së (%)			16.6	12.5p	10.4p	10.7p	11.1p	14.1p	15.7p	14.8p	15.6p	
Importi i mallrave dhe shërbimeve si pjesë e BPV-së (%)			120.4	98.6p	87.1p	45.0p	47.9p	50.8p	53.7p	56.0p	54.8p	

Industria	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Indeksi i vëllimit të produktit industrial (2000=100)		:										:

Shkalla e inflacionit	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Shkalla mesatare e Inflacionit vjetor (CPI, % ndryshimi në vitin e mëparshëm)		:			1.3	1.1	1.4	0.6	4.4	9.4	2.4	3.5

Bilanci i pagesave	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Bilanci i pagesave: llogari rrjedhëse gjithsej (milionë euro)		:	228	-104	-204	-209	-248	-226	-354	-629	-604	-684
Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: bilanci tregtar (milionë euro)		:	-646	-890	-941	-983	-1079	-1173	1368	-1668	-1673	-1735
Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse shërbimet neto (milionë euro)		:	10	-23	-14	-19	-8	29	59	81	121	37
Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse të hyrat neto (milionë euro)		:	141	154	152	138	139	159	186	164	83	125
Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse transferet aktuale neto (milionë euro)		:	723	665	599	655	700	759	769	749	866	889

Nga të cilat transfere të Qeverisë (milione euro)	:	809	661	490	372	348	320	245	256	401	361
Investimet e huaja të drejtpërdrejta neto (IHD) (milione euro)	:	:	:	:	43	108	248	431	342	281	311
Investimet e huaja direkte (IHD) jashtë (milione euro)	:	:	:	:	0	0	-6	-10	-25	-11	-3
Prej të cilave IHD të ekonomisë së raportuar në 27 vendet e BE-së (milione euro)	:	:	:	:	:	:	:	0	-9	-2	-1
Investimet e huaja direkte (IHD) në ekonominë e raportuar (milione euro)	:	:	:	:	43	108	289	441	366	291	315
Prej të cilave IHD të 27 vendeve të BE-së në ekonominë e raportuar (milione euro)	:	:	:	:	:	:	:	340	212	184	188

Financat publike	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Deficiti/suficiti i përgjithshëm i qeverisë, në raport me BPV (%)	:	:	:	8.4	2.2	2.7	:	:	:	:	:	:
Borxhi i përgjithshëm i qeverisë, në raport me BPV (%)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:

Indikatorët publikë	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Bruto borxhi i jashtëm i gjithë ekonomisë, në raport me BPV (%)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Bruto borxhi i jashtëm i gjithë ekonomisë, në raport me eksportet totale (%)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Oferta e parasë: M1 (banknota, monedha, depozita brenda nate, milionë euro)	:	761	971	998	891	713	572	:	:	:	:	:
Oferta e parasë: M2 (M1 plus depozitat me maturim deri në dy vjet, milionë euro)	:	761	1096	1126	1111	1128	1092	:	:	:	:	:
Oferta e parasë: M3 (M2 plus instrumentet e tregtueshme, milionë euro)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Kredidhënia totale nga institucionet monetare financiare për banorë (konsoliduar) (milione euro)	:	3	26	87	233	374	514	637	892	1 183	1 289	1 459
Shkalla e interesit: shkalla e parasë ditë pas dite, në vit (%)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Shkalla e interesit në kredi (një vit), për vit (%)	3)	:	:	:	:	14.7	14.4	14.5	14.6	14.8	14.1	14.3
Shkalla e interesit në depozita (një vit), për vit (%)	3)	:	:	:	:	2.8	2.9	3.0	3.3	4.2	4.0	3.4
Shkalla e këmbimit të euros	1)	1000	1000	1000	1000	1000	1000	1000	1000	1000	1000	1000
Indeksi i shkallës efektive të këmbimit (2000=100)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Vlera e aseteve rezervë (përfshirë arin) (milione euro)	:	62	296	337	423	311	278	356	647	670	501	587

Tregtia e jashtme	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Vlera e importeve: gjitha mallrat, gjithë partnerët (milione euro)	:	:	:	:	:	1050.4	1180.0	1314.6	1576.1	1930.0	1933.8	2157.7
Vlera e eksporteve: gjitha mallrat, gjithë partnerët (milione euro)	:	:	:	:	:	56.6	48.9	81.7	147.3	196.4	165.3	288.1
Bilanci tregtar: gjitha mallrat, gjithë partnerët (milione euro)	:	:	:	:	:	-993.8	-1131.1	-1232.9	-1428.8	-1733.6	-1768.5	-1869.6
Mënyrat e tregtimit (indeksi i çmimit të eksportit/ indeksi i çmimit të importit)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Hisja e eksporteve në 27 vendet e BE-së në vlerën e totalit të eksportit (%)	:	:	:	:	:	29.3	37.9	35.7	42.6	47.7	43.1	44.9
Hisja e importeve nga 27 vendet e BE-së në vlerën e totalit të importit (%)	:	:	:	:	:	40.3	38.4	34.2	35.2	36.2	39.0	38.3

Demografia	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Shkalla e Rritjes së natyrshe (lindjet minus vdekjet) (në 1000 banorë)	:	:	:	:	12.8	14.1	14.5	12.6	12.4	12.7	12.5	:
Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave: vdekjet e fëmijëve nën moshën një-vjeçare për 1000 lindje të gjalla	:	:	:	11.2	15.1	11.8	9.6	12.0	11.1	9.7	9.9	:
Jetëgjatësia e pritur në lindje: meshkuj (vjet)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Jetëgjatësia e pritur në lindje: femra (vjet)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:

Tregu i punës	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Shkalla e veprimtarisë ekonomike (15-64): hisja e popullsisë në moshë 15-64 që është ekonomikisht aktive (%)	:	:	45.6	52.8	50.3	46.2	49.2	52.3	46.8	46.2	48.1	:

* Shkalla e punësimit (15-64): hisja e popullsisë së moshës 15-64 e punësuar (%)	:	19.6	23.8	25.3	27.7	28.5	28.7	26.2	24.1	26.1	
Shkalla e punësimit: meshkuj (15-64) (%)		31.1	39.4	42.8	46.4	45.8	46.1	40.1	37.7	39.7	
Shkalla e punësimit: femra (15-64) (%)		8.1	8.8	8.3	9.9	11.7	11.8	12.7	10.5	12.5	
Shkalla e punësimit të punëtorëve të moshuar (55-64): hisja e popullsisë në moshë 55-64 në punësim (%)		16.7	18.4								
Punësimi sipas sektorëve kryesorë (%)											
Bujqësia	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Industria	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Ndërtimtaria	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Shërbimet	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Shkalla e papunësisë: hisja e fuqisë punëtore që është e papunë (%)	:	57.1	55.0	49.7	39.7	41.4	44.9	43.6	47.5	45.4	:
Hisja e fuqisë punëtore mashkullore të papunë (%)	:	51.8	45.2	40.3	31.5	32.9	34.6	38.5	42.7	40.7	:
Hisja e fuqisë punëtore femërore të papunë (%)	:	69.9	74.5	71.9	60.7	60.5	61.6	55.2	59.6	56.4	:
Shkalla e papunësisë së personave < 25 vjeç: hisja e fuqisë punëtore në moshë <25 vjeç e papunë (%)	:	80.0	77.7	74.9	66.5	70.5	75.5	70.0	73.0	73.0	:
Shkalla e papunësisë afatgjatë: hisja e fuqisë punëtore e papunë për 12 muaj e më shumë (%)		47.6	47.3	42.7	34.9	34.7	41.1	37.1	38.9	37.1	:

Kohezioni social	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Pagat dhe mëditjet nominale mujore mesatare (valuta kombëtare)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Indeksi i pagave dhe mëtidjeve reale (Indeksi i pagave dhe mëtidjeve reale pjesëtuar me CPI/HICP) (2000=100)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
* Braktisja e hershme e shkollës – hisja e popullsisë së moshës 18-24 vjeç me më së shumti shkollim të ulët të mesëm dhe jo më tutje arsim apo trajnim (%)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:

Standardi i jetesës	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Numri i automjeteve të udhëtarëve për 1000 persona	:	:	:	:	:	50.1	69.9	68.7	74.1	:	:	:
Numri i abonimeve në shërbime të telefonisë celulare për 1000 persona					158.7	169.5	:	:	:	376.2	369.1	:

Infrastruktura	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Dendësia e rrjetit hekurudhor (linja në funksion, në 1000 km ²)	:	:	:	:	:	39.5	:	:	:	:	30.6	:
Gjatësia e autostradave (mijë km)		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.6	0.6

Inovacioni dhe hulumtimet	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Shpenzimet në resurse njerëzore (shpenzime publike në arsim në % të BPV-së)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
* Bruto shpenzimet vendore në Kërkim/Zhvillim në % të BPV-së	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Përqindja e amvisërive që kanë qasje në internet në shtëpi (%)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:

Mjedisi	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
* Emetimet e gazrave serrë, ekuivalent me CO2 (tonë, 1990=100)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Intensiteti i energjisë së ekonomisë (kg naftë ekuivalent për 1000 euro BPV)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Energjia elektrike e prodhuar nga burimet e ripërtëritshme në % të bruto-konsumit elektrik	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Hisja rugore e transportit të mallrave brenda vendit (% e ton-km)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:

Energjia	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Prodhimi primar i gjitha produkteve energjetike (mijëra TOE)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Prodhimi primar i naftës brut (mijëra TOE)	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:

Prodhimi primar i thëngjillit të fortë dhe linjtit (mijëra TOE)	4)	:	:	3 853	4 507	3944	4 455	4 553	4 681	5 466	7 842	7 960
Prodhimi primar i gazit natyror (mijëra TOE)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Neto-importet e gjitha produkteve energjetike (mijëra TOE)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Bruto-konsumi i energjisë brenda vendit (mijëra TOE)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Gjenerimi elektrik (mijëra GVVh)				3.2	3.2	3.5	4.0	4.0	4.3		5.3	5.5

Bujqësia	Shënim	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Indeksi i mallrave dhe shërbimeve në vëllimin e prodhimit bujqësor (çmimet e prodhuesit, viti i kaluar =100)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Gjithsej sipërfaqe bujqësore e shfrytëzuar (mijëra hektarë)		:	539	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Bagëtia: (mijëra krerë, fundi i periudhës)		289	347	319	:	335	352	382	322	342	344p	:
Bagëtia: derra (mijëra krerë, fundi i periudhës)		59	75	110	:	55	47	68	40	27	51p	
Bagëtia: dele e dhi (mijëra krerë, fundi i periudhës)		193	230	116	:	106	152	113	152	180	217p	
Prodhimi dhe shfrytëzimi i qumështit në fermë (i gjithë qumështi i plotë, mijëra tonë)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Të korrat: (përfshirë orizin) (mijëra tonë, prodhimi në të korra)			459	396	:	408	441	392	295	438	411p	
Të korrat: panxharsheqer (mijëra tonë, prodhimi në të korra)		:	:	:	:	:	:	:	:	:	:	:
Të korrat: perime (mijëra tonë, prodhimi në të korra)			169	135	:	150	159	172	117	176	144p	

: = nuk është në dispozicion
p = përkohshme
e = vlerë e supozuar
b = ndarja në seri
* = indikator i Evropës 2020

Konventat e shenjave për bilancin e pagesave përdoren për IHD. Për IHD jashtë vendit, shenja e minusit do të thotë që investimi jashtë vendit nga ekonomia raportuese ka tejkaluar de-investimin gjatë periudhës, derisa shënimi pa shenjë do të thotë de-investimi ka tejkaluar investimin. Për IHD-të në ekonominë e raportimit shënimi pa shenjë do të thotë që investimi në ekonominë e raportuar ka tejkaluar de-investimin, derisa shenja e minusit tregon që de-investimi ka tejkaluar investimin.

Fusnotat:

- 1) Euroja është valuta në përdorim.
- 2) Investimet: përfshirë sektorin e donatorëve, qeverinë e përgjithshme, investimet private (banim dhe tjera).
- 3) Qysh prej 2008-ës, shkallët e interesit mbi huatë përfshijnë tarifën e kreditimit që vendoset nga bankat.
- 4) Prodhimi vendor i qymyrit në mijëra tonë.